



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

### THËRRAS

Mbledhjen e XLVI-të (dyzetegjashtë - mandati VII)-e rregullt, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **11 dhjetor 2024**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës, në orën **10:00**, me këtë;

### REND TË DITËS

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 12 shtator 2024; 26 shtator 2024 dhe 04 nëntor 2024
2. Propozim vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës
3. Draft Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës, për vitin 2025
4. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajjtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025
5. Informatë e Punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, korrik - nëntor 2024
6. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
7. Të Ndryshme

Nr.Prot.01-060/03-0077062/24  
Podujevë, datë; 02.12.2024



Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **Procesverbal nga mbledhja e XLIII-të (dyzetetretë)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 12 shtator 2024.**

Mbledhja filloi në orën 10:30 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi, kurse mungoi Ardi Hasani.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu; kurse mungoi; Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Demokrat Hodolli; Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Shujb Blakçori-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Alban Zeka-Drejtorja e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR, përfaqësues të mediave lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

### **Rendi i Ditës**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe i'u dëshiroj mirëseardhje dhe punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, para se të fillojmë me rendin e ditës konstatojmë se kuorumi ekziston dhe për momentin prezent në sallë jemi 31 anëtar/e të Kuvendit dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen.

**z.Valon Demolli**, theksoi, kërkoj që në rend të ditës të futet si pikë e rendit të ditës zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Komunitete me një anëtarë nga radhët e LDK-së.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrale dhe Gjeodezisë DPKGJ, theksoi, arsyeja pse po e marrë fjalën është në lidhje me disa pika të rendit të ditës të cilat kanë të bëjnë me dhënien e pronave në shfrytëzim andaj propozoj që Njësia kadastrale P-1057-0 ZK Balloc të largohet nga rendi i ditës për arsye se është propozim me dhënë në shfrytëzim me qira, mirëpo pasi që është përcjellë rendi i ditës është ofruar një mundësi ku së bashku me Federatën e Futbollit të Kosovës parashikojmë ndërtimin e një stadiumi të futbollit, andaj është e nevojshme që të mbetet kjo pronë në pronësi komunale andaj edhe duhet të tërhiqet nga rendi i ditës për dhënie në shfrytëzim.

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, së pari e vë në votim propozimin e z.Valon Demolli, që të vendoset si pikë e rendit të ditës, propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete me një anëtar nga radhët e LDK-së.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë 12 vota janë Për, 14 votë Kundër, 1 votë e Përmbajtur, nuk kalon propozimi i z.Valon Demolli, për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete me një anëtar nga radhët e LDK-së.*

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, sa për sqarim për këtë pikë të rendit të ditës që nuk kaloj unë brenda javës do të shkoj në Ministrinë përkatëse dhe do të kërkoj me shkrim interpretim për këtë çështje.

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal-MAPL, kur LDK nuk është përfshirë në këtë përbërje të këtij Komiteti, kjo Ministri ka kthyer përgjigje që duhet të jenë të përfshira Grupet parlamentare në këtë përbërje, këtë e ke të specifikuar me rregullore që kjo ju takon Grupeve parlamentare, andaj nga ana juaj kërkoj që të zëvendësohet ky anëtar sepse kjo pozitë na takon neve si Grup i anëtarëve të LDK-së.

Anëtari që ka qenë nuk është më pjesë e LDK-së, kështu që në përbërjen e Komitetit për Komunitete duhet të jetë i përfshirë edhe një anëtar nga radhët e LDK-së pasi që kjo i takon LDK-së dhe duhet të bëhet ky zëvendësim, përndryshe seanca nuk vazhdon.

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani e vë në votim propozimin e drejtorit të DBF-së z.Fatlum Osmani që pika 9 dhe 9.1 që është për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, të largohet nga rendi i ditës, dhe atë:

*-Propozim vendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1057-0, ZK Balloc,*

*-Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.*

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan) mbështetet propozimi për largimin nga rendi i ditës pikën 9 dhe nën pikën 9.1, dhe atë:*

*9. Propozim vendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës - Njësia kadastrale P-1057-0, ZK Balloc,*

*9.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.*

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, i nderuar Kryesues, nga ana juaj kërkoj që të bëhet zëvendësimi anëtarit të Komitetit për Komunitete, ti e ke vendimin vetëm zbatoje, përse të kthehen dy vendime të njëjta për të njëjtën çështje.

**z.Valon Demolli**, theksoi, unë nga kjo foltore e ftoj z.Demokrat Hodollin që moralisht të dalë e të japë dorëheqje nga Komiteti për Komunitete pasi që nuk është më pjesë e LDK-së, përndryshe duhet të zhvillohet procedura tjera për largimin e tij nga përbërja e Komitetit, përndryshe ne nuk

kemi rrugë tjera, sepse ky vend i takon LDK-së, pra i takon dhe duhet t'i takoj Grupeve parlamentare, andaj e ftoj publikisht që të vijë të japë dorëheqje këtu para qytetarëve, përndryshe duhet të zëvendësohet.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nuk do të doja të bëhet zhurmë për këtë çështje, kurse i nderuar z.Ekrem Rrahmani unë nuk kam vendim për këtë çështje.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, Kryesues ju e keni vendimin e MAPL-së, unë më parë kam bërë ankesë në MAPL për këtë çështje dhe e ke vendimin.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, unë jam interesuar dhe e kam lexuar Udhëzimin Administrativ i cili thotë që anëtari i Komitetit për Politikë dhe Financa që e ndërron etnitetin politik duhet ta liroj vendin ndërsa Komiteti për Komunitete drejtpërsëdrejti nuk përmendet por edhe ai është Komitet i përhershëm, mirëpo emri Komitet për Komunitete nuk përmendet.

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues, vetëm dy Komitete të përhershme janë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, nga ju kërkoj që të na jepni mundësi deri në mbledhjen e ardhshme të marrim një vendim për këtë çështje, pra që ne sot t'i drejtohem me shkresë MAPL-së e pastaj Ministria të na kthej përgjigjen për çështjen në fjalë.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, qysh i nderuar Kryesues i dërgon Ministrisë kërkesë për shqyrtim një gjë për të cilën Ministria të ka kthyer përgjigje ty dhe e ke vendimin në zyrë, unë e kam bërë ankesën për përbërjen e Komitetit për Komunitete dhe për përbërjen e anëtarëve të komisionit të këshillave të fshatrave, unë e kam bërë ankesën dhe Ministria i ka kthyer vendimet edhe njëherë në ri votim sepse herën e parë nuk na e keni lejuar ta kemi një anëtar në Komitet për komunitete, andaj çfarë vendimi tjetër doni ju kur Ministria të ka kthyer vendimin dhe e ke në zyre, pra nuk e di pse po e zgjatni këtë punë së pari ju e pastaj ky (i drejtohet z.Demokrat Hodollit) që i ka marrë nga 200€ në emër të LDK-së, e s'ka fol kurrë, veç ka shkuar si kukull në mbledhje dhe tash prapë rrinë si kukull dhe nuk del me dhënë dorëheqje.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, i nderuari z.Ekrem Rrahmani, tani është një situatë tjetër, ky është anëtar, e ka lëshuar subjektin politik dhe është e drejtë e secilit anëtar të Kuvendit edhe ta ndërroj partinë dhe ta lëshoj partinë.

**z.Demokrat Hodolli**, theksoi, nuk e di pse po e kërkoj fjalën sepse unë e di që këta kanë qejf me ua lëshua vendi por atë mundësi nuk jua jap, unë duhet t'ju tregoj disa prej tyre që qoj më shumë rëndë se këta, për me fol me mua duhet me qenë në baraspeshë me mua kurse këta janë mësuar veç me blofe, në mënyrë demokratike këta nuk dinë, pra shkojmë me vota nëse jeni për me më shkarkuar në rregull gjithçka, është demokratike, por jo pa vota. Këta janë mësuar veç në mënyrë fallc, a e keni parë edhe në jetë reale këta non-stop veç sulmojnë, veç fallco, askush në fytyrë nuk del me thënë që unë jam dhe po ju sulmoj, por veç në mënyrë fallco. Pra ejani në mënyrë demokratike vazhdoni me vota dhe gjithçka është në rregull, nëse nuk i keni votat është diçka tjetër ngase të gjithë me vota kemi ardh këtu, asnjë prej nesh pa vota s'ka ardh këtu.

**z.Valon Demolli**, theksoi, parafolësi ka të drejtë sepse me vota e kemi dërguar në Komitet për Komunitete, mirëpo ai vend i takon LDK-së, ky më nuk është pjesë e LDK-së, ky e ka tradhtuar elektoratin e vet për interesa të caktuara, kështu që ky duhet ta liroj vendin.

**z.Florent Hasani**, theksoi, i nderuar Kryesues, kjo nuk kaloj si pikë e rendit të ditës, përndryshe nëse e kanë vendimin e MAPL-së të cilin po e cekin, le te lexon. Nuk mund të thuhet ose të zëvendësohet ose nuk vazhdon seanca, sepse askush nuk mund t'i pengoj seancat

**z.Valon Demolli**, theksoi, ose do të zëvendësohet ose nuk vazhdon seanca i nderuar Kryesues, ti je ai që më ke thënë, ju keni të drejtë duhet të zëvendësohet, nuk e di çfarë frike ke ose prej kujt po ke frikë tani, ti e din që i takon LDK-së, duhet të zëvendësohet, nuk ka rrugë tjetër, ju po dëshironi



me prishë seancën, nuk lejojmë vazhdimin e seancës pa u bërë zëvendësimi me anëtarin e LDK-së, nuk e lejojmë të jetë përfaqësues i LDK-së dikush që nuk është në LDK.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nuk kemi çka diskutojmë më për këtë pikë, propozimi nuk kaloi me vota, ishin 12 vota Për, 14 vota Kundër dhe nuk kaloi, unë askënd s'mund ta detyroj të votoj.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, vetëm silleni vendimin e MAPL-së dhe lexoje, dhe nuk e di përse po e zgjatë këtë farë pune, vendimi e ke dhe na takon neve ajo e drejtë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, unë për këtë çështje nuk kam vendim të MAPL-së, kur ta kem vendimin e sjellë dhe e lexoj, vendim për këtë çështje nuk kam, unë kam pas vendim që të caktohet një anëtar i LDK-së në Komitetin për Komunitete.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, nuk e di me çfarë logjike i nderuar Kryesues ti po kundërshton, ti e ke një vendim që në fillim të mandatit të është dhënë nga MAPL që Grupi parlamentar i LDK-së të përfshihet në Komitetin për Komunitete si komitet i përhershëm, meqenëse në fillim se ke përfshirë këtë dhe nuk e ke votuar të është kthyer vendimi prej MAPL-së që LDK-ja duhet ta ketë një anëtar në Komitetin për Komunitete. Për momentin LDK-ja nuk ka përfaqësues në Komitetin për Komunitete, a është kështu, përderisa nuk ka përfaqësues dhe ky përfaqësues i takon në bazë të atij vendimi të MAPL, përse duhet edhe njëherë me pyet Ministrinë kur nuk ka nevojë, përndryshe nëse dëshirojmë të qëndrojmë indiferent përballë kësaj është diçka tjetër sepse e dinë edhe këta se kjo pozitë i takon LDK-së, pra partia në pushtet përse po marrin pjesë në votim, sigurisht për me i ngritë në fund pazaret që janë bërë për këtë vend, përndryshe mund të rrinë dhe të mos marrin pjesë në votim, ne e shkarkojmë anëtarin e tanishëm dhe e zëvendësojmë atë pozitë me një anëtar të LDK-së, e jo të deklarohen kinse nuk duam të marrim pjesë dhe nuk e votojmë këtë proces ndërsa në anën tjetër marrin pjesë dhe votojnë për diçka që s'është pjesë e tyre dhe s'ju takon.

Pra edhe njëherë, vendimin e ke Kryesues, përndryshe nuk vazhdon seanca pa u miratuar ai vendim dhe pa u zëvendësuar ky anëtar i Komitetit për Komunitete.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë nuk mund ta detyroj askënd të votoj për ose kundër, kurrfarë të drejte s'kam unë ta detyrojë dikë të votoj sepse e drejta e votimit është e drejtë dhe e lirë për secilin anëtar të Kuvendit. Asnjë pikë s'mund të kaloj në rend të ditës apo të largohet nga rendi i ditës pa vota, Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk e lejon një gjë të tillë, unë s'kam të drejtë ta fus si pikë e rendit të ditës asnjë propozim që si ka votat, pati 14 vota kundër dhe kjo është shumë normale, por nëse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal na obligon që ta bëjmë zëvendësimin ne do ta bëjmë. Ministria nuk e ka kthyer përgjigjen për këtë rast, rasti që po përmendet ka qenë kur janë formuar Komitetet dhe LDK-ja që nuk është përfshirë.

**z.Florent Hasani**, theksoi, qysh po mënoni ta futni pikë të rendit të ditës në çfarë forme, kur ajo doli në votim dhe nuk kaloi.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, nuk ka nevojë të futet fare në rend të ditës sepse është e ditur kjo çështje dhe Kryesuesi e din këtë, por vetëm të zëvendësohet sepse tani LDK nuk është e përfshirë në Komitetin për Komunitete.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, asnjë pikë e rendit të ditës nuk mund të futet e as të hiqet pa vota. Vendimin e MAPL-së që po e përmendni nuk ka qenë për këtë rast por ka qenë për tjetër rast, z.Demokrat Hodolli është pjesë e Komitetit për Komunitete në emër dhe me vota të LDK-së.

E paraqita një kompromis që të pritet deri në mbledhjen e radhës.

**znj.Edona Shabani**, theksoi, i nderuar Kryesues, ai (z.Demokrat Hodolli) edhe shumë tjerë tani më nuk janë pjesë e LDK-së.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, ne mund të bëjmë zhurmë sa të dëshironi por unë kërkoj kompromis deri në mbledhjen e ardhshme, anëtarët e Komiteti për Politikë dhe Financa janë zgjedhë me votat e të gjithëve.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, i nderuar Kryesues, unë e di që ti e din por je duke bërë paksa politikë, nuk e di përse po e shkelë Rregulloren, herën e parë kur i kemi votuar Komitetin për Komunitete këtu nuk na keni përfshirë, pastaj e kam bërë shkrimin në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ajo ta ka kthyer një përgjigje, e ke sjellë sërish në një seancë edhe është dashur të përfshihet një anëtar i LDK-së në Komitetin për Komunitete, prandaj nuk e di çka po dëshiron tani, dil e shpjegona thuaj kështu - kështu qëndron puna, përse po e shkel vendimin sërish, përse të vazhdohet kjo edhe 1 muaj, a ka dhënë dorëheqja ai (z.Demokrat Hodolli) që 4 -5 muaj, e kemi lënë ne dhe e kemi pritë, s'jemi ngut, tani përse të presim edhe një seancë, a deri te shtini në punë diku a çka është problemi, edhe tre të tjerë shtini në punë nëse ke të drejtë, por ne duam ta kemi një anëtar të LDK-së në përbërjen e Komitetit për Komunitete dhe atë nga sot, përndryshe sot seanca nuk vazhdon. Nuk është nevoja të na qitni keq, as vetën e as neve duke e bllokuar seancën. Seanca nuk vazhdon pa përfshirjen e një anëtari të LDK-së në Komitetin për Komunitete, përndryshe jo kolegun në fjalë, por të gjithë nëse keni mundësi futni në atë përbërje të Komitetit ngase askush nuk po të thotë hiqe atë, por ne e duam përfshirjen e një anëtari të LDK-së në Komitetin për Komunitete, dhe nga sot.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nuk e di a po e kuptoni ose jo që vota është ajo që vendos dhe votat ju nuk i patët.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, nuk ka këtu jo vota jo vota, ligji të obligon dhe respekto ligjin, për këtë çështje kemi interpretim në bazë të vendimit dhe nuk ka nevojë për të njëjtën çështje dy herë t'i bëhet shkresë MAPL-së sepse përgjigjen e ke aty Kryesues.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH, duke i'u drejtuar parafolësit z.Ekrem Rrahmani, theksoi, vota edhe ligjin e bënë, rrëzon, ndryshon.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, i nderuari zotëri Rrahmani, atëherë situatë tjetër ka qenë e tjetër situatë është tani, atëherë s'jeni përfshirë fare në Komitet, ashtu ka qenë.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, as tani nuk jemi të përfshirë në përbërje të Komitetit për Komunitete dhe asgjë tjetër nuk po kërkojmë vetëm përfshirjen e një anëtari nga LDK-ja në këtë Komitet, ju mund ta lëni edhe anëtarin në fjalë që është tani.

Shefi i Grupit të LVV-së e dinë këtë po nuk deshti të votoj propozimin ton por deshti të bëjë politikë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë nuk mund ta lë e as ta heq asnjë anëtar nga Komiteti për Komunitete, për këtë është Kuvendi dhe ai që vendos, e jo unë.

**z.Haki Rurdari**, theksoi, natyrisht për vazhdimin e seancës, për miratimin e rendit të ditës është një Rregullore që është nxjerrë nga Kuvendi i Komunës, Rregullore e cila shpeshherë nuk na pëlqen as neve si parti në pushtet, kjo Rregullore mund t'i mos i përshtatet as edhe partisë në opozitë në këtë moment por megjithatë Rregullorja është miratuar dhe duhet nga të gjithë të përkrahet dhe të mbështetet. Në fund të fundit ne jemi koleg, natyrisht se në këtë rast e kuptoj edhe LDK-në mirëpo një gjë dua ta them, unë për aq sa kam dëgjuar z.Demokrat Hodolli nuk është larguar nga LDK-ja por nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së, dhe ky është një dallim.

**z.Valon Demolli**, theksoi, kjo e drejtë për të cilën po diskutojmë ju takon Grupeve të subjekteve politike, dhe personi në fjalë nuk është pjesë e LDK-së.

**z.Haki Rurdari**, vazhdoi, me këto reagime të juaja po ma humbni edhe atë seriozitetin që pata për të diskutuar ngase me këtë reagim tregoni se nuk jeni serioz fare në atë kërkesën e juaj për arsye se është dallim kur largohesh prej LDK-së komplet zyrtarisht, atëherë është e vërtetë që LDK-ja mbetet pa përfaqësues.

**z.Valon Demolli**, sërish ndërhyr duke e pyetur parafolësin se qysh ndryshe duhet të largohet zyrtarisht kur ai person ka fol në foltore të Kuvendit.

**z.Haki Rurdari**, sërish vazhdoi, i nderuari koleg z.Valon Demolli, Rregullorja e përcakton ashtu siç e ceka dhe po e përsërisë, kolegu në fjalë më duket është larguar, dhe fundja unë desha të dalë vetëm si koleg, por në kuptimin e çfarë do veprimi që ju e merrni është vendim i Grupit tuaj dhe unë se kam asnjë problem, mirëpo për të dalë nga kjo situatë por ju lutem mos pyetni si votoj unë se atë nuk ma imponon askush, vota është e hapur ju atë e dini por e them si koleg si veprim që ju ndoshta e mendoni dhe veproni, është e drejtë e juaj nuk është problem por nuk është gjatë kur do të thirret një seancë, kjo nuk zgjatë me muaj shikojeni aspektin ligjor.

Nuk jam për të marrë veprime të kundërligjshme as për anëtarët e LVV-së, për arsye se në fund të fundit është ai që na ka sjellë këtu prandaj kolegjalisht kërkoj që kjo seancë të vazhdoj dhe ju të mbetni në kërkesën e juaj sepse është legjitime kërkesa juaj, e analizoni në aspektin ligjor dhe vazhdojmë edhe njëherë, është e drejta e juaj si veproni por si koleg nuk kisha pas dëshirë në kuptimin e marrjes së veprimeve ndoshta jashtë Rregullores, por prapë do të thirret një seancë e radhës dhe ne këtu do të jemi.

U tha se si të votohet, këtu jemi secili me një përkrahje qytetare por në fund këshilltari vepron vet, voton vet, në fund të fundit as unë nuk mund t'ia imponoj votimin anëtarëve të LVV-së e as opozitës se si veproni, prandaj këtë hiqeni pse po voton ose jo, kjo është e drejtë e secilit këshilltarë të votoj qysh mendon vet, tash ju mendoni se është e mirë ajo, kjo është e drejtë e juaja. Ne jemi subjekte politike dhe natyrisht se jemi edhe koleg, këtë po e përsërisë edhe njëherë se në fund të fundit mandati shkon e vjen por po e përfundoj me një thirrje kolegiale që në këtë seancë të vazhdojmë me këto pika, unë i dëgjova kërkesat, i dëgjova arsyetimet e kolegut z.Ekrem Rrhamani dhe të të gjithëve dhe në seancën e ardhshme sigurisht aspekti ligjor do të merret për bazë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, propozimi i z.Haki Rudari ishte i mirë, në këtë muaj e kemi edhe një mbledhje, brenda këtij muaji do të kërkojmë sqarim me shkrim nëse një anëtar i Komitetit për Komunitete i cili nuk përfaqëson më atë subjekt nga i cili është përzgjedhë a është i obliguar ta liroj pozitën e anëtarit të Komitetit për Komunitete. Unë me shkrim do i adresohem pa marrë parasysh votat dhe nëse ligji na e jep këtë të drejtë atëherë ne do e bëjmë zëvendësimin, mirëpo unë t'ia imponoj votimin s'mundem askujt dhe s'dua t'ia imponoi sepse është shkelje e të drejtave të njeriut dhe shkelje e ligjit, kështu që kërkoj kohë nga ana juaj që të mos krijojmë situata sepse ky problem mund të zgjidhet. Unë po ju them që monitoruesin Komunës tonë nga MAPL e kam kontaktuar por ai ka qenë në pushim, por më ka thënë se brenda javës do e zgjidhim këtë çështje. Ne jemi njerëz dhe është mirë ta bëjmë një kompromis, pritni deri në mbledhjen e ardhshme vendimin, po sa të ma kthen Ministria unë atë vendim do e sjellë këtu në Kuvend, Ministria do e kthej vendimin sepse është një ndryshim që një anëtar i LDK-së ka qenë pjesë e Komitetit për Komunitete dhe ai anëtar tani është larguar nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së.

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues, a ka mundësi ti me marrë vendimin e MAPL-së këtu me lexu para nesh, nëse ne nuk kemi të drejtë atëherë unë dal publikisht kërkoj falje, mirëpo kemi të drejtë se i takon LDK-së, kjo e drejtë iu takon Grupeve parlamentare, kurse sa i përket kërkesës për ta shtyrë për seancën e radhës pas dy jave nuk e di çfarë ndryshon ajo, kjo nuk bëhet, kjo sot duhet të ndryshohet i nderuar Kryesues.

**znj.Edona Shabani**, theksoi, i nderuar Kryesues, nuk e di ti çka je duke fituar duke e mbrojtur aq shumë këtë sistem, ne po kërkojmë veç me lexu atë vendim që të ka ardh e që e ke në zyre, asgjë tjetër. Çështja tjetër, kolegu në fjalë me vullnetin e lirë ka dalë në foltore dhe ka dhënë dorëheqje, ne jemi duke kërkuar vetëm të drejtën tonë asgjë tjetër, kështu që nuk e di çka po i jep kaq shumë rëndësi kësaj teme, ne po e kërkojmë vetëm një të drejtë tonë të përcaktuar me ligj dhe asgjë tjetër, nëse ka mundësi me lexu vendimin për ne është në rregull, përndryshe seanca nuk vazhdon.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë ju thash se është një situatë pak më ndryshe sepse ka qenë anëtar i LDK-së dhe tash ai anëtar ka dal nga LDK-ja.

Unë propozimin tuaj e vëra në votim por ai propozim nuk kaloi. Ti z.Valon Demolli a ke mundësi si shef i Grupit të LDK-së t'i thuash anëtarëve të Grupit tuaj të votojnë ashtu siç thua ti.

**z.Valon Demolli**, theksoi, ai person nuk është më pjesë e LDK-së dhe nuk ke çka të diskutosh këtu më tepër, vetëm lexo vendimin e MAPL-së. Përndryshe meqë propozimi nuk kaloi qysh po e cekë Kryesuesi, atëherë as seanca nuk vazhdon.

Edhe njëherë i nderuar Kryesues, ti e ke vendimin e MAPL-së vetëm zbatohet, kaq se as atëherë në votim s'kam mund t'i them votoni pozitës që të përfshihemi edhe ne si Grup me një anëtar në Komitet për Komunitete, kur e ka kthyer vendimin Ministria jemi përfshirë dhe po të them se pas dy jave nuk do të bëhet zëvendësimi, por do të bëhet sot sepse është e drejtë e jona.

Ti Kryesues vetëm dil dhe lexoje vendimin e MAPL-së, nëse nuk është ashtu qysh ne po themi, unë kërkoj falje.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, ne mund ta ndërprejmë këtë seancë e pastaj e vazhdojmë pas dy jave kur vjen interpretimi ligjor prej MAPL-së.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, mbledhjen ju mund ta ndërpreni por nuk keni kurrfarë të drejte sepse me votë s'kaloi propozimi juaj.

**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, i nderuar Kryesues, a bën një pauzë prej 20 minutave që t'i hapet mundësi një dakordimi se a mund apo jo të vazhdoj seanca sepse kështu vetëm po humbim kohë dhe mendoj se ky debat është vetëm humbje kohe.

**Kryesues i Kuvendit**, theksoi, atëherë e vë në votim propozimin që të shkojmë në një pauzë prej 20 minutave.

*Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga shumica e anëtarëve të Kuvendit, mbështetet propozimi për pauzë rreth 20 minuta, dhe atë nga ora 11:00*

### **Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 11:50**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, kishim takim me shefat e Grupeve por sërish nuk mundem ta gjenim një gjuhë të përbashkët për arsye se një pikë që u hedh në votim nuk kaloi dhe sipas Rregullores të njëjtën ne nuk mund ta përsërisim edhe njëherë, kështu që ju lutem, unë e dhashë një propozim dhe e ftova Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal që të na japë një shpjegim, kërkesë e tyre ishte që t'ju drejtohem me shkresë dhe ata do të na përgjigjen dhe ashtu siç e kthejnë vendimin ne do të veprojmë, ky ishte propozimi edhe i Ministrisë edhe i imi, edhe i shefit të Grupit të LVV-së z.Haki Rudari dhe i shefit të Grupit të PDK-së z.Bashkim Sylja.

Nga ana juaj kërkoj që të vazhdoj kjo mbledhje sepse deri në mbledhjen e ardhshme do të vijë një vendim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila është mbikëqyrëse e pushteti lokal dhe atë vendim do e sjellim këtu në Kuvend sepse të gjithë ne këtu jemi për ta zbatuar ligjin ngase asnjëri nga ne e as unë nuk e shkelim ligjin për askënd, e këtë nuk e bëjnë as z.Haki Rudari, as z.Valon Demolli dhe asnjëri prej nesh, do të ishte mirë të bëjmë një kompromis dhe ta vazhdojmë mbledhjen në mënyrë që deri në mbledhjen e ardhshme të gjejmë një zgjedhje.

**z.Haki Rudari**, theksoi, Kryesuesi i Kuvendit e sqaroi gjeth atë, megjithatë unë propozoj që deri në ora 13:00, të shkojmë në një pauzë, edhe ashtu është koha e pauzës dhe pastaj të kthehem në seancë pas një ore.

*Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga shumica e anëtarëve të Kuvendit, mbështetet propozimi për një pauzë deri në ora 13:00, dhe atë nga ora 11:55*

**Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 13:30.**

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani.

Nga PDK, Bashkim Syla;

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Të pavarur, Demokrat Hodolli; .

Gjithashtu të pranishëm në mbledhje ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Shujb Blakçori-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSSH; Alban Zeka-Drejtorja e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm tjerë ishin edhe përfaqësues të mediave lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, vazhdojmë me mbledhjen, përkatësisht me rendin e ditës, ne biseduam rreth një çështje që patëm dhe besoj që ishim shumë të qartë sepse unë isha shumë i qartë me juve që çështja në fjalë brenda kësaj jave do të shkojë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku do t'i kërkoj interpretim ligjor me shkrim dhe interpretimin ligjor që do të na e sjellë MAPL ne do ta zbatojmë sepse edhe ne jemi pjesë e ligjit dhe duhet ta miratojmë, kështu që s'kisha dashur që më të krijojmë skena por të vazhdojmë me punë.

Pra unë do të jem ai që do të kërkoj në emër të Kuvendit Komunal të Podujevës sqarime, kështu që ju kisha lut të kalojmë në rendin e ditës pasi që propozime tjera për rendin e ditës nuk pati, ishin dy propozime por njëri nuk kaloi.

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues edhe njëherë po them nuk mund ta vazhdosh seancën pa u bërë ky ndryshim në përbërjen e Komitetit për Komunitete me një anëtarë të LDK-së, nuk po kërkojmë diçka të një Grupi tjetër por po kërkojmë që prej Grupit tonë të bëhet zëvendësimi sepse ai person nuk përfaqëson më LDK-në dhe jemi në rregull, nuk po kërkoj diçka që nuk bëhet, vetëm po dua që vendin e LDK-së ta zëvendësojmë me një anëtarë nga radhët e LDK-së, dhe jemi në rregull.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, i nderuar z.Valon Demolli, propozimi juaj sot nuk kaloi me votë kështu që unë nuk mund të shkelim ligjin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit sepse çdo propozim duhet të kaloi me votë, kështu që nuk mund të bie në atë pozitë dhe ta përsërisë votimin.

Unë ju premtova që brenda dy jave e kemi mbledhjen tjetër dhe unë do i drejtohem me shkrim MAPL-së për interpretim ligjor dhe atë interpretim ligjor do e sjellë këtu në Kuvend dhe do ta konsultojmë, pra do të veprojmë sipas atij vendimi të Ministrisë, unë tjetër gjë s'mund t'ju ofroj juve, andaj ju lus që të vazhdojmë rendin e ditës.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, ti i nderuar Kryesues, me vetë faktin që MAPL ta ka dërguar interpretimin je duke e shkel Rregulloren, nuk lëshon ajo brenda mandatit tënd interpretim dy herë se për interpretim ke pyet njëherë për z.Demokrat Hodollin ngase njëherë nuk na keni lënë anëtar në Komitetin për Komunitete dhe Ministria e ka dërguar interpretimin, andaj qysh mund të kërkoresh sërish interpretim që nuk i takon Grupit prej 12 këshilltarëve një anëtar në Komitetin në fjalë, e ke vendimin nuk e di përse ta pyesësh sërish Ministrinë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, i kërkon ta lexoj atë vendim të MAPL-së.

**z.Ekrem Rrahmani, vazhdoi**, është detyrë e juaja Kryesues që ta lexosh atë përgjigje, dhe unë e di që e ke vendimin e MAPL-së, andaj nuk e di përse ta pyesësh sërish.

**Kryesuesi i Kuvendit**, i përgjigjet parafolësit duke theksuar se kjo është situatë tjetër, në atë kohë s'keni pas përfaqësues të partisë fare, pra nga LDK s'ka pas anëtar në Komitetin për Komunitete.

**z.Ekrem Rrahmani**, pyeti Kryesuesin, mendoj se është situatë e njëjtë, nëse jo përse nuk është njëjtë tani. Ai person ka përfaqësuar LDK-në dhe tani nuk është pjesë e LDK-ës më.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, z.Demokrat Hodolli është propozuar nga z.Valon Demolli që të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete dhe është votuar nga ky Kuvend,

**z.Valon Demolli**, ndërhyrë duke i thënë Kryesuesit se personi në fjalë nuk më pjesë e LDK-së.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, tani ai person është deklaruar që nuk është pjesë e juaja më, andaj tani duhet kërkuar interpretim ligjor se a duhet të tërhiqet edhe prej Komitetit për Komunitete, kështu që ju kisha lut të keni durim dy javë deri në mbledhjen e ardhshme sepse do ta zgjedhim këtë problem.

**z.Demokrat Hodolli**, theksoi, meqenëse po bëhet fjalë për mua, unë kisha kërkuar të mendoj deri në seancën e ardhshme, pra unë do të mendoj edhe këtyre ua kthej një përgjigje me shkrim, mirëpo në qoftë se këta asesi nuk mendojnë, mua nuk më ka mbet tjetër veç se t'ju them si z.Glauk Konjufca, hajde matemi bre shkojmë në zgjedhje, hajdeni me mua matuni, tjetër s'po di çka t'ju them unë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani kemi një propozim të z.Demokrat Hodollit për kompromis, pra kërkohet t'i jepet kohë ndoshta edhe për të dhënë dorëheqje, nuk kemi nevojë që të zgjidhim situata të tilla me presion.

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues, ka 3 muaj që është kjo punë, duhet me liru vendin, kështu që le të bëhet burrë e të japë dorëheqje, ai vend është i LDK-së dhe ky nuk është më pjesë e LDK-së, për interesa të tij ky e din arsyen e vet pse ka dalë nga LDK-ja dhe duhet t'ia liroj vendin LDK-së, do të shkoj një anëtar i LDK-së në atë Komitet dhe jemi në rregull.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, vetëm ju lutem që në fjalorin e shprehur të mos vije puna për ta larguar ndokënd nga kjo mbledhje e Kuvendit, ju lutem mos të fliten fjalë që nuk na kanë hije neve ngase na shikojnë 30-40 mijë banorë të Komunës së Podujevës, dhe jemi pasqyrë e tyre.

**z.Valon Demolli**, theksoi, po lexoj, kur anëtari i Komitetit për Komunitete kalon në ndonjë etnitet tjetër politik zëvendësohet me anëtarin tjetër të të njëjtit subjekt politik të cilit i ka takuar përfaqësimi në rastin e zgjedhjes, nuk e di çka po dëshiron ti i nderuar Kryesues kur e ke edhe vendimin e MAPL-së për rastin kur nuk na keni përfaqësuar fare në atë Komitet.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, unë tashmë e kuptova që paska një ngërç këtu në këtë çështje, një ngërç që posa më informuan që doli në votim dhe nuk ka kaluar, është një propozim që ka lind prej Grupit parlamentar të LDK-së, për ta ndërruar një asamblistë i cili është zgjedhë me votat e kësaj asambleje, pra zgjedhja e tij është bërë nga ju asambleja e Komunës së Podujevës. Personi në fjalë për tu larguar prej Komitetit për Komunitete janë dy rrugë, në fakt janë tri rrugë, por atë të tretën nuk desha ta them, pra e para me dorëheqje, rruga e dytë me proces të votimit për shkarkim, dhe e treta kur njeriu nuk është më, këto tri rrugë janë, s'ka rrugë tjera më.



Etniteti politik edhe asamblisti i pavarur kujtoj që kanë dallime, ju disa jeni juristë këtu dhe mund ta interpretoni këtë ose të kërkon interpretim gjyqësor, z.Demokrat Hodolli nuk është etnitet politik sepse nuk ka kaluar në ndonjë subjekt politik, por z.Demokrat Hodolli është asamblist i pavarur, të paktën kështu janë deklaruar, dhe njerëzit e pavarur e kanë të drejtën e përfaqësimit brenda për brenda një përfaqësimi të Komitetit për Komunitete.

Ky është i zgjedhur prej juve, ju e keni zgjedhur, ju e keni votuar, e për ta shkarkuar z.Demokrat Hodollin bëni votat brenda dy ore dhe futeni si pikë të jashtëzakonshme në rend të ditës mirëpo sot nuk paska kushte më sepse ju e keni hedh në votim këtë propozim dhe nuk mundet brenda një seance të rrëzohet një propozim dhe brenda të njëjtës seance i njëjti propozim të kthehet edhe njëherë sepse ju e dini, të paktën z.Naim Çunaku e din që është shkelje e Rregullores së punës së Kuvendit. Nuk është bërë nami e as kiameti nëse çështja e z.Demokrat Hodollit sipas juve të mbetet në seancën e radhës të diskutohet, është mirë dhe domosdoshmëri të kërkohej interpretim ligjor prej Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, njëri prej juve po thotë se ka interpretim ligjor dhe nuk po delta lexon atë andaj nëse ka interpretim ligjor le të dalë ta lexon para opinionit publik dhe ta dinë edhe qytetarët se çka është ajo letër që ky e paska e ne nuk e kemi.

Andaj unë po them se nuk është në rregull sot të bllokohen punët e Kuvendit për këtë çështje, ai Komitet për Komunitete nuk është diçka i jashtëzakonshëm dhe që është ndonjë vendimmarrës që e çrregullon komplet punën e kësaj asambleje, dhe pyes a ka diçka për të votuar sot ai Komitet që është shumë e rëndësishme e që duhet domosdo z.Demokrat Hodollin me heq nga ajo përbërje, se besoj që ka, përndryshe nëse jeni ardhë me blloku punën e Kuvendit dilni e tregoni qytetarëve që po dëshironi ta bllokoni punën e Kuvendit, mirëpo ju e dini që puna e Kuvendi nuk bllokohet për gjëra të tilla, Kuvendi bllokohet nëse bëhet shkelje e Rregullores së Punës në proces të votimit, kur dihet numri i votave dhe nuk respektohen ato vota, për raste të tilla mund të bllokohet Kuvendi, ndërsa në anën tjetër ju e dini që kemi përvoja që puna e Kuvendit nuk mund të bllokohet sepse e zhbllokojmë por nuk është mirë të kërkohej rrugë alternative për ta zhbllokuar punën e Kuvendit sepse ai zhbllokohet dhe se për ato përvoja ju jeni në dijeni sepse i kemi marrë prej juve dhe prej të tjerëve që kanë ndodhur në nivelet tjera.

Andaj shumë sinqerisht po ju lus si përfaqësues të qytetarëve që jeni këtu, të na lejoni të zhvillohen punimet e Kuvendit, propozimin e juaj e keni hedh në votim dhe ai propozim nuk ka kaluar me votë, mbetet si obligim që Kryesuesi i Kuvendit pas kësaj seance të bëjë një shkresë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, t'ju tregoj qysh është situata, jo që z.Demokrat Hodolli ka kaluar në ndonjë etnitet tjetër politik sepse nuk ka kaluar, por t'ju tregoj që z.Demokrat Hodolli është propozuar nga LDK dhe është votuar nga gjithë asambleja e Kuvendit sepse nuk keni votuar vetëm ju por e kanë votuar edhe të tjerët. Tani nëse ju dëshironi të dilni mbi votën dhe të pengoni votën dhe vullnetin e asamblesë atëherë trimave përpara nuk i'u dilet e as nuk ka që i ndal, bëjeni nuk ka kurrfarë telashe, por të drejtë ta bëni këtë nuk keni përderisa nuk kemi interpretim ligjor, prandaj për atë arsye është Kryesuesi i Kuvendit këtu i cili i adresohet me shkresë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për situatën konkrete, e jo për atë që na ka treguar para 6 muajve ose para 2 viteve, pra kemi të bëjmë me situatën konkrete sepse fjala është për situatën konkrete.

Asamblisti i respektuar (z.Demokrat Hodolli) nuk e besoj se e ka jetike atë pozitë aty, ama qysh të ndërrohet pa vota përbërjen e Komitetit për Komunitete, më tregoni ju mua, përndryshe nëse ju keni formë qysh ta detyroni atë të tërhiqet me zor, bëjeni por se besoj që me zor mundeni me shti njeriun të japë dorëheqje, kurse me qejf ky po thotë jo deri sa nuk merret vendimi ligjor, pra ky po thotë jo, prandaj ju duhet ta respektoni edhe mendimin e tij individual por edhe shumicën e votimit që u bë në këtë asamble. Kështu që nuk më duket shumë as e njerëzishme, as reale e as e momentit për ta penguar punën e Kuvendit, nëse dëshironi ta pengoni punën e Kuvendit tani si të dilni nga

këtu kjo zhbllkohet sepse mbeten 18 anëtar/e prezent e që për momentin nuk po e di a janë apo jo i nderuar Kryesues, pra nëse dëshironi me blloku punën e Kuvendit ju dilni nuk ka problem se nuk ju ndal askush është e drejtë e juaja ta bllokoni ose jo punën e Kuvendit, ne me zor askënd nuk e mbajmë këtu prezent në sallë, mirëpo mos justifikoni gjëra të cilat nuk qëndrojnë.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, kjo çka potencoj Kryetari i Komunës nuk është asgjë relevante me situatën sepse këto janë gjëra të gjithë ne i dimë dhe ajo që dimë është se para tri viteve kur keni shkuar në rrugën e njëjtë dhe e keni përjashtuar Grupin parlamentar të LDK-së nga Komiteti për Komunitete, MAPL e kthyer përgjigjen negative. Nuk po tenton këtu askush të dalë mbi votë e nën votë, por është duke u interpretuar një Rregullore e cila thotë se Grupit parlamentar i takon përfaqësimi në Komitetin për Komunitete, në këtë rast asamblisti që ka dalë nga Grupi i LDK-së nuk është më pjesë e tij dhe Grupi parlamentar i LDK-së nuk është i përfaqësuar në Komitetin për Komunitete, prandaj ne po e duam pjesën që na takon, ose edhe të jetë ai pjesë e Komitetit për Komunitete por të rritet numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete sepse sipas Rregullores kjo është e lejuar, kurse ne po duam vetëm përfaqësim tonë si Grup, ne nuk duam as me mbi votuar e as me nën votuar, por po duam vetëm diçka që është përcaktuar me Rregullore që si Grup parlamentar të kemi përfaqësim që për momentin nuk e kemi.

Keni një interpretim ligjor më herët, sepse Kryetari i Komunës e tha që nuk e di çka ka qenë më herët, por e dimë ne që keni votuar për ta anashkaluar LDK-në dhe e kemi dërguar vendimin në MAPL e cila e ka kthyer interpretimin se ne duhet të jemi të përfaqësuar e pastaj kur ka ardh vlerësim ju keni votuar që edhe ne ta kemi përfaqësues në atë Komitet e i cili tashmë nuk është përfaqësues i LDK-së, pra përgjigjja dihet dhe qysh të doni interpretojeni situatën, nëse i thau MAPL-së që Grupi i LDK-së nuk ka përfaqësim se ai anëtarë nuk është pjesë e LDK-së më, ajo atë e kthen mbrapsht sepse e ka kthyer njëherë vlerësimin, e ai vlerësim dihet.

Ose është rruga tjetër që seanca nuk vazhdon sot por pasi që MAPL ka thënë se duhet një javë kohë për interpretim, dërgojeni kërkesën në MAPL, shtyjeni këtë seancë deri sa të vijë interpretimi nga MAPL, ne vijmë për çdo javë në qoftë se është nevoja.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, e para, nuk është e vërtetë dhe askush nuk e ka përjashtuar LDK-në prej Komitetit në fjalë, kjo është gënjeshtër dhe nuk është ashtu, e vërteta është se nuk keni dashtë të jepni propozim, është e drejtë e juaja dhe sa e di dhe sa më kujtohet ka mbet vendi i lirë për LDK-në, por nëse ju nuk e keni pas vullnetin ta dërgoni përfaqësuesin e juaj është e drejtë e juaja ajo, ne absolutisht nuk ua imponojmë atë të drejtë.

Parafolësi e tha, nuk ka relevancë, tani varet qysh e shikon ai relevancën dhe çka nënkupton me relevancë, nëse ai si pjesë e kësaj asambleje ka kërkuar fjalën në fillim të kësaj seance dhe ka ngritë dorën për ta propozuar këtë pikë të rendit të ditës dhe ky propozim nuk ka kaluar si pikë e rendit të ditës, të mos kërkohet diçka e njëjtë brenda kësaj seance sepse kjo nuk bëhet, madje këtu prezent keni persona dhe koleg me përvojë që mund ta interpretojnë që nuk ka kaluar ai propozim në procesin e votimit, dhe nuk mund të kthehet edhe njëherë në ri-votim ai propozim, nuk bëhen këto gjëra kështu.

Këtë propozim mund të kërkosh ta fusësh si pikë të rendit të ditës në seancën e radhës, ose nëse veç ju duhet ashtu le të kërkohet interpretimi ligjor sepse është Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal që e jep interpretimin ligjor, jo ti e as unë, le të kërkohet interpretimi ligjor pastaj e thërrasim mbledhjen e jashtëzakonshme nëse veç kaq i rëndësishëm qenka ky zëvendësim, dhe në momentin që sjellët interpretimi ligjor prej Ministrisë ne po e thërrasim një mbledhje të jashtëzakonshme dhe po e shkarkojmë z.Demokrat Hodollin nga përbërja e Komitetit të cekur.

Unë votën nuk ua japë, sërish po ju tregoj që me Grupin tim në çfarë do rrethane nuk ua japë votën për shkarkim, por nëse është vendimi ligjor që duhet respektuar atëherë ju i keni votat, i bëni votat

dhe e zëvendësoni atë, ose përndryshe duhet lutur zotëri Hodollin e që është në vullnetin e tij të lirë të tërhiqet nga ai Komitet ose jo. Pra z.Demokrat Hodolli është veç asamblist i pavarur dhe nuk ka askush që i jep epitet tjetër këtij personi derisa ky vet vullnetarisht nuk lëvizë në atë ose këtë subjekt, është vetëm i pavarur.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, nëse ka harruar Kryetari i Komunës si ka qenë, unë mund t'ia rikujtoj, është votuar Komiteti për Komunitete dhe Ministria përkatëse e ka kthyer vendimin, është dashtë znj.Mimoza Abdullahu të jep dorëheqje dhe të zëvendësohet me z.Demokrat Hodollin, pra është tërheq ajo dhe ia ka liruar vendin këtij, i njëjti interpretim është, znj.Mimoza Abdullahu nga radhët e PDK-së ia ka liruar vendin z.Demokrat Hodollit.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, i sqaron parafolësit duke theksuar se znj.Mimoza Abdullahu është në entitet politik sepse përfaqëson një entitet politik, pra të mos barazohet kjo sepse zotëri Hodolli është i pavarur.

**z.Ekrem Rrahmani**, vazhdon, qysh është e mundur që z.Demokrat Hodolli si i pavarur ka të drejtë të jetë përfaqësues në Komitet, kurse ne 12 këshilltarë të LDK-së nuk kemi të drejtë, a ka mundësi të më shpjegoni këtë, pra qysh ky person fikall vetëm si i pavarur ka të drejtë të jetë në atë Komitet kurse ne entitet dhe Grup me 12 anëtarë nuk kemi të drejtë.

Çështja tjetër, qysh po thua ti Kryetar, atëherë ne nuk kemi çka të kërkojmë këtu fare nëse keni më shumë vota. Ku po mbetet demokracia.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, duke i'u drejtuar parafolësit theksoi, çfarë të bëjë unë këtu, unë këtu kur s'kam faj, qytetarët ju kanë sjellë këtu ku jeni. Demokraci është vota, ai që e ka një votë më shumë ai e kryen demokracinë dhe i'u ec punëve të veta, këta të tjerët nëse dëshirojnë t'ju mbështesin mbrapa në rregull, nëse nuk duan lirojnë rrugë dhe presin deri sa t'iu vije radha.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, nuk mundet ashtu siç po thua ti Kryetar sepse janë votuar disa ligje më parë, e din ti Kryetar.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, dëgjomëni mua, ta pengoni punën e Kuvendit mundeni, të bëni probleme mundeni nuk jua ndalon askush këtë punë, por ta keni parasysh se e keni hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës dhe nuk ju ka kaluar me vota, priteni seancën tjetër, krejt çka mund të bëjmë lëshim për qejfin dhe hatrin e juaj po e bëjmë këtë kërkesë, pra po dakordohemi dhe po bëjmë kërkesë në institucionin përkatës për të na treguar ligjshmërinë e kësaj çështje. Dallimi është substancial, ky (z.Demokrat Hodolli) është personalitet, është individ, është një, është i pavarur dhe nuk ka entitet politik dhe këtë zbrazëti që e krijon ligji këtu z.Naim Çunaku i din shumë mirë këto gjëra që interpretimin e bënë ai organ që i ka nxjerrë e ai organ është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, prandaj hapni rrugë procesit, le të ec procesi, përndryshe mund të flasim sa të dëshironi për këtë punë, nëse keni mbetur në këtë pozitë, që dëshironi, meqë ne LVV i kemi dy anëtarë në atë Komitet, ju bëjmë edhe juve dy anëtar në atë Komitet nëse dëshironi, por pas kësaj nëse veç e fitoni këtë, unë jua jap edhe një anëtar timin dhe bëni dy anëtar, nuk ka telashe, ose mund ta dërgojmë tek subjekti i znj.Mrika Thaçi, fare nuk ka telashe kjo punë.

**z.Qendrim Softolli**, nga vendi ndërhyrë duke theksuar, Kryetar të lutem mos e banalizo temën.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, vazhdoi, nuk po e banalizo dhe shumë sinqerisht po foli, nëse juve kjo situatë është aq shumë duke ju penguar, a kemi diçka për të votuar sot e që ka të bëjë me këtë problematikë, jo nuk kemi dhe tani nuk është fer që 12 asamblist të këtij Kuvendi ta bllokoni shumicën e këtij Kuvendi dhe të mos lejoni zhvillimin e punimeve të këtij Kuvendi sepse po ju tregoj që dilni keq para opinionit dhe unë e kam për obligim për aq sa mundem t'ju ruaj, unë nuk mund t'ju ruaj gjithë por sa kam mundësi t'ju ruaj do të mundohem t'ju ruaj mos me dalë keq ngase kemi punuar relativisht mirë dhe shumë procese të rëndësishme bashkërisht i kemi çuar

përpara, kanë mbet edhe disa. Unë e di që jemi në prag të fushatës zgjedhore por nuk kemi çka të bëjmë tash sepse këto janë procese të cilat janë krijuar nganjëherë me qejf, nganjëherë me dashje e nganjëherë pa dashje.

Lejoni që të zhvillohen punimet e seancës së Kuvendit, kërkojmë interpretim ligjor, na vie interpretimi për këtë çështje. Pra ne e shkruajmë një shkresë sepse tani jemi duke diskutuar për rastin konkret dhe për situatën konkrete e që për mendimin tim dallon prej rastit të mëparshëm, ky është mendim i imi nuk do të thotë që kam të drejtë, por kam të drejtë ta shpreh mendimin ashtu siç po e shprehni ju, prandaj ju kisha lut shumë, hapni rrugë procesit le të ec procesi edhe vazhdojmë tutje pas një ose dy jave e thërrasim mbledhjen tjetër e që unë besoj që e kemi projektbuxhetin në seancën e radhës dhe brenda 10 dite ndoshta duhet ta thërrasim seancën tjetër për shkak të buxhetit, andaj deri në atë kohë po shpresojmë se do të na kthehet përgjigje nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe vazhdojmë tutje.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, të nderuar, ne fjalë pas fjale nuk mund t'i përfundojmë të gjitha kurrë, kështu që ta respektojmë Rregulloren dhe të vazhdojmë me mbledhjen.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, i nderuar Kryesues unë isha duke diskutuar dhe ma ndale fjalën dhe i'a japë Kryetarit, në rregull e respektova dhe e ndala unë fjalën time.

Një mundësi e ke i nderuar Kryesues, aty janë 7 anëtar, duhet të bëhen 9 anëtar, mund të propozohet edhe një anëtarë nga radhët e komuniteteve jo shumicë dhe e votojmë edhe një anëtar të LDK-së, askush nuk po të kërkon me heq z.Demokrat Hodollin meqë ia ka dhënë fjalën ai (Kryetari i Komunës) se askush nuk do të shkarkoj sepse nuk kanë vota, pra le ta mbanë fjalën ai tani, të shtohet edhe një anëtarë nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Komitetin për Komunitete dhe një anëtarë nga radhët e LDK-së, bëhen 9 anëtar dhe jemi në rregull, askush nuk është kundër z.Demokrat Hodollit sepse nuk është bërë nami që ka dalë ai prej LDK-së që ne tani ta heqim, mirëpo propozoni edhe dy anëtar, një nga radhët e komuniteteve jo shumicë dhe një nga radhët e LDK-së dhe jemi në rregull, asgjë më shumë nuk po kërkojmë.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, përgjigje parafolësit theksoi, nuk ka shumë relevacë a i kam dhënë fjalën apo jo, por ju e dini që unë e mbajë fjalën, të paktën për këtë punë e dini që kur unë them ashtu ajo punë mbetet ashtu, dhe dashtë të ketë jetëgjatësi z.Demokrat Hodolli deri sa ta heq Shpejtim Bulliqi prej atij Komiteti, për këtë po ju tregoj se kurrë, ju e dini këtë punë por meqë po më detyroni edhe po jua them, për që e heq unë veç le të ketë jetëgjatësi deri ta heq unë, se kurrë nuk do ta heq.

Ju fitojeni këtë të drejtë në bazë të ligjit dhe procedurave që të keni një përfaqësues brenda atij Komiteti edhe pse zotëri Hodolli realisht prej juve është propozuar dhe votuar, krejt në rregull jemi, unë mbi ligjin nuk jam sikurse që nuk jeni as ju, prandaj anëtari i Kuvendit z.Demokrat Hodolli në çfarë do rrethanash se besoj që lëviz nga aty përveç nëse ai vet dëshiron të largohet e që është diçka tjetër sepse unë nuk e detyroj të qëndron në atë Komitet.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, këtu u bisedua për variante të ndryshme mirëpo nga kjo situatë mund të dalim vetëm duke e pritur interpretimin ligjor nga MAPL, po sa të vije interpretimi ligjor do ta zëvendësojmë edhe z.Demokrat Hodollin sepse ligji e zëvendëson ngase nuk është i pa zëvendësueshëm, por tani kompromise tjera nuk mund të bëjmë sepse pika / propozimi nuk kaloi në Kuvend, pra nuk është votuar dhe për sot kjo çështje ka marrë fund.

Do të presim një javë dhe sigurisht do kthehet interpretimi ligjor me të cilin do t'ju njoftoj si parti politike duke jua dërguar nga një kopje dhe në mbledhjen e ardhshme do e fusim si pikë të rendit të ditës e që nuk është e thënë ta votojnë të gjithë por ata që nuk dëshirojnë ta votojnë mund të abstenojnë dhe kalon si zëvendësim, zgjidhje tjetër nuk ka, por ju lus që të vazhdojmë me mbledhjen edhe kjo çështje do të zgjidhet, me mënyra tjera nuk zgjidhet, unë tjera kompromise

nuk bëj, propozimi për sot kanë marrë fund sepse ka përfunduar votimi, ju mund ta ndërpreni mbledhjen kurdo që ta lironi sallën.

I nderuar Ekrem Rrahmani, ne biseduam gjatë me shefat e Grupeve, shefi i Grupit të LVV-së dhe ai i PDK-së e jepen mbështetjen nëse vjen përgjigjja e MAPL-së sepse askush nuk e shkel ligjin, as për zotëri Hodollin e as për cilin do qoftë. Pastaj kjo temë për herë të parë është diskutuar në Kuvend e jo që 6 muaj që thoni ju zotëri Rrahmani, kurse çka keni biseduar ju në parti dhe nëpër kafiteri është diçka tjetër, kështu që ju kisha lutur edhe njëherë të na jepni kohë që në mbledhjen e ardhshme ta zgjedhim këtë problem.

**z.Qendrim Softolli**, theksoi, kjo çështje goxha edhe u banalizua direkt prej Kryetarit të Komunës, ti si Kryesues i Kuvendit e ke të njohur këtë situatë me muaj sepse ky djali (z.Demokrat Hodolli) nuk ka dhënë dorëheqje sot nga LDK, por ka dhënë dorëheqje që disa muaj dhe ti e din që duhet të jetë i përfaqësuar në Grupi, pa marrë parasysh a është i LDK-së, LVV-së apo cilido do subjekt tjetër, Grupi i anëtarëve të subjekteve politike duhet të jetë i përfaqësuar në këtë Komitet.

Ne nuk jemi ata që e kemi bllokuar seancën e as punimet sepse Kryetari i Komunës këtu deshti të na paraqes neve si bllokues, ky djali (z.Demokrat Hodolli) është bllokuesi, jo ne, kjo çështje është shumë e thjeshtë, ne po e kërkojmë një pozicion që na takon neve si Grup, asgjë tjetër, është e thjeshtë, nëse ky nuk është në vijë politike me LDK-në dhe politikat e LDK-së, përse po dëshiron t'i gëzoj benifitet e saj, ky nuk na përfaqëson neve më. I nderuar Kryesues i Kuvendit nuk e kemi personale me kolegun në fjalë, asgjë nuk kam personale me të, mirëpo ne po kërkojmë përfaqësim në një Komitet që na takon, kjo është dhe që e kemi një interpretim në fillim të mandatit rreth kësaj situate ku përgjigjja ka qenë që duhet të jenë Grupet parlamentare të përfaqësuara në Komitetin për Komunitete, ne jemi Grup parlamentar që për momentin nuk jemi të përfaqësuar, aty shkruan Grupet e jo individët, pra Grupet parlamentare e ne e dimë qysh formohen Grupet parlamentare, përndryshe nëse ka Grup ky djali jemi në rregull dhe të vazhdoj të qëndroj në atë Komitet, por edhe ne duhet ta kemi një përfaqësues në Komitetin për Komunitete.

**Kryesuesi i Kuvendit**, përgjigjet parafolësit duke theksuar se situatë tjetër ka qenë në atë kohë që ju po i'u referoheni, pastaj këtë çështje nuk e keni përmend e as sjellë asnjëherë në Kuvend. Ne po e kuptojmë dhe të gjithë e dimë, por nuk po duam ta pranojmë se anëtari edhe shkarkohet dhe zgjidhet me votë, kjo duhet të jetë shumë e qartë për të gjithë ne, ne kundër votës nuk mund të dalim, kjo është.

**z.Qendrim Softolli**, vazhdoi, ti Kryesues vetëm një gjë tregoj asamblistëve që është e drejtë ligjore që të jenë të gjitha Grupet të përfaqësuara në atë Komitet, këtë bëje me dije kurse a votojnë ose jo asamblistët ajo është çështje tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit**, sërish i reagon parafolësit duke theksuar se ne këtë propozim e vëm në votim njëherë, ai propozim ishte.

**z.Qendrim Softolli**, sërish vazhdon, e hedhe në votim Kryesues mirëpo nuk ju tregove, por i qite në lajthitje dhe e ke luajtur njëfarë loje sepse vet ti jashtë Kuvendit ju ke thënë kolegëve të mijë që keni të drejtë kurse sot këtu i ke qit në një pozicion tjetër e që nuk është pozicioni i pa lakmueshëm për neve, pozicioni i pa lakmueshëm është për atë personin e jo për neve, dhe e din se nuk ka asgjë personale dhe e din se kjo situatë nuk është tani, është me muaj, kështu që ke përgjegjësi sepse e ke një interpretim zotëri Kryesues.

**Kryesuesi i Kuvendit**, duke i reaguuar sërish parafolësit, theksoi, tjetër situatë ka qenë më parë dhe nuk e keni sjellë këtë çështje asnjëherë në Kuvend, tjetër situatë ka qenë atëherë për çka po flisni ju sepse në atë situatë nuk keni pas përfaqësues fare në Komitet.

Të nderuar, tjetër nuk kemi çka të diskutojmë por po vazhdojmë me rendin e ditës.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, është mirë të tentohet të vazhdohet seanca dhe është mirë të vazhdoj seanca, edhe ju e dini se është mirë të vazhdoj seanca, vendimet e Kuvendit të Komunës janë vendime që merren me vota, nuk janë unanime, një votë e ndryshon procesin, ju e keni vënë në votim propozimin e juaj dhe keni humb, pritni seancën e radhës, pritni interpretimin ligjor që vjen nga instancat kompetente e mos e pengoni procesin, përndryshe unë mendoj i nderuar Kryesues i Kuvendit që të mos shpenzohet kohë koti për këtë çështje por të vazhdohet me seancën, nëse dëshironi të jeni pjesë e seancës jeni të mirëseardhur sepse për këtë keni ardh këtu dhe paguheni për këtë, nëse nuk dëshironi ne me zor askënd nuk e ndalim këtu, ne duhet me vazhdojmë me punë sepse nuk kemi kohë për të humbur.

**z.Arjant Topanica,** theksoi, mendoj që këto shaka të Kryetarit të Komunës nuk na çojnë askund dhe vetëm e prishin më shumë situatën, ne nuk po kërkojmë asgjë me na falë, por po kërkojmë vetëm diçka që na takon dhe ne po kërkojmë një mjet demokratik që për një të drejtë tonën do të luftojmë për ta mbrojtur andaj nuk do e lëmë seancën të vazhdoj. Kur të vjen interpretimi e marrim atë dhe vazhdojmë, prandaj nuk jemi këtu për të na falë as një anëtarë e as dy anëtar, dhe as me na e falë atë vend, por vetëm atë që na takon, e jo të bëhet shaka me këto nënvlerësime sepse nuk shkon askund ngase nuk janë as etike e as njerëzore.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, ajo që ky djali (z.Arjant Topanica) po e thotë po i tregon opinionit publik që ti po dëshiron me dhunë të ndalësh punën e këtij Kuvendi, ashtu po i bie, kjo formë është me dhunë, ju e dini shumë mirë LDK-ja qysh ka ikë dhe me të tjerët i ka mbajtur mbledhjet lartë, pra edhe unë kam qenë deputet dhe së bashku me ata kam dalë.

Nuk do të ishte rrugëzgjdhje ajo sepse edhe ndodh, nëse nuk sot ndodh sot, ndodh nesër, por nuk është mirë ta përjashtoheni veten prej këtyre gjërave, prandaj leni këto gjëra zbatoheni ligjin për të cilin jeni të thirrur për ta zbatuar, pritni rregullativën ligjore, t'ju jepet ligjshmëria, shfrytëzoni të drejtat e juaja askush nuk jua ndalë të drejtën. Ndërsa nëse tentoni me forcë të zbatoni të drejtat e juaja, pa votë të kësaj asambleje harrojeni se ajo nuk bëhet, nëse doni merrni të gjitha këto pajisje dhe pastaj shkoni nëpër shtëpitë e juaja me to në dorë, por kjo nuk është e drejtë e juaja, ju nuk keni të drejtë ta bllokoni punën e seancës e të këtij Kuvendi, askush, ne mund të bashkëbisedojmë deri në mbrëmje por mendoj se kjo temë nuk ka nevojë të zgjatet më shumë fare.

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, ti Kryetar po thua votoni një pazar që e ke bërë me një njeri e ju shkoni prej shtëpie se ju nuk jeni asgjë, kjo i bie se ne nuk kemi marrë vota, do të thotë më i vlefshëm qenka një person se sa 12 persona tjerë, pazarin tënd nuk e votoj Kryetar.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** duke i'u përgjigjur parafolësit theksoi, nuk je duke votuar për mua, voto për veti nëse të duhet të votosh sepse nuk po të them as votoje as mos e voto, unë vetëm po të tregoj që unë ato që i bëj i mbroj, por i mbroj ligjërisht, jo jashtë ligjit sikurse ti, unë me ligj po punoj, ti po mundohesh me dalë mbi ligjin, nëse ti del mbi ligjin dil dhe vazhdoje.

**z.Ekrem Rrahmani,** sërish ndërhyr duke theksuar që është shkel Rregullorja sepse neve na takon të kem anëtarin tonë në Komitet.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** i përgjigjet parafolësit, theksoi, kush e ka shkel Rregulloren e punës, a e keni propozuar ju, me propozimin e juaj a ka shkuar personi në fjalë aty në Komitet për Komunitete, a e keni dërguar z.Demokrat Hodollin në atë Komitet, çfarë faji kam unë këtu që nuk jeni në gjendje të menaxhoni Grupin e juaj, cili është problemi im këtu, çfarë përgjegjësie kam unë këtu, këto janë dobësi tuaja.

**z.Ekrem Rrahmani,** ndërhyrë duke theksuar se ne jemi mësuar me kësi tradhtarësh sikur ti, së pari je tradhtar ti e pastaj ky e me radhë kështu, kurrë nuk ndalen tradhtitë këtu.



**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** i përgjigjet parafolësit, theksoi, ti gjithë kohën ke hangër (ngrënë) në “grazhd” të Hashim Thaçit kurrë tradhtarë nuk të kam thënë deri sot, edhe tash ende je tu hangër, kurse unë me Hashimin nuk kam pas asgjë, kurrë nuk kam tradhtuar sa kam qenë aty,

**z.Ekrem Rrahmani,** sërish ndërhyrë duke theksuar, po ti je tradhtar, ti ke thënë Çakorri, Çakorri.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** sërish vazhdon duke i’u drejtuar parafolësit që ti ke hangër aty unë jo, prandaj...

**z.Qendrim Softolli,** i drejtohet Kryetarit të Komunës duke theksuar, jo jo nuk mundesh me fol me këtë gjuhë.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** vazhdoi, unë jam duke ju treguar juve se ju mund t’i fitoni të drejtat në këtë Kuvend vetëm me ligj edhe me votë.

**z.Ekrem Rrahmani,** sërish i drejtohet Kryetarit të Komunës, ti je tradhtar.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** duke i reagu parafolësit theksoi, po unë nuk bëhem tradhtar veç se thua ti, ti nuk e din as çka është tradhtari, por nuk bëhem qysh thua ti.

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, ti e ke tradhtuar shtëpinë tënde, ti je tradhtar, ke shkuar në AAK i ke marr 2 qind mijë euro dhe ke blerë banesa.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** sërish duke i’u drejtuar parafolësit theksoi, këta që po ju ikin për çdo ditë, këta kush po ju’a ikë, që po i menaxhoni për ditë, që po i “menaxhoni mirë”.

**z.Ekrem Rrahmani,** sërish vazhdon duke theksoi, ti je tradhtar.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** i reagon parafolësit, po ti deri dje i ke duartrokit Agim Veliut kurse sot po e shan Agim Veliun. Ti je tradhtar, sepse unë nuk po e shaj, por mos u bë ti sikur unë, ruaje vetën ti.

**z.Ekrem Rrahmani,** sërish duke reagu Kryetarit të Komunës, theksoi, jo nuk e shaj, ti je tradhtar, je uzurpator, të gjitha i ke.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** kërkon nga Kryesuesi i Kuvendit që ose të vazhdohet seanca sipas rregullave ose ndërpritet seanca.

**Kryesuesi i Kuvendit,** theksoi, ju rikujtoj se gjuha që është duke u përdorur prej disa asamblastëve është gjuhë denigruese.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetari i Komunës,** duke i’u drejtuar Kryesuesit të Kuvendit, theksoi, respektoje Rregulloren e punës, të mos ofendon ky pis.

**Kryesuesi i Kuvendit,** theksoi, edhe njëherë ofendon ndokush unë do e largoj prej mbledhjes.

**z.Ekrem Rrahmani,** i reagon Kryetarit të Komunës duke theksuar, këqyr kujt i thua pis ti, çka të kesh privat kallëzo, kujt i thua pis more legen more.

**Kryesuesi i Kuvendit,** theksoi, debati përfundoj, tani e vë në votim rendin e ditës, mjaft më Ekrem sepse kjo është e tepërt.

Për shkak të mungesës së kushteve e ndërpresë mbledhjen e Kuvendit, seanca shtyhet për një kohë të pacaktuar, arsyeja është që për problemet e juaja të kemi telashe.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetari i Komunës,** i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit duke theksuar se nuk ndërpritet seanca pa votën e shumicës së asamblastëve. Nuk mund ta ndërpritesh seancën pa e marrë pëlqimin e shumicës së asamblastëve, nuk mundesh me ndërprerë seancën pa votë dhe nuk je ti autoritativ që e ndërpre në seancën në këtë mënyrë, Kuvendi është ai i cili e ndërpre në seancën, jo ti Kryesues.

**z.Qendrim Softolli,** theksoi, i nderuar Kryesues, ti e dhe një konstatim.

**znj.Edona Shabani,** theksoi, Kryesuesi i Kuvendit e tha që seanca ndërpritet për një kohë të pacaktuar, faleminderit shumë.

**z.Haki Rudari,** theksoi, unë propozoj një pauzë 15-30 minuta dhe të kthehemi prapë në seancë.

**Kryesues i Kuvendit**, theksoi, atëherë e vë në votim propozimin e z.Haki Rudari që të shkojmë në një pauzë 15 minuta.

**z.Valon Demolli**, theksoi, ti i nderuar Kryesues pak më parë e ndërpreve seancën për një kohë të pacaktuar, tani çka po hedh në votim.

**Kryesues i Kuvendit**, përgjigje parafolësit, theksoi, seancën e ndërpreva shkaku juaj sepse keni përdor fjalë fyese.

**Kryesues i Kuvendit**, theksoi, pas 15 minutave kthehemi në sallë të Kuvendit, pra koha e pa caktuar që e potencova më herët është pas 15 minutave.

*Pas situatës së krijuar, Kryesuesi i Kuvendit në ora 14:10, me arsyetimin për mungesë të kushteve për zhvillimin e punimeve, ndërpre në seancën dhe njëkohësisht cakton kohën e vazhdimit të seancës duke ftuar anëtarët e Kuvendit që të kthehen pas 15 minutave në sallë për të vazhduar me mbledhjen, përveç nëse në ndonjë formë tjetër ju njoftoj ndryshe.*

### **Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 15:25.**

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.

(Nga LDK Valon Demolli; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani.

Nga PDK, Endritë Murati; Mimoza Abdullahu.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Të pavarur, Demokrat Hodolli;

Gjithashtu të pranishëm në mbledhje ishin, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

*(Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Alban Zeka-Drejtorja e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR).*

Të pranishëm tjerë ishin edhe përfaqësues të mediave lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, po fillojmë me vazhdimin e mbledhjes, debati rreth rendit të ditës ka përfunduar andaj kush është që të punohet me rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës si dhe propozimit të mbështetur në fillim të mbledhjes.

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues, ne kemi një kërkesë nga fillimi i mbledhjes, kështu që nuk mund të vazhdohet mbledhja kështu, për po nxitë Kryesues..

**Kryesuesi i Kuvendit**, përgjigje parafolësit theksoi, nuk jam duke nxitur asgjë, në temën e cekur nuk kthehemi sepse ka përfunduar debati dhe nuk kemi më çfarë të diskutojmë, kështu që vazhdojmë me mbledhjes, ju i keni masat e juaja, unë i kam masat e mia dhe vazhdoj.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 16 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan) miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së si dhe propozimet që u përkrahen në fillim të mbledhjes për heqjen e një pike të rendit të ditës (pika 9 së bashku me nënpikën 9.1)*

### Rendi i miratua i ditës:

1. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 korrik 2024
2. Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025.
3. Propozim vendim për transferimin e buxhetit të komunës për vitin 2024.
4. Propozim vendim për hartimin e planit zhvillimor të Komunës së Podujevës.
5. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës.
6. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-437-1, ZK Podujevë.
- 6.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
7. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-704-0 dhe P-706-0, ZK Llapashticë e Poshtme.
- 7.1 *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.*
8. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1615-4, ZK Orllan.
- 8.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.*
9. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1119-0, ZK Balloc.
- 9.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.*
10. *Të Ndryshme*

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues ose ma jep fjalën ose ne e lëshojmë sallën dhe mbeteni pa kuorum, nga mëngjesi nuk je duke na marrë parasysht fare neve.

**Kryesuesi i Kuvendit**, i përgjigjet parafolësit duke theksuar që në rregull është mund ta lëshoni sallën, është punë e juaja, vetëm kaloni mirë, unë nuk ndalem.

### Grupi i këshilltarëve të LDK-së lëshon sallën

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, pas që u larguan Grupi i LDK-së nga mbledhja, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën. Në fakt rendi i ditës u miratua paraprakisht, dhe nuk besoj se ka nevojë për pauzë.

**z.Haki Rudari**, theksoi, në këto zhvillime natyrisht se jemi kundër dhe ne e kundërshtojmë, po ashtu edhe zhvillimet e ndodhura më herët në emër të Grupit të LVV-së i kundërshtoj dhe kërkoj që ato të mos përsëriten. Në të njëjtën kohë kërkoj që Rregullorja e punës së Kuvendit të është e njëjtë për të gjithë këshilltarët komunal.

në këto rrethana ne duhet të shikojmë sa është numri i këshilltarëve që janë prezent dhe a janë 18 prezent, si dhe në të njëjtën kohë unë propozoj një pauzë 15 minuta në mënyrë që të vazhdohet sërish seanca.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në mungesë aktuale të kuoromit, e jap një pauzë për rreth 5 minuta deri sa të bëhet kuorumi, kështu që do të ishte mirë të qëndrojmë në sallë dhe të presim vazhdimin e mbledhjes.

*Në mungesë të kuoromit, Kryesuesi i Kuvendit jep pauzë 5 minuta derisa të bëhet kuorumi në mënyrë që të vazhdohet me mbledhjen.*

## **Pas një pauze të shkurtër, mbledhja vazhdoi duke filluar në ora 15:40**

*Prezent në vazhdimin e mbledhjes janë 27 anëtar/e të Kuvendit përfshirë këtu edhe grupin e LDK-së që paraprakisht lëshoi sallën.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, vazhdojmë sipas rendit të ditës, tani kemi pikën e par të rendit të ditës që është Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 korrik 2024. Edhe njëherë e përsërisë që debati për temën që Grupi i LDK-së po e kërkoni fjalën ka përfunduar dhe nuk kemi çka të diskutojmë më, kështu që vazhdojmë me pikat e rendit të ditës sipas radhës dhe vetëm për pikat e rendit të ditës mund të kërkohet fjala tani.

### **1. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 korrik 2024**

**z.Illir Koprani**, theksoi, i nderuar Kryesues, unë do të jepja një propozim për daljen nga ky ngërç, e mos na qitni edhe neve në pozitë të palidhje e as të mos i lodhim kolegët.

Ju e potencuat që për dy javë Ministria e kthen përgjigjen, andaj po e shtyjme këtë mbledhje për dy javë, vjen përgjigjja edhe atëherë qysh të kthehet përgjigjja nga Ministria ne e pranojmë vendimin dhe jemi në rregull. Kemi ardh në një situatë që duhet të dalim prej saj, prandaj ta shtyjme këtë mbledhje për dy javë, vjen vendimi i Ministrisë dhe çfarë do vendimi që është edhe ju e potencuat që e pranojmë, edhe ne e pranojmë dhe jemi në rregull, kështu që nuk e shohë të arsyeshme vazhdimin e këtij diskutimi. Prandaj i nderuar Kryesues unë nuk shoh të keqe në këtë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, duke i'u përgjigjur parafolësit theksoi, edhe unë e bëra një propozim, mirëpo ju propozimin ton nuk e pranuat, pra propozimi im personal ishte se mbledhja e radhës është pas dy javësh dhe është shumë më e rëndësishme se kjo që është buxheti i Komunës.

Unë krejt po të kuptoj ty, por ne duhet të vazhdojmë me rendin e ditës.

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues, seanca nuk mund të vazhdoj, nuk po merret parasysh një e drejtë që i takon LDK-së e nëse veç nuk po doni me marrë parasysh kërkesën tonë për një vend që i takon LDK-së në atë Komitet, atëherë as seanca nuk mund të vazhdon.

Edhe njëherë e përsërisi i nderuar Kryesues që seanca nuk mund të vazhdon pa ardhur interpretimi ligjor nga ana e MAPL-së.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kërkesa juaj nuk ka të bëjë me këtë mbledhje, nëse në këtë mbledhje ju kanë shkelë të drejtat në mbledhjen e ardhshme merrem me këtë temë.

Tani po vazhdojmë me rendin e ditës dhe ju kisha lut për qetësi dhe mirëkuptim sepse të gjithë jemi të një vendi dhe nuk kemi nevojë për telashe, unë premtimin tim e mbaj.

Nuk kemi nevojë të diskutojmë më për këtë temë i nderuar Valon sepse prej orës 10:00 jemi duke debatuar për këtë çështje. Kështu që për të satën herë ju lus të vazhdojmë me mbledhjen, premtimin që ua dhashë do e mbaj.

**z.Qëndrim Softolli**, i ndërhyr duke theksuar që edhe ne i nderuar Kryesues po të lusim ty me mirësjellje.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, nuk kemi nevojë të diskutojmë më për këtë temë, të kryhet kjo mbledhje dhe kërkesa juaj në mbledhjen e ardhshme do të jetë pikë e rendit të ditës.

**z.Illir Koprani**, ndërhyr duke i'i drejtuar kryesuesit të Kuvendit që t'i me çdo kusht po dëshiron të prodhosh dhunë ose gjëra tjera të ngjashme.

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues, nuk mund të vazhdosh, madje ti je ai që na ke thënë se ju keni të drejtë dhe ne po e kërkujmë një të drejtë tonën, pra ti Kryesues vetë ke thënë.....

**Kryesuesi i Kuvendit**, pyetja parafolësin se kur e kam thënë unë që ju keni të drejtë.

**z.Valon Demolli**, duke i'u përgjigjur Kryesuesit, theksoi, ke thënë këtu në korridor edhe e din edhe ti që kemi të drejtë, është një vendim që kjo e drejtë i takon Grupit parlamentar të LDK-së. Andaj nuk bëhet nami të shqyhet kjo seancë për dy javë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, duke i'u përgjigjur parafolësit theksoi, njeriun e juaj e keni në atë Komitet, ai i LDK-së ka qenë, z.Demokrat Hodolli prej LDK-së ka shkuar në atë përbërje të Komitetit për Komunitete jo prej meje.

**z.Florent Hasani**, theksoi, i nderuar Kryesues, të lutem të kesh konsideratë për Grupin tonë sepse në këtë seancë nuk mund të merremi vetëm me një Grup parlamentar, asgjë nuk kam kundër kolegëve por të kemi konsideratë edhe ne.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, e vë në votim pikën e parë të rendit të ditës që procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 korrik 2024.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për, asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajtur (të tjerët nuk votuan) miratohet procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 korrik 2024, sipas materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

*(Në shenjë pakënaqësie për arsyet e lartcekura nga fillimi i mbledhjes, një pjesë e anëtarëve të Kuvendit nga radhët e LDK-së, në formë të protestës dalin dhe e zën foltoren e Kuvendit).*

*(Pas kësaj situate të krijuar, debateve, kërkesave dhe propozimeve të pandërprera mes anëtarëve të Kuvendit në përgjithësi dhe Kryesuesit të Kuvendit, diskutimet në vazhdim, konstatimet dhe proceset e votimeve për pikat e rendit të ditës janë nxjerrë nga incizimi tonik i mbledhjes si dhe ai me video-incizim, për aq sa ka qenë e mundur të nxirren duke i'u referuar rrethanave të krijuara)*

**z.Illir Koprani**, pse i nderuar Kryesues po dëshiron të na qitësh në pozitë të keqe pa pasur nevojë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, kjo që po bëni ju është imponim.

**z.Qendrim Softolli**, me mirësjellje po të lusim Kryesues të mos e vazhdosh këtë mbledhje.

**z.Arjant Topanica**, të shtyhet kjo mbledhje derisa të vij interpretimi i MAPL-së, pastaj ti Kryesues e thërret mbledhjen dhe vazhdojmë.

**Kryesues i Kuvendit**, duke i'u përgjigjur parafolësve, theksoi, po presim derisa të kryhet kjo mbledhje.

**znj.Lirika Maliqi**, kërkon nga Kryesuesi i Kuvendit të vazhdohet me mbledhjen.

**z.Qendrim Softolli**, i reagon parafolësës duke theksuar se nuk mund të vazhdoj e nderuar Lirikë, nuk vazhdon kjo mbledhje, ne e kemi një kërkesë dhe kompromis, të bëhet interpretimi nga Ministria dhe në momentin që kthehet përgjigja ne jemi këtu, kjo është shumë e thjeshtë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, ta vazhdojmë mbledhjen, nuk ka çka diskutojmë më për atë temë.

**z.Valon Demolli**, Kryesues ke çka diskuton, ndërprerje seancën, shtyje për dy javë deri kur të kthehet vendimi i Ministrisë dhe jemi në rregull.

**z.Florent Hasani**, i'u drejtohet anëtarëve të Kuvendit të cilët kanë dal në foltore duke theksuar, zotërinj nuk mundeni këtu të bëni skena si kauboj sepse po na qitni edhe neve në pozitë jo të lakmueshme. Përse për një pikë të rendit të ditës të mos kalojnë 10 pika tjera të rendit të ditës.

**z.Qendrim Softolli**, përgjigje parafolësit, theksoi, pse ne po kemi qejf të jemi në këso situatash a. Tani po ju dhemb një pikë e rendit të ditës a, hiç nuk më intereson ajo që e thoni ju, drejt po ju tregoj.

**z.Florent Hasani**, sërish ndërhy duke theksuar se ajo çështje në formë demokratike nuk kaloj, tash nuk e di në çfarë forme ju po dëshironi ta impononi këtë.

**z.Qendrim Softolli**, i reagon sërish parafolësit, theksoi, ju po folni për demokraci, i nderuar Florent mos na mbajë ligjëratat morale këtu, mos diskuto me mua por diskuto me Kryesuesin sepse ky për atë është i thirrur këtu.

**z.Valon Demolli**, i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit, z.Hilmi Hoxha përgjegjësi kryesor për këtë situatë je ti këtu.

**znj.Tringa Sfishta**, i nderuar Kryesues, të lutem shtyje seancën. Të lutem për t'i ikur kësaj situatë dhe këtyre gjërave banale që nuk janë të hijshme për ne, po flas për nivelin tonë si Kuvend, të shtyhet kjo seancë për një datë tjetër e mos të degradojmë deri në këtë nivel

**Kryesuesi i Kuvendit**, i përgjigjet parafolëses që seanca duhet të vazhdoj. Kërkesën e juaj e kemi përfill, propozimin e juaj e kemi hedh në votim, tani pse anëtari i juaj e ka lëshuar partinë ne nuk kemi faj.

**z.Valon Demolli**, reagim Kryesuesit, tani cili je ti, a ky apo ai jashtë që po na thua keni të drejtë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, reagim ndaj parafolësit, nuk të kam thënë zotëri Valon, gabim e ke, përndryshe kur jemi takuar ne të dy, unë qe tre muaj me ty nuk kam biseduar.

**z.Florent Hasani**, theksoi, i nderuar Kryesues, mikrofonin e ke dhe vetëm vazhdo me seancën.

**z.Qendrim Softolli**, reagim ndaj parafolësit, theksoi, mikrofonin nuk e ka, mikrofonin është i imi tani. I nderuar Kryesues të gjithë jemi duke të lutur, të mos bëhen skena këtu, me mirësjellje jemi duke të thënë.

**znj.Lirika Maliqi**, i kërkon Kryesuesit ta vazhdoj seancën.

**Kryesuesi i Kuvendit**, pyet Grupin e LDK-së, a e keni pasë një anëtar në atë Komitet.

**z.Arjant Topanica**, i nderuar Kryesues, qysh e thua që e kemi pas një anëtar në Komitetin për Komunitete ne Grupi i LDK-së, të lutem mos bë shaka.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH, theksoi, i nderuar Kryesues, mos harro që ti ke edhe një të drejtë që mund t'i përjashtosh ata të cilët e pengojnë punën e Kuvendit. Gjithë kohën këta po ankohen, a je Kryesues i Kuvendit apo jo, përdore të drejtën tuaj.

**z.Valon Demolli**, i reagon drejtorit parafolës duke theksuar se a po e thua këtë kur po është ai Kryetari yt këtu prezent dhe që po ofendon, apo vetëm Kryesuesit po i thua a je Kryesues a jo.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, Kryetari i Komunës ka të drejtë ta merr fjalën sa herë të dëshiroj.

Ju disa kolegë të nderuar që nuk jeni pjesë e mbledhjes tani sepse jeni duke penguar mbledhjen, duhet ta lironi sallën sepse po na pengoni.

**z.Valon Demolli**, në fillim të tregova Kryesues se me këtë qasje nuk mund ta vazhdoj seancën.

**z.Arjant Topanica**, ty Kryesues askush nuk ta ndal të drejtën për ta shtyrë seancën.

**z.Tringa Sfishta**, edhe njëherë po të lutem i nderuar Kryesues, me marrëveshje të lutem ndërprerje seancën.

**Kryesuesi i Kuvendit**, përgjigje parafolëses, nuk është marrëveshje kjo, sipas juve është imponim.

**znj.Edona Shabani**, edhe unë i nderuar Kryesues të lutem mos na detyro me dalë prej vetes sepse këtu tani ka mbërri limiti, të lutem, as ne nuk kemi qejf me ndodh kjo, të lutem ndërprerje mbledhjen, shumë qetë po flas në mënyrë paqësore, të lutem.

**Kryesuesi i Kuvendit**, i'u drejtohet anëtarëve të Kuvendit të cilët kanë zënë foltoren, luteni t'i zëni vendet e juaja ose lironi sallën, ju jeni të detyruar ta lironi sallën sepse po e pengoni mbledhjen.

**z.Florent Hasani**, Kryesues në emër të Grupit të këshilltareve të LVV-së, kërkojmë që të fillosh me pikat e rendit të ditës dhe ta evitosh këtë imponim që është duke u bërë pa të drejtë.



**z.Qendrim Softtoli**, edhe ne në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së kërkojmë që të shtyhet seanca sepse po na bëhet e pa drejtë.

**znj.Lirika Maliqi**, sërish i kërkon Kryesuesit të Kuvendit të vazhdohet me seancën.

**z.Qendrim Softtoli**, edhe këtu po mundoheni ta përdorni arrogancën e numrave.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, të nderuar kolegë, kur nuk i keni votat nuk ka çka t'ju bëj askush.

**znj.Lirika Maliqi**, i nderuar Kryesues mund ta vësh në votim që të vazhdojmë me seancën.

**z.Qendrim Softtoli**, po dëshironi të përdorni arrogancën e numrave, hidheni në votim, por po na detyroni non-stop pastaj..., u tha unë i kam numrat, ju nëse dëshironi të qëndroni rrini, por s'mund të na thoni atë.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSh, ndërhyu duke theksuar se këtu është demokraci dhe vota është ajo që vendos.

**z.Qendrim Softtoli**, i reagon drejtorit parafolëse, ti je duke mi treguar gjërat elementare këtu, po të them mos mbaj ligjëratat këtu duke u munduar të përdorësh arrogancën e numrave, këto janë gjëra elementare për të cilat nuk kanë nevojë për diskutim.

**z.Florent Hasani**, i nderuar Kryesues, a bën t'i kthesh një përgjigje Grupit të këshilltarëve të LVV-së për kërkesën për të filluar me seancën.

**z.Artrit Mulliqi**, kolegu z.Demokrat Hodolli e paraqiti një kërkesë, pasi që nuk keni dashtë më herët të bëni zëvendësimin e tij përse sot është kaq e rëndësishme kjo.

**z.Arjant Topanica**, mendoj se MAPL nuk shqyrton diçka që nuk është marrë vendim në këtë Kuvend.

**Kryesuesi i Kuvendit**, edhe njëherë po ju lus t'i zëni vendet e juaja sepse po e pengoni mbledhjen.

**z.Qendrim Softtoli**, përgjigje Kryesuesit, nga fillimi ju treguam me mirësjellje se në këtë mënyrë nuk mund ta vazhdoni këtë seancën.

**Kryesuesi i Kuvendit**, konsideroj se kushte ka për vazhdimin e seancës mirëpo ju që jeni këtu afër meje po e pengoni vazhdimin e saj dhe nuk keni të drejtë t'a ndërpreni vazhdimin e seancës, nëse mendoni se po, na thoni me çfarë të drejte.

**z.Valon Demolli**, ti Kryesues me çfarë të drejte po na e mohon një të drejtë që na takon.

Këtë formë kështu nuk mund të vazhdoj seanca Kryesues.

**Kryesuesi i Kuvendit**, nuk është kurrfarë e drejte kjo, vetëm se ju po dëshironi ta pengoni mbledhjen e këtij Kuvendi. Pa humbur kohë më shumë kalojmë në pikën e radhë të rendit të ditës.

## **2. Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025.**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, e vë në votim propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025.

**z.Fatlum Osmani, Drejtorja e Buxhetit dhe Financave dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ**, theksoi, është obligim ligjor dhe propozoj të votohet ky propozim vendim për caktimin e normave tatimore sipas materialit përkatës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/ të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

### **3. Propozim vendim për transferimin e buxhetit të komunës për vitin 2024.**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, theksoi, propozohet që 250,000.00€ nga dy projekte të transferohen në një projekt të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, andaj kërkoj të votohet ky vendim.

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, e vë në votim propozim këtë pikë të rendit të ditës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet vendimi për transferimin e buxhetit të komunës për vitin 2024, sipas materialit përkatës.*

### **4. Propozim vendim për hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Podujevës.**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, e vë në votim propozim vendim për hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Podujevës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

### **5. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës.**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, e vë në votim propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, theksoi, kërkoj nga asambleja të aprovoj propozim vendimin për miratimin e Planit Rregullues për Zonën Industriale.

**Kryesuesi i Kuvendit**, e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet vendimi për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues nuk mund të kalojnë këto pika të rendit të ditës në këtë mënyrë kështu.

**6. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-437-1, ZK Podujevë.**

**6.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim**

*Në bazë të incizimeve, dhe situatës së krijuar te foltorja e Kuvendit dhe te Kryesuesi i Kuvendit, kjo pikë e rendit të ditës është tejkaluar dhe nuk ka dal në proces të votimit nga Kryesuesi i Kuvendit, rrjedhimisht nuk është miratuar dhe nuk ka konstatim nga Kryesuesi i Kuvendit.*

**7. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-704-0 dhe P-706-0, ZK Llapashticë e Poshtme.**

**7.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale Njësitë kadastrale P-704-0 dhe P-706-0 në Zonën Kadastrale Llapashticë e Poshtme, si dhe formimin e Komisionit përkatës për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.

**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues, nuk mund të kalojnë këto pika të rendit të ditës kështu në këtë formë, çka është kjo kështu kjo pikë ngritni duart dhe kaloj, si mundet kështu.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, theksoi, propozoj që të votohet kjo pikë dhe anëtar të komisionit nga Ekzekutivi propozoj të jenë z.Bahri Selimi dhe z.Alban Zeka.

**znj.Lirika Maliqi**, theksoi, nga radhët e Grupit të LVV-së propozojmë z.Haki Rudarin.

**z.Burim Hasani**, propozoj z.Demokrat Hodollin.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, nga sektori jo qeveritar propozoi znj.Alejna Hamiti.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kush është për këtë pikë të rendit të ditës duke përfshirë edhe formimin e komisionit me përbërjen e propozuar.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e të Kuvendit prezent në sallë, me 16 vota Për, asnjë votë Kundër, 2 vota të Përmbajtura (të tjerët nuk votuan), miratohet Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-704-0 dhe P-706-0, ZK Llapashticë e Poshtme, si dhe vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, sipas materialit përkatës dërguar me thirrjen e mbledhjes, në këtë përbërje;*

*Haki Rudari, anëtar nga Kuvendi i Komunës*

*Demokrat Hodolli, anëtar nga Kuvendi i Komunës*

*Bahri Selimi, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës*

*Alban Zeka, anëtare nga Ekzekutivi i Komunës*

*Alejna Hamiti, anëtare nga sektori jo qeveritar lokal*

**Kryesuesi i Kuvendit**, edhe njëherë kërkon nga anëtarët e Kuvendit të cilët i qëndrojnë afër dhe në foltore të Kuvendit, që të shkojnë nëpër vendet e tyre dhe të lejojnë vazhdimin e mbledhjes në mënyrë normale sepse po pengohet mbarëvajtja e mbledhjes dhe unë si kryesues i Kuvendit.

**8. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1615-4, ZK Orllan.**

**8.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani kemi pikën e rendit të ditës propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1615-4, ZK Orllan, së bashku me nënpikën për formimin e komisionit vlerësues për këtë pronë.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, theksoi, propozoj që të votohet kjo pikë dhe anëtar të komisionit nga Ekzekutivi propozoj të jenë z.Leutrim Krasniqi dhe z.Shuajb Blakçori, kurse nga sektori jo qeveritar anëtar i komisionit të jetë znj.Shqipdon Rushiti.

**z.Florent Hasani**, theksoi, nga radhët e Grupit të LVV-së propozojmë z.Xhevdet Malokun dhe nga anëtarët e Kuvendit propozoj z.Arbnor Fazliun.

**Kryesues i Kuvendit**, theksoi, e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës së bashku me nënpikën përkatëse për formimin e komisionit sipas propozimeve të dhëna.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1615-4, ZK Orllan, si dhe vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, në këtë përbërje;*

*Xhevdet Maloku, anëtar nga Kuvendi i Komunës*

*Arbnor Fazliu, anëtar nga Kuvendi i Komunës*

*Leutrim Krasniqi, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës*

*Shuajb Blakçori, anëtare nga Ekzekutivi i Komunës*

*Shqipdon Rushiti, anëtar nga sektori jo qeveritar lokal*

**9. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1119-0, ZK Balloc.**

**9.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kemi pikën 9 të rendit të ditës që është propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1119-0, ZK Balloc, së bashku me nënpikën për formimin e komisionit vlerësues për këtë për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij vendimi.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, theksoi, propozoj që të votohet kjo pikë dhe anëtar të komisionit nga Ekzekutivi të jenë znj.Adelina Stublla dhe z.Alban Zeka, kurse nga sektori jo qeveritar anëtar i komisionit të jetë z.Shqipdon Rushiti.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, nga radhët Grupit të LVV-së e propozoj z.Ragip Fetahun.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, nga radhët e Kuvendit propozoj për znj.Mrika Thaçi për anëtare në këtë komision.

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës, përfshirë edhe formimin e komisionit përkatës me anëtarët e propozuar.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtura (të tjerët nuk votuan), miratohet Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1119-0, ZK Balloc, si dhe vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, në këtë përbërje;*

*Ragip Fetahu, anëtar nga Kuvendi i Komunës*

*Mrika Thaçi, anëtare nga Kuvendi i Komunës*

*Adelina Stublla, anëtare nga Ekzekutivi i Komunës*

*Alban Zeka, anëtare nga Ekzekutivi i Komunës*

*Shqipdon Rushiti, anëtar nga sektori jo qeveritar lokal*

**10. Të ndryshme**

*Nuk pati diskutime, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 16:10**

**Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;**

**Enis Sheholli**

**Osman Bajrami**

**Nr.Prot.01-060/04-0062400/24**

**Podujevë,**

**12 shtator 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Hilmi Hoxha**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **Procesverbal nga mbledhja e XLIV-të (dyzetekatër)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 26 shtator 2024.**

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; kurse munguan; Ilir Koprani dhe Fahri Hasani.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor.

Të pavarur, Demokrat Hodolli; Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Shuajb Blakçori-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS (U.D. drejtoresh); Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Alban Zeka-Drejtorja e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;).

Të pranishëm ishin edhe Caleb Waugh dhe Samir Calaković përfaqësues të OSBE, Kovacs Karoll përfaqësues i KFOR - LMT, media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

## **Rendi i Ditës**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar punë të mbarë në këtë mbledhje, ndër të tjera theksoi, sa i përket kuorumit, në bazë të nënshkrimeve të pjesëmarrjes dhe numërimit të prezencës konstatohet se 30 anëtar/e të Kuvendit janë prezent në sallë, kurse 5 për momentin mungojnë po që ndonjëri prej tyre mund të arrijë gjatë zhvillimit të seancës.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me rendin e ditës.

**z.Valon Demolli**, theksoi, qytetar të dashur të Podujevës, ajo që ka ndodh në seancën e fundit në këtë Kuvend është e turpshme dhe nuk i nevojitet ai imazh më së paku këtij qyteti kur dihet se në Llap kanë filluar të gjitha proceset e mëdha gjatë gjithë kohës dhe historisë së këtij vendi.

Ajo që ka ndodhur në këtë Kuvend ka emër dhe adresë, kolegu ynë z.Ekrem Rrahmani si anëtar i Kuvendit ka ardhur këtu me votën e qytetarëve dhe prej momentit të dhënies së betimit në Kuvend nuk përfaqëson vetëm votuesit që e kanë votuar por gjithë zërin qytetar Llapjan.



**z.Florent Hasani**, nga vendi reagon në drejtim të Kryesuesit të Kuvendit duke pyetur se a ishte fjala për rend të ditës apo për fjalime të tilla sepse tani po ofendohemi gjithë pala jonë duke futur këso lloj pikash.

**z.Valon Demolli**, vazhdoi, ta kryej unë fjalimin e pastaj mund të merrni fjalën kushdo nga ju. Kryetari i Komunës i ashtuquajturi me tituj shkencor....

**Kryesuesi i Kuvendit**, ndërhyjnë duke kërkuar të mos zgjatet me fjalime të tilla.

**z.Valon Demolli**, duke sqaruar ndaj Kryesuesit të Kuvendit theksoi, i nderuar unë kam një deklaratë lidhur me atë çka ka ndodhur në seancën e kaluar, andaj kërkoj të mos më ndalet fjala.

**z.Florent Hasani**, sërish i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit duke kërkuar që të ketë një menaxhim më dinjitoz të seancës, përndryshe e lëshojmë seancën

**Kryesuesi i Kuvendit**, askush nuk ju dha fjalën z.Florent Hasani andaj kërkoj të mos ngutesh, po ashtu z.Valon Demolli, mund të vazhdosh me përfundimin e deklaratës dhe të mos të përdorësh emra sepse nuk ke nevojë.

**z.Valon Demolli**, vazhdoi, Kryetari i Komunës i ashtuquajturi me tituj shkencor, ra në atë nivel aq të ulët dhe përdori pozitën dhe autoritetin e tij....

**Kryesuesi i Kuvendit**, sërish ndërprejnë fjalën parafolësit duke kërkuar nga ai që të mos përdorë emra sepse as me Rregullore të Punës së Kuvendit nuk lejohet përdorimi i emrave. Situatën për të cilën po flet ti e dim të gjithë çfarë ka ndodh, madje edhe në atë seancë jua kam ndalur fjalën gjithë atyre që kanë bërë fyerje, prandaj urdhëro lexoje deklaratën e juaj më shkurtë dhe përfundoje, pa përmend emra sepse qytetarët na njohin të gjithëve.

**z.Valon Demolli**, vazhdoi sërish, edhe deklarimet tona po tentoni të na i ndalni a, kurse për fyerjet që u bënë në atë seancë nuk ju ndalej fjala.

Ajo çka është më e keqja e këtij Kuvendi, është edhe një ish profesor i respektuar në Llap i cili tani në cilësinë e spikerit të Kuvendit apo zëdhënësit të ashtuquajturit Kryetar dhe Kryesues pas gjithë asaj shfaqje dhe kidnapimi të anëtarit të Kuvendit nuk reagon dhe as nuk pyet se çfarë po ndodh, e kjo përgjigje sa është dashtë t'ia bëj argatin shefit dhe më e keqja me direktiva të Shpejtitimit dëshmitar në procesin e montuar vijnë edhe vasalët e tij të Kuvendit e që është turpi i turpit.

Për të gjitha këto ju njoftojmë se kemi filluar gjitha procedurat ligjore dhe gjithë ju do të përgjigjeni penalisht secili veç e veç, madje edhe vasalët e pushtetit jashtë dhe brenda këtij tempulli të demokracisë. Zëri i qytetarëve nuk do të ndalet, një e drejtë e garantuar me ligj nuk mund të mohohet me arrogancën e pushtetit por asnjëherë edhe të inponohet, por në fund janë qytetarët që vlerësojnë dhe vendosin për fatet e tyre, të këtij vendi e në veçanti Llapit.

Këtu në Kuvend mund të kemi shumë individ me tituj e doktor shkence dhe profesor, por titujt nuk ju bëjnë nderë sepse ata nuk paraqesin personalitet me moral të lartë dhe integritet, mirëpo qytetarëve të Llapit i'u them se unë dhe kolegët e mi e në veçanti z.Ekrem Rrahmani deri në momentin e fundit do të jemi dhe do të mbështesim zërin e juaj, zërin e drejtësisë kurse këta e kanë të kotë ngase as me grila nuk patën sukses ta ndalin zërin tonë dhe as nuk do të kenë asnjëherë mundësi ta ndalin zërin tonë e as të qytetarëve.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 30 anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 20 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

## **1. Propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026 - 2027**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, më lejoni para juve të paraqes propozim vendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 si dhe projeksionet për vitet 2026 dhe 2027.

Komuna e Podujevës në bazë të Qarkores Buxhetore të lëshuar nga ana e Ministrisë së Financave për vitin 2025, ka një buxhet total prej 33,459,115.00€ e që është buxheti më i lartë në historinë e Komunës së Podujevës e që dihet se edhe gatë gjithë këtyre viteve ka pasë një rritje progresive të buxhetit. Ky buxhet është i ndarë në kategorinë e pagave, mallrave, komunalive, subvencioneve, dhe kapitale.

Në kategorinë e pagave janë 17,669,041.00€, në kategorinë e mallrave janë 4,090,032.00€, në komunalit janë 633,600,00€, në subvencione 1,810,000.00€ dhe në shpenzime kapitale 9,256,442.00€.

Në propozim vendimin përkatës që ju është dërguar, për disa arsye teknike të disa keqkuptimeve në raport me Ministrinë e Financave tek numri i të punësuarve, më lejoni që këtu t'i prezantoj disa ndryshime që janë në raport me propozimet që kanë të bëjnë me ndryshimet tek numri i stafit në mënyrë që të ndikoj pastaj edhe tek çështja e shpenzimeve të pagave në programet përkatëse, pra në bazë të propozimit të ri tek Zyra e Kryetarit do të jenë 18 të punësuar për dallim që në propozim kanë qenë 19, tek Zyra e Kuvendit tani për herë të parë për arsye se na kanë ngjallë këto sepse nuk kanë qenë pjesë e numrit të aprovuar nga ana e Ministrisë së Financave, mirëpo që në këtë vite duhet të inkuadrohen e që do të thotë se janë 36 (35 anëtar/e të Kuvendit dhe asistenti/ja e Kryesuesit), pastaj në Drejtorinë e Administratës janë 66 të punësuar, te Drejtoria e Buxhetit dhe Financave janë 20, te Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik 9 të punësuar, në Drejtorinë e Inspeksionit 17, tek Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 8, te Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë 18, te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit 13, në Infrastrukturë-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit 12, tek Zjarrfikësit 18, në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit 17, në Teatrin e Qytetit 12, në Zyrën Komonale për Komunitete dhe Kthim 2, në Administratën e Arsimit 12, Administratën e Shëndetësisë 10, te Shërbimet rezidenciale 13, te Shërbimet sociale 13, pastaj në Arsim dhe Shkencë janë 1465, në Shëndetësi 266. Pra të gjitha këto janë me ndikime në buxhetin varësisht prej koeficientit të pagave për cilët nuk dëshiroj t'ju marrë kohë duke i cekë të gjithë me numra mirëpo sekretarisë do t'ia prezantoj me shkrim dhe atë duke filluar prej Zyrës së Kryetarit që janë 187,052.00€, pastaj Zyra e Kuvendit 288,608.00€ e kështu me radhë e që nuk po dëshiroj t'ju marrë kohë me të gjitha shifrat për secilën fushë.

Nëse i ndajmë me programe te kategoria e pagave do të thotë se te Administrata Komunal janë 2,612,603.00€, te Shëndetësia janë 2,380,508.00€, te Arsimit janë 12,571,282.00€ dhe te Shërbimet Sociale 104,648.00€, te buxheti i Teatrit publik të qytetit si buxhet total nuk ndryshon asgjë, por vetëm tek financimi i grandit duhet të jetë përbrenda viteve dhe atë në vitin 2025 shuma 157,349.00€, në vitin 2026 shuma 166,003.00€ dhe në vitin 2027 shuma 175,133.00€ e që këtu tek ndryshimi i strukturës duhet të jenë në raport me bujqësinë mirëpo pa ndryshuar asnjë centë qoftë buxheti i Teatrit e as buxheti i bujqësisë ashtu siç është i paraqitur në propozim vendimin që është dërguar për miratim në Kuvendin e Komunës së Podujevës.

Edhe për vitin 2025 ashtu sikurse për vitet e kaluara në këtë buxhet janë të prioritizuara disa sektorë siç është sektori i Arsimit, sektori i Shëndetësisë, sektori i Kulturës, sektori i Ekonomisë, normalisht nëse e krahasojmë me vitet e kaluara, pra ta zëm në sektorin e Arsimit për vitin 2025 do të jetë një buxhet prej 1,970,000.00€ e që është një prioritizim shumë i madh i sektorit të Arsimit kur dihet se me Qarkoren Buxhetore përkatësisht me grandin specifik të Arsimit janë vetëm 110,000.00€ në bazë të formulës së financimit në sektorin e Arsimit mirëpo duke pasë parasysh mundësitë ligjore që nga grandin i përgjithshëm të bartim mjete buxhetore në sektorin e Arsimit normalisht e kemi shfrytëzuar këtë dhe kemi planifikuar një buxhet total për Arsim në shumë 1,970,000.00€ ku janë shumë projekte siç është ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike që është vazhdim i projektit, përmirësimi i infrastrukturës shkollore ku janë 180,000.00€, ndërtimi i shkollës në fshatin Shajkoc që është bashkëfinancim, ndërtimi i aneksit në fshatin Llapashticë, ndërtimi i shkollës në fshatin Bradash, ndërtimi i shkollës në fshatin Dobërdol e të tjera.

Në sektorin e Ekonomisë është vazhdimi i projektit në të cilin jemi në bashkëfinancim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për ndërtimin e Zonës Industriale ku ne jemi bashkëfinancues të këtij projekti e që janë të planifikuara mbi 200,000.00€, pastaj gjithashtu edhe te ndërtimi i Tregut që është një projekt mbi 1 milion euro bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik e që Komuna merre pjesë me një shumë prej 300,000.00€ në vitin e ardhshëm.

Në fushën e Kulturës janë të planifikuara 500,000.00€ ku bëjnë pjesë ndërtimi i terreneve sportive në shumë 200,000.00€, pastaj Pishina Gjysmë olimpike që është bashkëfinancim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit ku ne marrim pjesë me 150,000.00€, mandej renovimi i Teatrit të Qytetit ku janë të planifikuara 100,000.00€.

Në fushën e Bujqësisë, përveç kategorisë së Subvencioneve ku janë të planifikuara 750,000.00€, kemi projektin që ndoshta për herë të parë zbatohet në Kosovë, do të jetë projekti i ndërtimit të Parkut Industrial Bujqësorë që do të ndërtohet në fshatin Sfeçël ku do të jetë bashkëfinancim me Organizatën e Katarit (Chatar Charity) ku Komuna e Podujevës për vitin 2025 ka të planifikuara 400,000.00€.

Në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit janë të planifikuara 3,052,670.00€ e që vlen të ceket se përveç projekteve më të mëdha infrastrukturore, në këtë buxhet është i përfshirë pothuajse çdo lokalitet i Komunës që do të preken me investime në infrastrukturën rrugor.

Gjithashtu edhe në programin e infrastrukturës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjesh dhe Shpëtimit janë shumë projekte të rëndësishme siç është ndërtimi kolektorit të ujërave të zeza, rindërtimi i rrugëve përfshirë edhe rrugë të fshatrave, pastaj kemi investime në ndriçimin publik, ndërtimi i trotuareve, infrastruktura e varrezave si dhe projekte tjera.

Nuk dëshiroj të zgjati më shumë mirëpo dua të cekë vetëm edhe një çështje e cila ka të bëjë me 2-3 përmirësime teknike në propozim vendim, bëhet fjalë te emërtimet e rrugëve e që në propozim figuron ndërtimi i rrugëve në fshatra ku është i emërtuar ndërtimi i rrugëve nga fshati Bajçinë deri në fshatin Murgull si dhe nga fshati Shajkoc deri në fshatin Orllan, bëhet fjalë për meremetimin e rrugëve me zhavorr, si dhe ndërtimi i rrugëve me elemente të betonit kemi të bëjmë me ndërtimin e rrugëve me kubëza nga qyteti deri në fshatin Kërpimeh dhe nga Sekiraça në fshatin Lluzhan, si dhe po ashtu rindërtimi i rrugëve ri-emërohet si ndërtimi i rrugëve të asfaltuara nga rr.”Zahir Pajaziti” deri te rrugët “Xhemajl Mustafa” dhe “Skënderbeu”, pastaj përmirësimi i infrastrukturës fizike ku janë të cekura shkollat është renovimi i infrastrukturës shkollore në qytet – shkollat “Naim Frashëri” “Xheladin Rekalii”, shkolla në fshatin Orllan, Kërpimeh, Dumnicë, Sfeçël, e të tjera.

Pra ky ishte prezantim i përgjithshëm i buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 dhe ju falënderoj për vëmendje. Po ashtu jemi të hapur për diskutim në mënyrë që ta diskutojmë dhe në fund ju ftoj ta miratojmë këtë buxhet i cili mendoj

se i përgjigjet shumë mirë interesave dhe nevojave të qytetarëve, normalisht duke pasë parasysh edhe kufizimet buxhetore sepse është normale se gjithmonë nevojat janë më të mëdha se sa mundësit buxhetore që kemi.

**z.Haki Rudari**, theksoi, natyrisht se procesi i planifikimit të buxhetit është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm apo do të thoja është një lloj kalendari përmes të cilave do të kyçen ose kyçen vazhdimisht institucionet qendrore duke filluar nga Ministria e Financave, Kuvendi, pastaj institucionet lokale siç janë Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës e deri te vet qytetarët e Komunës tonë. Pra thjesht buxheti është një dokument në të cilin parashihen investimet e Komunës tonë dhe për qytetarët e Komunës tonë për vitin 2025 si dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026 dhe 2027.

Të nderuar koleg, çdo komunë duhet të ketë parasysh disa parime të cilat ndërlidhen me buxhetin, disa prej tyre po i lexoj dhe janë, respektimi i kornizës ligjore e që është në rregull, investimet kapitale sipas kërkesave të qytetarëve e që po ashtu janë marrë kërkesat e tilla, pastaj kemi transparencën, pjesëmarrjen e qytetarëve në buxhet, mandej kërkesat e qytetarëve, qëndrueshmëria dhe gjitha këto. Natyrisht se kërkesat e qytetarëve janë të shumta e që edhe drejtori parafolës e ceku se po të kishim edhe një buxhet kush di sa, kërkesat janë të mëdha, por megjithatë ne kemi një buxhet, e thash edhe në KPF, se është buxheti më i madh i Komunës tonë e që është 33,459,115.00€ nga i cili për investime kapitale kemi shumën prej 9,256,442.00€ e që mendoj se është një shumë e mirë dhe në interes të qytetarëve ngase ashtu siç e përmendi edhe drejtori parafolës të gjitha projektet dhe investimet që bëhen janë nëpër fshatra, lagje dhe për qytetarët e Komunës tonë sepse edhe ashtu e kemi obligim.

Pastaj kemi edhe subvencionet në shumë 1,810,000.00€ e që po ashtu është një shumë e cila është rritur dhe kjo shumë planifikohet të investohet në fusha dhe sektor të ndryshëm duke filluar nga Arsimi, Shëndetësia, pastaj Bujqësia, Kultura Rinia dhe Sporti dhe shumë e shumë të tjera, pra thjesht është një buxhet i cili është për qytetarin dhe natyrisht se krejt këto investime do të shkojnë tek qytetarët e vendeve të ndryshme.

Ne kemi buxhetin si anëtar të Kuvendit dhe në të njëjtën kohë kemi edhe prioritetet nëpër Drejtori të ndryshme e që edhe unë për hir të kohës nuk dëshiroj të ndalem shumë, mirëpo vërtetë kemi një buxhet unë do të thoja gjithëpërfshirës e që këtë na e argumenton edhe materiali i cili na është dërguar, shembull te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit ku pothuajse nuk fshat ku nuk parashihen investime, natyrisht shumat dallojnë dhe ndryshojnë sepse diku mund të jetë më e vogël e diku më e madhe, pastaj kemi Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, pastaj Drejtorinë e Kulturës Rinis dhe Sportit, Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të tjerat Drejtori në të cilat parashihen investime të ndryshme, prandaj të gjitha këto që i ceka e që u potencuan edhe nga drejtori janë prioritete janë projekte në interes të qytetarëve dhe ne Grupi i LVV-së do ta përkrahim buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, jemi në seancën ku do të miratohet buxheti i Komunës tonë për vitin 2025 dhe projeksionet për vitet 2026 – 2027, buxhet i cili si i tillë është dokumenti kryesor që përcakton rrjedhën e të hyrave financiare dhe projekteve kapitale të Komunës së Podujevës për 3 vitet në vijim, pra është dokumenti më i rëndësishëm që ne si Kuvend i Komunës e miratojmë e që fillimisht do të uroja që meqë është buxheti për vitin 2025 ky të jetë buxheti i fundit që e miraton kjo qeverisje komunale për arsye se e dim gjithë rrjedhojën e asaj që ka ardh deri këtu dhe tani unë me një përmbledhje në pikat kryesore do ta bëjë një analizim të këtij buxheti, defekteve, mangësive dhe rekomandimeve që dalin nga ne si Grup i anëtarëve të Kuvendit nga LDK.

Po filloj me infrastrukturën, vazhdimisht kur keni qenë në opozitë e keni trumbetuar fjalën asfalt e asfalt dhe zhavorr po shtrohet kurse pjesën më të madhe të këtij buxheti edhe pse jemi 25 vite pas luftës e zë asfalti dhe infrastruktura, ku janë ato investime kapitale që tani do të duhej të bëheshin, ato investime që do të kenë para vetës zhvillimin e Komunës, të dalin përtej të menduarit dhe asaj që bëhet vazhdimisht këtu për përmirësimin e jetës së qytetarëve, por që ato mungojnë dhe çka kemi tani sërish kemi numër të madh të asfalteve të paspecifikuara, kode të paspecifikuara dhe krejt kjo me qëllimin e vetëm që të merren ato mjete dhe të përdoren aty ku është e nevojshme dhe jo sipas një plani të detajuar me emërtime të projekteve.

Kemi mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve ku edhe pse pas gjithë atyre skandaleve me tender në vitin e kaluar sërish nuk keni arritur të ofroni një mirëmbajtje e rrugëve dhe trotuareve si dhe për hapësirat publike në Komunën tonë, mandej kemi buxhetin për lumenj e që e kemi ngritur disa herë si shqetësim dhe tani po e shohim për fat të keq se vite me radhë kemi dalje të lumenjve nga shtretërit dhe dëmtim të ekonomive bujqësore dhe familjare dhe sërish nuk ka një plan dhe një buxhet të theksuar që adreson sakt dhe e zgjedh njëherë e mirë këtë çështje me të cilën besoj se jemi përballur të gjithë ne. Pastaj si defekt tjetër e që e ceka edhe më parë është mos specifikimi i ku kemi disa kode siç është shembull shtrimi i disa rrugicave private e që kjo është në kundërshtim me ligjin për shpronësim, mandej kemi ndërtimin e rrugëve në fshatra e do të thotë se as emrat e fshatrave nuk janë përmendur por vetëm është si kod ndërtimi i rrugëve në fshatra dhe tani Komuna e Podujevës ka mbi 80 fshatra dhe tani me këtë dihet se aty ku është kërkesa dhe klientela aty do të intervenohet me qëllim të blerjes dhe tregtimit të votës meqë edhe jemi në fushatë zgjedhore, mandej kemi meremetim të 7 shkollave pa e cekur me kurrfarë definimi se çfarë do të meremetohet, pastaj janë cekur emrat e të gjitha shkollave por për ironi të fatit shkolla “Ibrahim Rugova” është me shkronja të vogla, nuk kemi shumë kohë nga përrurimi i bustit të Ibrahim Rugovës me qëllime të përfitimeve elektorale dhe për të shitur mend aty përpara kurse shkojnë deri në atë pikë ku nga 7 shkolla që janë të shkruara 6 janë shkruar siç duhet kurse shkolla “Ibrahim Rugova” është shkruar me të shkronja të vogla e që është një detaj i vogël por shumë domethënës. Shumë mjete figurojnë pa adresë të qartë të shpenzimeve siç janë shembull, blerje mallrash dhe blerje mobilesh e që nuk janë të planifikuara as në planin kontabël por që këto mjete padorën vetëm si rezervë për tu shpenzuar aty ku ka nevojë pa asnjë llogaridhënie andaj për atë arsye edhe Raportet e Auditorit tash e sa herë dalin të kualifikuara.

Te sektori i Arsimit ndonëse kemi një rritje të buxhetit nga vitit 2024 kjo prap nuk është e mjaftueshme që kjo rritje të mbulon defektet, mangësitë dhe të ketë një zhvillim të qëndrueshme të Arsimit në Komunën e Podujevës ku shembull, do të pamendja shkollën “Isa Boletini” e cila ende funksionon me 3 ndërrime, ku kemi ende klasë që mësimi ende zhvillohet vetëm 30 minuta e që është në kundërshtim të plotë me ligjin për arsim. Pastaj kemi investime për kabinete në shumë 130,000.00€ e që duke pasë parasysh territorin e madh që ka Komuna e Podujevës dhe numrin e madh të shkollave shuma e ndarë 130,000.00€ është e pamjaftueshme sidomos në këtë kohë kur po flasim se Arsimit nuk e kemi mirë e që duhet ta zhvillojmë dhe qojmë përpara, ne i kemi vetëm 130,000.00€ për kabinete e që po të pajisen me pajisje moderne del që 1 apo eventualisht 2 kabinete do të merrnin këtë shumë.

Te sektori i Shëndetësisë është shumë e rëndësishme të thuhet që ne si opozitë gjatë vitit të kaluar i kemi ngritur disa shqetësime për disa Ambulanta apo Shtëpi të Shëndetit mirëpo për fat të keq nuk kemi një buxhet të specifikuar për adresimin e atyre çështjeve dhe përmirësimin e atyre Ambulantave apo Shtëpive të Shëndetit nëpër fshatra të Komunës tonë.

Kemi mungesën e qytetarëve dhe kuvendarëve në dëgjimet publike që ishin pa pjesëmarrje të qytetarëve e që kjo tregon qartë se qytetarët kanë humbur interesimin të jenë pjesë e dëgjime

publike për arsye se nisen nga fakti se zëri i tyre nuk po dëgjohej nga kjo qeverisje dhe që është e vërtetë ajo mirëpo mendoj se nuk duhet të dekurajohen qytetarët por duhet të marrin pjesë sepse herë do kur do zëri i tyre është vendimtarë dhe zëri i tyre do të dëgjohej gjithmonë. Po ashtu edhe Kuvendi i Komunës nuk i ka mbajtur dëgjimet publike e që me Rregullore është përcaktuar se do të duhej të mbaheshin dëgjime buxhetore para datës 01 shtator por që është anashkaluar tërësisht Kuvendi i Komunës.

Te investimet kapitale është paraqitur si rritje e investimeve kapitale në vlerë nominale mirëpo marrë nga të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës-BQK si dhe inflacionit i cili shkon në rritje viteve të fundit vlera nominale e investimeve kapitale, realisht nëse e analizojmë duke hequr inflacionin është vetëm 187,000.00€ që është ngritje e investimeve kapitale, por nëse flasim me përqindje investimet kapitale në vitin 2024 kanë pasë përqindje më të lartë nga buxheti i tërësishtëm i Komunës së Podujevës me 28.2% kurse buxheti i investime kapitale si tërësi nga buxheti i vitit 2025 janë vetëm 27.66%.

Te të punësuarit drejtori i DBF-së vetëm i përmendi, por unë do të ndalesha vetëm te Arsimi ku kemi një rritje të numrit të të punësuarve ku nga 1453 sa kanë qenë të punësuar në vitin 2024 kurse në vitin 2025 kemi rritje të numrit në 1483 e jo 1465 ashtu siç e ceku drejtori i DBF-së në fjalën hyrëse të tij, pra është tejkalim për 30 e numrit të të punësuarve në Arsim e që kjo vie si rezultat i pazareve në kompensim të votave që janë bërë dhe si ta bëjnë atë, e bëjnë përmes punësimit duke rritur numrin e të punësuarve në Arsim, ndarjes së orëve ku për një normë të plotë janë deri në 3 të punësuar e gjëra të tilla tërësisht në kundërshtim me ligjin vetëm për rehatimin dhe plotësimin e pazareve që është bërë më herët në kompensim të votës.

Subvencionet në Kulturë dhe në Sport në vitin 2024 ishin 200,000.00€ kurse tani kemi 150,000.00€ edhe pse jemi në dijeni se një pjesë e konsiderueshme e tyre subvencioneve për Kulturë dhe Sport kanë shkuar për dosta e shumë pak për Klubet sportive të Llapit, ndërsa këtë shumën 50,000.00€ që është më pak në vitin 2025 ta dim se a do t'ju ndalen dostave apo Klubeve sportive të Llapit.

Te Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik kemi 300,000.00€ të parapara për subvencionim të kompanive private dhe publike thuhet, pra tani janë shtuar edhe ato publike, për ndihmesën e tyre për blerjen e mjeteve themelore apo për prodhim, pra këtu do të donim ta dinim përse kanë hyrë edhe Kompanitë publike kur në një kohë kanë qenë vetëm Kompanitë private, apo mos janë për t'i plotësuar disa pazare të mëhershme e që ndonjëra prej Kompanive duhet ta ketë buxhetin e vet, si do të bëhet kjo si dhe a do të ketë një gjithëpërfshirje në Komisionin i cili do të bënë ndarjen e këtyre mjeteve, a do të jetë ndokush nga Kuvendi i Komunës si prezencë në këtë Komision në ndarjen e këtyre mjeteve apo do të bëhet allishverishi siç është bërë teri tani tek dostat ku ju dëshironi.

Edhe një shqetësim tjetër është mungesa e ndriçimit publik dhe e trotuareve në fshatin Sfeqël, çështje të cilën e ngris tani specifikisht për fshatin prej nga vije unë për arsye se disa herë i kam bërë kërkesë edhe Drejtorit të drejtorisë përkatëse qoftë këtu nga kjo foltore por edhe kërkesë personalisht kurse në vitin 2025 nuk është paraparë asnjë metër trotuar e as ndriçim publik për fshatin Sfeqël.

Si përfundim ky buxhet nuk i përmbush nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe hartohet duke anashkaluar qoftë kritikën qoftë rekomandimet e bëra nga opozita, mirëpo është hartuar vetëm duke i përcjellë interesat e këtij pushteti famëkeq. Është një fasad shumë e shprazët nga ajo çfarë ish dashtë të jetë dhe ajo çfarë është realisht dhe rrjedhimisht nga kjo LDK do të voton kundër këtij buxheti, por edhe pse votojmë kundër ne gjithmonë do të jemi

gardian dhe ruajtës të interesave të qytetarëve në çdo segment të tij duke përfshirë edhe buxhetin që është shpenzim direkt i parasë publike të qytetarëve tanë.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, sot në këtë seancë po diskutojmë për buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2025, buxhet i cili është 33,459,115.00€ ku për shpenzime kapitale janë paraparë 9,256,442.00€ dhe duke shikuar fushat ku janë planifikuar investime kapitale Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka shumë prej 3,052,000.00€, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit / Infrastruktura publike janë planifikuar 2,193,000.00€, në Drejtorinë e Arsimit janë planifikuar 1,970,000.00€, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik janë 500,000.00€, pastaj subvencione në Bujqësi janë planifikuar 750,000.00€, mirëpo ajo që më bëri përshtypje ishte Shëndetësia ku janë vetëm 160,000.00€ shumë e cila mu duk shumë pak sa i përket ndarjes së buxhetit për investime kapitale për investime në Shëndetësi.

Te të hyrat vetanake janë inkasuar 1,986,336.00€ edhe pse nuk e di se shuma totale a është deri në këtë datë apo është deri në fund të muajit dhjetor sepse ne jemi në dijeni që të hyrat vetanake mbledhen deri më 31 dhjetor.

Te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit janë ndarë jete buxhetore në shumë 300,000.00€ për 2 projekte e që janë rruga nga magjistralja Prishtinë-Podujevë deri te rruga “Vëllezërit Fazliu” dhe rruga nga shkolla “Shaban Shala” deri te rruga “28 Nëntori”, pra janë ndarë 300,000.00€ për këto 2 projekte për çka do të ishte mirë të na jap sqarime drejtori i Drejtorisë përkatëse sa janë paraparë për njërin projekt dhe sa për projektin tjetër, edhe pse jemi në dijeni se rruga nga rr.”Vëllezërit Fazliu” deri te magjistralja Prishtinë-Podujevë është duke u ndërtuar por që nuk e dim sa mjete buxhetore kërkohen për përfundimin e saj.

Te subvencionet në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit janë ndarë 120,000.00€ për çka do të doja të di edhe për këtë, sikurse që do të doja të di edhe për subvencionet në shumë 320,000.00€ në Administratën e Shëndetësisë, pra për çfarë janë paraparë këto mjete buxhetore.

Në Arsim janë ndarë 1 milion euro për ndërtimin e shkollës së mesme, e që është mirë sepse ndoshta kryhet edhe ky projekt sepse do të rregullohej edhe vijimi i mësimit edhe në shkollat fillore në qytet mirëpo edhe për faktin që shkak i këtij projekti po kemi pastaj suficid të buxhetit në fund të vitit.

Te ndërtimi i Zonës Industriale janë planifikuar 200,000.00€, ndoshta drejtori i drejtorisë përkatëse mund të na sqaroj, por nuk e di a mund të funksionalizohet Zona Industriale me 200,000.00€ edhe pse është një prej projekteve më jetike të qytetit.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, fillimisht ju tregoj se do t’ju dhëmbin sytë gjatë duke më parë këtu.

Po ashtu për fillim kam pyetje për drejtorinë Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, nuk e di a bëri gabim apo është ashtu siç e kemi në materialet tona numrin e të punësuarve në Arsim që është 1483 kurse ai e ceku numrin 1465.

Çështja tjetër është rubrika shërbime kontraktuese dhe atë për vetëm për vitin 2025 janë 800,000.00€ andaj përse nuk emërtohet si projekt, çfarë janë këto shërbime dhe përse i lëni kështu si dhe kujt doni t’ia jepni këto mjete. Në çdo Drejtori ka mjete për shërbime kontraktuese, te Administrata 70,000.00€, në Kuvendin e Komunës 20,000.00€ e kështu me rend, pra 800,000.00€ të planifikuara për shërbime kontraktuese, pa asnjë emërtim, pa e ditë ne ku shkojnë dhe pa kurrfarë sqarimesh.

Pastaj kemi buxhetin për rrugët ku edhe për këtë pyes përse nuk i shkruani rrugët të cilat do të shtrohen, si dhe çfarë mund të bëhet në një fshat me 15,000.00€ për asfaltimin e rrugëve për çka mendoj se lehtë është të llogaritet, 35 € m<sup>2</sup> i asfaltit dhe nëse shtrohet asfalti sipas standardeve 5 m

gjerësi edhe pse ju i keni ngushtuar tash, del që as 70 m asfalt nuk mund të shtrohen me 15,000.00€. Përse nuk duhet ta dim ne kujt do t'i shtrohet asfalti, kurse pastaj dilni nëpër dëgjime publike dhe i rreni njerëzit duke i'u thënë do ta rishikojmë buxhetin si dhe duke i pyetur ku po doni t'ju shtrojmë e ku jo duke i shikuar votuesit. Ata që kanë qenë më parë në këtë Kuvend gjithëherë janë kritikuar pushtet e kaluar përse nuk po specifikohen emrat e rrugëve në mënyrë që të dihet ku po shtrohet dhe ku po shkon buxheti, unë i vëreja 2-3 vende, shembull urë në fshatin Siboc, a jam përqaftues unë dhe a duhet të dijë edhe unë ku ndërtohet ajo urë, nuk jam kundër shtrohet ajo urë por duhet ta dijë ku shtrohet, a ka nevojë për atë apo kush e ka thënë sepse në dëgjime publike nuk ju vije askush, me pyet nuk e pyetni askënd por vetëm ju thirrë ndokush në telefon duke ju kërkuar t'ia shtroni urën dhe kryhet.

Tjetër gjë që më bëri përshtypje është ndërtimi i aneksit të objektit të Komunës, pyes çfarë aneksi dhe ku ndërtohet në Komunë, në cilën pjesë sepse kjo që aktuale është paraparë për këtë administratë dhe për këtë numër të punëtorëve, madje vetëm janë pakuar sepse një numër i tyre janë ik nga ju krejt dhe kanë shkuar në Prishtinë, ndërsa tani planifikoni edhe një aneks por që ne duhet ta dim çka dhe ku, madje t'ju them të drejtën më së shumti ka nevojë për një sallë tjetër të Kuvendit të Komunës sepse kjo që është nuk i plotëson kushtet për sallë.

Po ashtu ishte edhe planifikimi mirëmbajtje e trotuareve, kush i mirëmban ato trotuare, për çfarë i janë dhënë rreth 300,000.00€ tjetrit operator më shtrenjtë dhe asnjë pjesë të trotuarit askund nuk e prek fare, pra këndej shtrimi i trotuareve, andej mirëmbajtja e trotuareve prej të njëjtës Drejtori kurse në anën tjetër mirëmbajtjes e trotuareve e obligim kompania përkatëse, do të thotë atë kompani nuk po guxonin as ta thirrni për ta larë e pastruar sheshin e lëre më ta mirëmbaj ndonjë trotuar, përndryshe më tregoni ju cili trotuar në Podujevë është i mirëmbajtur përveç atyre që ndonjë qytetar del vet dhe i kosit, në të tjerët trotuare nuk kalohet dhe nuk mund të ecësh, pra asnjë trotuar në Komunën e Podujevës nuk është i mirëmbajtur.

Pastaj 3 herë radhazi e vëni shtrimi i rrugëve nga rr."Zahir Pajazit" deri te rr."Skënderbeu" për çka pyes ku janë ato rrugë që do të shtrohen me gjithë atë shumë të mjeteve që është ndarë sepse unë nuk e di ku janë ato rrugë që ju po i shtroni e që ne nuk po i shohim.

Ishte e ndarë edhe shuma prej 150,000.00€ për mirëmbajtjen e lumenjve, kurse për zgjerimin e lumenjve janë 100,000.00€. Pastaj edhe tek prioritetet, çfarë prioriteti është të shkohet dikujt t'i shtrohet asfalti deri në dyer dhe t'i thuhet hapi dyert se po jua shtrojmë edhe brenda kur dihet se cilat prioritete kemi ne e që besoj se prioritet është nëse ne vendosim një kod buxhetor për kompensimin e dëmeve bujqve, prioritet është zgjerimi i lumenjve në mënyrë që të kos na merr uji, përndryshe prioritet shtrimi i 10 - 15 metrave asfalt rrugicat dhe oborret nuk është më, andaj nuk e di qysh i keni zgjedh këto prioritete, me këndë jeni konsultuar apo me çfarë fizibiliteti apo qysh t'ju teket. Po ashtu për shenjëzimin e rrugëve ishte një shumë prej 200,000.00€, pyes ku po shkojnë këto mjete sepse të shenjëzohen rrugët nga rr."Zahir Pajaziti" te rr."Skënderbeu" në shumë 200,000.00€ nuk e di çfarë shenjëzimi i rrugëve është ai me këtë shumë buxhetore kur jemi dëshmitar se me disa vija të bardha në asfalt përfundon ajo, madje ajo rrugë është e shenjëzuar, ndoshta do të mjaftonte ndonjë shumë më e vogël e jo vitin e kaluar 300,000.00€, në këtë vit 200,000.00€ për shenjëzimin e rrugëve, ndoshta po i'u vie më lehtë me vjedh qaty.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, para vetës kemi një dokument mjaft të rëndësishëm që mban ndër vete investimet kapitale dhe buxhetore për vitin 2025, gjegjësisht edhe për vitet 2026-2027 dhe ajo që vëreja te ky buxhet se dallon nga buxhetet e kaluara është i hartuar në përpikmëri për një vit zgjedhor. Vetëm nëse analizojmë te projektet prioritare për vitin 2025 aty fjalën kryesore e ka asfalti, pra një shpërndarje gjithandej territorit të Komunës së Podujevës me shuma të ndryshëm



10,000.00€ - 15,000.00€ vetëm e vetëm të tentohet të mashtrohen qytetarët në fushatën e ardhshme zgjedhore për t'ju votuar edhe për një mandat, metodë kjo e vjetër dhe e skaduar tash më.

Për 4 vite qeverisje nëse i llogaritim rreth 9 milion euro për secilin vit investime kapitale, a mund të na tregoni 1 projekt që e keni përfunduar dhe ka ndikuar direkt në mirëqenien e qytetarëve, 1 projekt i cili është financuar 100% nga buxheti i Komunës së Podujevës, kurse unë tani po ju përmend juve 2 projekte, pra 2 projektet më të mëdha që janë financuar 100% nga buxheti i Komunës së Podujevës është rr."Skënderbeu" dhe rr."Xhemajl Mustafa" dhe tani mund t kuptojmë sepse jemi dëshmitar të gjithë se çfarë pune është bërë në këto projekte, unë them se aty është bërë më shumë krim se sa punë, kemi dhjetëra shkelje ku e para është se patët marrë buxhetin e rr."Xhemajl Mustafa" dhe e keni dërguar te projekti i rr."Skënderbeu" e kjo dihet pse, vetëm e vetëm që edhe projektin e radhës pastaj që ka qenë rr."Xhemajl Mustafa" t'ia jepni Kopanisë së njëjtë, pastaj patët nënshkruar krejt në përfundim punë shtesë ku brenda ditës është nënshkruar kontrata është kryer puna dhe keni bërë pagesën, madje kemi edhe devijim të projektit sepse shkruan zgjerimi ndërtimi i rr."Xhemajl Mustafa" kurse ne jemi në dijeni se nga rrethi që lidhet me rrugën e Kërpimehut, e deri te Lagja Dushkollit është bërë gërryerja e shtresës së vjetër të asfaltit dhe është shtruar shtresë e re dhe çfarë keni bërë tutje është se e keni hap një kanal në mes të rrugës ku keni vendos disa gypa dhe tani vetëm me një shtresë tjetër të asfaltit mendoni ta përfundoni krejt këtë projekt e që në tërësi llogariten afër 3 milion euro këto 2 projekte.

Asnjë projekt i përfunduar për këto 4 vite, a jeni në dijeni se asfalti nuk është as në 5 top prioritetet e qytetarëve, kurse tani po ju jap një shembull konkret, ka qenë një premtim elektorale për fshatin Letanc i cili përballet me problemet e ujit të pijshëm, ndërsa ju shkoni i ndani 40,000.00€ për asfalt në atë fshat, ndërsa ata banor nuk po kërkojnë asfalt por po kërkojnë ujë dhe tash e 4 vite nuk keni arritur t'ju bëni zgjidhje për këtë problem. mandej ndoshta po dal paksa lokalist por po nisem prej fshatit ku jetoj unë dhe po e marr një shembull, për 4 vite qeverisje asnjë metër trotuar, asnjë metër ndriçim publik, por vetëm keni shtruar disa rrugica të vogla sepse aty është interesi.

Kemi të ndara për rindërtimin e rrugëve shumë prej 350,000.00€, kurse kodi tjetër për ndërtimin e rrugëve 300,000.00€ dhe gjitha këto projekte janë te Drejtoria e urbanizmit të shpërndara nëpër fshatra dhe jemi në dijeni se secila rrugë ka emër të veçantë tani më por që nuk ceken sepse duhet t'jua hapni dyert dhe t'jua shtoni edhe oborret, për çka kemi fakte e argumente për të gjitha këto që po e them. Paramendojeni 200,000.00€ për shenjëzimin e rrugëve, janë shpenzuar rreth 3 milion euro kurse ju ndani 200,000.00€ ekstra për shenjëzimin e atyre rrugëve "Skënderbeu" dhe "Xhemajl Mustafa". Unë mendoj se qytetarët do t'ju gjykojnë për krejt këto të bëma që jeni duke i bërë, njëkohësisht e ftoj edhe Prokurorinë të merret seriozisht me këto 2 projekte që i ceka sepse ka shumë shkelje të cilat i kemi paraqitur të gjitha dhe besoj se do ta merrni vendimin e merituar.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, më lejoni që së pari të jap një informacion bazik për kolegun nga LDK (Arjant Topanica), Komuna e Podujevës ka 77 fshatra dhe me Podujevën si vendbanim 78, dhe ka 633 km<sup>2</sup> e që nuk është mirë të harrohen.

Jemi në dijeni se jemi në demokracinë diskursive, pra përfaqësuesve ku secili prej neve ka detyra, përgjegjësi dhe është i mandatuar nga qytetarët tanë Llapjan, ka një mandat i cili fillon dhe përfundon e që njëkohësisht kemi edhe përgjegjësi që zërin e tyre ta ngrisim dhe në momentin që hyjmë këtu kemi përgjegjësi që ato projekte dhe ato kërkesa të qytetarëve t'i dërgojmë te Ekzekutivi i Komunës apo tek personat të cilët i zgjidhin ato probleme andaj pyes a keni marrë ndonjë iniciativë të tillë, unë të paktën nuk kam parë, ose a keni dërguar ndonjë projekt kur jemi në dijeni se janë mbajtur 5-6 dëgjime publike e që unë nuk kam parë ndokënd prej kolegëve të kësaj asambleje nga radhët e opozitës që ka marrë pjesë në dëgjime publike apo që i ka nxitur qytetarët

ose banorët e lokaliteteve ku banojnë ata për të dërguar projekte me qëllim të përfshirjes në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Ne mund të bëjmë konglomerat në kuptimin e keq informimit të qytetarëve, apo më mirë të them ju, por në asnjë mënyrë nuk bënë që ta ndryshojmë realitetin e që realiteti është 9.2 milion për investime kapitale që Komuna e Podujevës nuk i ka pasë asnjëherë, e që realiteti është që të gjitha ato investime shihen ane kënd qytetit të Podujevës, e realiteti është se janë paraparë investime kapitale të cilat me të vërtetë janë në interes të të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe investime të cilat nuk janë bërë asnjëherë. Pra ajo që dua të them është se e kemi buxhetin më të madh, e kemi planifikimin më të mirë buxhetor, kemi planifikim të mirë buxhetor edhe për vitet e ardhshme, planifikim i cili është lehtë të planifikohet por vështirë të realizohet dhe të mbahet, mirëpo me politikën e mira të Ekzekutivit të Komunës e sidomos kam një lëvdatë shumë të madhe për drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili me përpikmëri e bënë punën e tij, pra të gjitha ato planifikime mbahen duke u bazuar në politikën e mira të Ekzekutivit të Komunës, politika të cilat po nxitin investime kapitale në sektorin privat, investime të cilat po gjenerojnë vende të punës, investime të cilat po ndihmojnë tregun e brendshëm lokal që të ngritën dhe po krijojnë mundësi të mira për punësim të të rinjve Llapjan, temë për të cilën kemi folur shumë gjatë. **z.Burim Hasani**, theksoi, ne veç jemi në dijeni se sot jemi në këtë mbledhje lidhur me propozim vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025, normale që diskutimet gjithmonë ndodhin por për këto thashetheme deri tani, të gjitha i kemi sepse na janë dërguar në e-mail që 1 javë apo afër 7 ditë.

Në Komunën e Podujevës përveç projekteve që janë të kamotshme, në këtë vite kemi edhe projekte të cilat nuk kanë ngjasuar me vitet tjera, në lidhje me projektet kemi shembull në shumicën e rasteve që u cek më parë nga disa koleg kemi subvencionimin e Ndërmarrjeve Publike e që në vitet e mëhershme Komuna e Podujevës ka subvencionuar Ndërmarrjet / Kompanitë private ku shumica e shërbimeve janë kryer nga Ndërmarrjet private, tani duhet ditur dhe ta kemi paksa të arsyeshme kur të japim ndonjë propozim, shembull te propozimi tek ndarja e mjeteve ose subvencionimi i ndarjeve buxhetore tek bizneset dhe ndërmarrjet publike duhet të kemi parasysh që ne në vitin e kaluar e kemi themeluar një Ndërmarrje Publike që NPL “Eko-Llapi”, pastaj e kemi funksionalizuar Stacionin e Autobusëve, prandaj këto janë Ndërmarrje Publike që e kanë fillimin dhe që duhet të subvencionohen.

Po ashtu çka është e arsyeshme të dihet lidhur me çështjen e mirëmbajtjes së trotuareve, në shumicën e rasteve e dim që vite më parë janë ndarë mjete buxhetore për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve por kjo ka ndodh në shumicën e rasteve vetëm në një pjesë të qytetit rreth 50% të qytetit, kurse tani duhet pasur parasysh që mirëmbajtja e trotuareve jo vetëm në qytet po kryhet edhe nëpër fshatra përreth ku çdo fshat apo çdo asambleistë prej nga e kemi prejardhjen, pra është NPL “Eko-Llapi” e Komunës së Podujevës e cila është duke i mirëmbajtur trotualet në qytet, rrugës për në fshatin Obrancë, rrugës për në fshatin Bradash, Podujevë, në fshatin Shajkoc dhe me krejt rrethinat.

Përveç këtyre, për herë të parë kemi Kuzhinën Qendrore sepse sa di unë Komuna e Podujevës nuk ka pas Kuzhinë Qendrore, pra për herë të parë është Kuzhina Qendrore dhe këtu dihet arsyeja, do të subvencionohet edhe me ushqime edhe do të bëhet furnizimi i ushqimeve edhe nëpër Çerdhe edhe nëpër Shkolla që veç ka qenë synim dhe premtim.

Përveç Drejtorisë për Planifikimin dhe Zhvillimin Ekonomik, mund të themi që edhe për pjesën e Arsimit tek propozimi i buxhetit janë disa projekte siç është renovimi i 8 shkollave, do të thotë me rregullim kuptohet se kemi të bëjmë me rregullim primar, pastaj përveç renovimit kemi edhe 4 shkolla të reja të cilat do të ndërtohen e që një prej tyre do të ndërtohet edhe në vendlindjen time

në fshatin Bradash ku arsyeja dhe kërkesa ka qenë e kamotshme dhe e arsyeshme, pastaj ndërtimi i shkollës në fshatrat Dobërdol, Llapashticë dhe në Shajkoc.

**znj. Arnisa Sylejmani**, theksoi, jemi mbledhur sot që të diskutojmë rreth projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025, dhe kërkoj disa sqarime përgjigjet e të cilave i kërkoj vetëm nga drejtori i Drejtorisë përkatëse, por jo nga anëtarët e asamblesë nëse ka mundësi.

Në faqen 7 të projektbuxhetit janë planifikuar thuajse 240,000.00€ për mirëmbajtjen e ndriçimit publik andaj pyes a mund ta di a do të jetë gjendja e njëjtë qysh ka qenë në vitin 2024 dhe këtë e them duke filluar nga Sheshi i qytetit ku gjysma e dritave nuk bëjnë dhe duke vazhduar edhe rrugëve tjera të qytetit dhe të fshatrave. Gjithashtu po në faqen 7 janë parashikuar 150,000.00€ për shërbime kontraktuese andaj a mund të na tregoni se çka janë këto shërbime specifikisht dhe cilat janë prioritetet që do të mbulohen me këto fonde.

Gjithashtu kam pyetje sikurse kolegu im z.Ekrem Rrahmani, në faqen 10 të projektbuxhetit për Administratën Komunale janë parashikuar investime për ndërtimin e një aneksi të objektit të Komunës andaj pyes a mund të na tregoni se ku do të ndërtohet dhe cilat janë qëllimet e ndërtimit të këtij aneksi.

Në faqen 12, për rregullimin e infrastrukturës së varrezave janë ndarë 50,000.00€ dhe pyetja ime konkrete për këtë pjesë është se a do të ndërmerreni ndonjë hap konkret për të realizuar këtë projekt apo qysh ndodhi që tani në këtë vit apo qysh ndodhi që në këtë vit nuk keni realizuar asgjë dhe do ta bartni këtë shumë në ndonjë projekt tjetër.

**znj. Arjeta Salihu**, theksoi, kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë përkatëse, kur jemi te pika për subvencionimin e bizneseve dhe Ndërmarrjeve publike, meqë kemi mungesë të transparencës këtu, dua të di a do të ketë përkrahje të grave në biznes dhe a është paraparë te kjo shumë prej 300,000.00€ a është paraparë ndonjë shumë që të ndahet për gratë të cilat zhvillojnë biznesin në vendin tonë, nëse po atëherë do të doja që konkretisht të na tregoni ku shkon dhe për çfarë biznesesh janë ndarë ato mjete dhe a i keni përkrahë me të vërtetë duke parë që këtu kemi pabarazi gjinore në çdo pikë.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, kolegu parafolës z.Burim Hasani veç e konfirmoj atë që e potencova unë sepse edhe po shihet se nuk e ka lexuar materialin. Te kodi mirëmbajtja e trotuareve, ajo është dalë në tender dhe e ka fituar tenderin shumë më shtrenjtë se sa që është dashtë të jetë e që ka qenë kompani e Vetëvendosjes, për mirëmbajtjen e trotuareve dhe rrugëve, pra këtu është kod i veçantë kujt i jepen këto mjete, madje plus edhe mjetet buxhetore që është subvencionimi i kompanive dhe Ndërmarrjeve publike, do të thotë punën e kryen NPL “Eko-Llapi” por faturat dhe paratë i merr Kompania që e ka fituar tenderin.

**znj. Mrika Thaçi**, theksoi, pa dashur të përsëris ato që u ceken deri më tani që kanë të bëjnë me projekt buxheti dhe rëndësinë e tij, dua të bëjë një propozim shumë konkret, fjala është për rr.”Kongresi i Manastirit” propozim ky i cili mendoj se duhet të gjej vend për trajtim në kuadër të këtij buxheti sepse rruga e cekur nga punimet që janë bërë deri më tani është dëmtuar shumë dhe ka mbete në gjendje jo të mirë, kësaj rruge tani i mungon ndriçimi publik, kanalizimi atmosferik si dhe ka nevojë edhe për riasfaltim, ose përndryshe në gjendjen qysh është apo si e tillë është shumë e vështirë për qarkullim.

Nga ajo që kam kuptuar në këtë projektbuxhet për vitin 2025 janë paraparë për investime kapitale mbi 9 milion euro në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit prej tyre mbi 3 milion euro janë paraparë për asfaltime do të thotë më pak se 1 milion euro janë paraparë në qytet dhe mbi 2 milion euro janë paraparë për rrugica në vendbanime rurale për rreth 55 rrugë në ato vendbanime, pa dyshim se mua më gëzon fakti për këto investime por mendoj se duhet shtuar një

kujdes i veçantë edhe rrugëve ndërlihdëse në qytet siç është fjala për rrugën e lartcekur rr.”Kongresi i Manastirit.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, e kuptoj kolegun parafolës përse i’a bënë avokatin NPL “Eko-Llapi”, sepse është shfrytëzuar skajshmërisht për t’i punësuar familjarët e asambleistave dhe aktivitet e pakënaqur. E keni marrë një pozicion për t’i përfaqësuar paksa edhe disa interesa të qytetarëve, por jeni verbuar krejt, veç në interesa personale jeni lëshu, po më vie keç prej juve qysh e keni degraduar pozicionin e asambleistit.

**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi, gjithashtu një çështje tjetër që dua ta bëjë si pyetje është çështja e qenve endacak që vazhdon t’i shqetësoj qytetarët kurse sa kam vërejtur unë në këtë projektbuxhet nuk është ndarë asnjë shumë specifike për trajtimin e kësaj çështje apo menaxhimin e kësaj situatë, prandaj pyes a keni menduar të ndërmerrni ndonjë nismë konkrete për të adresuar këtë problem apo do të vazhdoni duke mos pasuar asnjë veprim të dukshëm.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, buxheti më i madh ndonjëherë, disa projekte të mëdha siç është ndërtimi i Zonës Industriale në Livadicë, pastaj Ndërtimi i Kuzhinës Qendrore për fëmijët në Çerdhe dhe në Shkollë, pastaj kemi ndërtimin e Parkut Industrial Bujqësor si dhe ndërtimi i disa shkollave të reja, renovimi i disa të vjetrave si dhe shumë projekte të cilat u përmenden këtu gjerë e gjatë. Më vie çudi prej disave më herët që e quajtën buxhet të asfaltimit, në anën tjetër po thuhet se përmenden vetëm ndërtimi i rrugëve në fshatra kur në projektbuxhetin e vitit 2025 shihet se janë mbi 60 fshatra që përmenden me emër se ku do të asfaltohen, nuk e di a e kemi të njëjtin projektbuxhet apo jo.

Më befasoj gjithashtu që po shfrytëzohet foltorja për urime, urimet mund t’i bëni në Radio Vizion sepse këtë Qeveri do ta kemi edhe disa vite kështu shumë gjatë, kështu që ju falënderoj shumë.

**znj.Edona Shabani**, theksoi, në fakt jam duke dëgjuar shumë shifra, 300,000.00€, 500,000.00€, 600,000.00€ e të tjera, e besa edhe jam duke dëgjuar edhe shumë avokatë këtu mirëpo nuk është ajo që vetëm të them diçka, i kuptoj ata sepse pastaj duhet të thonë që unë fola, unë të mbrojtja e të ngjashme dhe tash duhet të ma kryesh një punë, por kështu nuk funksionon.

Çështja tjetër, drejtorit të Drejtorisë së Arsimit do t’i thoja që për fëmijët me nevoja të veçanta unë qe gati 4 vite që jam këtu asnjëherë nuk kam parë që është vë një projekt ose që është thënë që do të bëhet diçka për ata fëmijë apo të paktën të ketë ndonjë lidhje me UNICEF apo ndokënd tjetër që ata fëmijë t’i kenë pajisjet që i’u duhen e jo të ndodh që as letra të bardha të mos ketë në atë shkollë siç e kam cekë edhe më parë. Prandaj unë dua që të ketë fokus më të madh për njerëzit që kanë më shumë nevojë, përndryshe sa i përket asfaltit ne jemi në dijeni shumë mirë se kemi jetuar para luftës edhe pa asfalt ose pa e ndërruar asfaltin dhe jemi të mësuar si popull (jemi guri), mirëpo mendoj se jemi duke harruar që ne jemi ata që duhet të punojmë për qytetarët.

Ky vend nuk është i joni, kanë kaluar shumë breza dhe do të kalojmë edhe ne ku një ditë do të ecim nga këtu, por për ata njerëz që janë jashtë dhe nuk janë këtu në institucione duhet të mendoni më shumë, madje në sencën e kaluar i kam thënë një shprehje Kryesuesit të Kuvendit “qefini nuk ka xhepa”, kështu që e përsëris duke ju lutur që të mendoni për ata persona, shkolla përkatëse në Gllamnik vërtetë është shumë keç sepse nuk ka gjëra dhe pajisje, asgjë nuk kanë, prandaj i propozoj që drejtori i Drejtorisë së Arsimit të punojë edhe me drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale sepse unë si asambleiste kam shumë informacione dhe nuk po mund të kryej gjitha punët vet, për këtë është Komuna dhe do të vie koha që do t’i përmendi të gjitha dhe t’ju them se nuk keni qenë në gjendje të ndani një shifër sado të vogël për ata fëmijë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, mora fjalën që sado pak të shfaq mendimin gjegjësisht kontributin tim rreth këtij dokumenti që me të drejtë u potencua nga pjesa më e madh e parafolësve si një dokument ose një vendimmarrje në Kuvendin e Komunës që ndoshta është një prej vendimeve më cruciale për 1 vit kalendarik.

Projektbuxheti i Komunës së Podujevës i propozuar në këtë formë çfarë ne e kemi me mbi 33 milion e 500 mijë euro, nuk kam si të mos e përkrah atë që u potencua disa herë se është buxheti më i madh, mirëpo nga ajo ditë që ne dalim në këtë botë ne çdo ditë bëhemi më të mëdhenj, edhe vitet na shtohen për çdo vit kështu që shoqëria është progresive dhe ec, rriten bizneset, rriten tatimet, rritet TVSH. Andaj normale që edhe buxheti do të jetë më i madh dhe nëse na mjafton kjo që të themi me shifra kemi një buxhet nominalisht më të madhin sepse është ashtu, por ju lus, e potencova edhe në mbledhjen e KPF-së, vetëm një logjik të thjeshtë nëse e përdorim çka do të mund të realizohet para 5 viteve me 9 milion euro buxhet e çka realizohet sot me 9 milion euro, e them këtë sepse vet lëvizjet e tregut dhe çmimeve kanë bërë që sot në kuptimin e vlerës reale ky buxhet nominalisht është më i madh por faktikisht dhe realisht realizim të projekteve vetëm mund të kemi më pak, jo më shumë.

Shumë normale që një buxhet i tillë parashihet të bëhet për nevojat e qytetarëve e që gati çdo njëri foli në emër të qytetarëve e që shumë kush e kemi të drejtën të flasim në emër të tyre e në veçanti ne që na është besuar dhe na është dhënë besimi paksa më i shenjt që t'i prezantojmë këtu në Kuvend Komunal.

Po ashtu më bëri përshtypje që edhe pas tri viteve të funksionimit gjegjësisht të kësaj legjislature të këtij Kuvendi, në kuptimin procedural dhe atë ligjor, lirshëm mund ta marrë diskutimin që e kam pas para 3 viteve dhe i njëjti është edhe sot, po e them në kuptimin që këtu sot pati zëra ndër më të rëndësishmet duke thënë se kemi projekte gjithëpërfshirëse, kemi përfshirë gjitha lokalitetet, kemi konsultuar qytetarët, e kështu me radhë, mirëpo e them se funksionimi i demokracisë gjegjësisht deri te ardhja dhe miratimi i një projektbuxheti në Kuvendin e Komunës, kalohet nëpër disa faza duke filluar nga Strategjia Zhvillimore, Korniza Afatmesme e kështu me radhë, mirëpo specifikisht ky vend sot, dje, nga Shpallja e Pavarësisë e këndeje për të ardhur deri te një buxhet e që po i'a japim vetit të drejtën të flasim në emër të qytetarëve, ka paraparë disa Udhëzime Administrative se si duhet t'i ofrohemi qytetarëve dhe si të afrojmë qytetarin në vendimmarrje, ku jemi ne sot me këtë, a e kemi përfillë Udhëzimin Administrativ për standardet minimale të konsultimit publik, jo.

Gjithashtu e vërejtja se u ngatërrua nga disa parafolës duke përfshirë edhe kolegun z.Arjant Topanica duke parashtrua çështja se a na ka ftuar ndokush neve në ndonjë dëgjim publik, jo nuk na fton askush neve në dëgjim publik por është obligim ligjor që si Kuvend të organizoj dëgjim publik me qëllimin që të shikohet se a i'a ka qëlluar Ekzekutivi i Komunës me dëgjimet publike që ka mbajtur sepse ne si Kuvend e marrim vendimin si dhe a ka mundësi dhe a ka vend për t'u ndryshuar ai projektbuxhet sepse votat tona vendosin për buxhetin. Pra viti i tretë me radhë dhe ne Kuvendi i Komunës në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë publike, kemi miratuar buxhete duke bërë shkelje të dy neneve të këtij ligji, e lëre më të flasë për një diçka kur themi projekte prioritare lë shumë për të dëshiruar dhe lë shumë dilema e pikëpyetje cilat janë ato projekte prioritare, kush i ka bërë ato projekte prioritare, me kë jemi konsultuar për ato projekte prioritare, a kemi pasë para vetës Udhëzimin Administrativ i cili e përcakton saktë procedurën se si vihet deri te një projekt prioritar, fatkeqësisht jo.

Dëshiroj të dal te një diçka më konkret e që vërtetë pash, po e përmendi edhe dikush që në 55 fshatra do të ketë investime, mirë është që përmenden fshatrat *(në veçanti e falënderoj kolegu z.Ragip Fetahu i cila na e hoqi dilemën duke na sqaruar sa fshatra kemi në Komunën e Podujevës, i cili hyri paksa në profesion të gjeografëve mirëpo Ragipit i lejohet).*

Në këto 78 fshatra e pranuar ose jo të gjithë në këtu, gjysma e tyre janë të boshatisura, por mirë që janë përmendur, mirëpo nuk është mirë sepse nuk mund të realizohen projekte me ato shifra çfarë janë paraparë sepse është vetëm sa për t'u përmendur dhe t'ju thuhet jeni pjesë e jona por jo për tu realizuar projekte.

Fundja nuk më kënaq as mua një projekt të më përmendet emri atje i fshatit e që më së paku ishte i përmendur sepse e di që fshati Llugë më së paku përmendet shkak i Kryetarit të Komunës sepse po mundohet të ketë rezerva, mirëpo një prej problemeve shqetësuese që ka pas edhe qytetari por edhe që ky Kuvend është marrë disa herë me të kemi ambientin gjegjësisht gjendjen e lumenjve, nuk e them se nuk është bërë asgjë në këtë drejtim, por larg nga ajo që ta tejkalojmë si rrezik nga vërshimet për aq sa është në dorën e njeriut ngase ka disa rreziqe që janë jashtë ndikimit njerëzor.

Tani po mundohem të jap një propozim konkret sepse një pjesë e parafolësve jepen nga një propozim, pra propozim konkret i imi është që kur kemi Memorandume me Bashkësinë Islame dhe kur kemi të bëjmë me mirëmbajtjen e varrezave, unë mendoj që në këtë buxhet ka dashtë të zë vend një kod i veçantë për mirëmbajtjen e varrezave gjithandej Komunës tonë.

Patjetër më duhet të polemizoj paksa me kolegun parafolës z.Ragip Fetahu, jo me qëllim tendencioz por në kuptimin që e përmendi në një formë të qasjes së vet ndaj kolegëve duke pyetur çfarë projektesh keni prurë ju këtu, më vie keq zotëri Fetahu por roli i këshilltarit të Kuvendit Komunal nuk është me prurë projekte, nuk i'a ndalon askush me dhënë ide, por nuk harton projekte, shfaq shqetësime e që kemi tentuar disa herë që ato shqetësime t'i paraqesim por që janë cunguar. Se sa ne jemi për qytetarin tregon fakti që për gjithë këto vite, viti 2023 dhe po i marrë vitet që nga Shpallja e Pavarësisë, ne edhe sot e kësaj dite nuk kemi Këshilla funksional të Fshatrave e që janë adresë për konsultime me qytetarë.

**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, në projektbuxhetin e Komunës për vitin 2025, për mirëmbajtjen e ndriçimit publik janë ndarë 240,000.00€, ju me i ndarë po i ndani por ndriçim publik nuk ka, rasti konkret është rr."Fitorja" ku nuk ka ndriçim publik për më shumë se 2 javë, atëherë përse nuk po e sanoni meqë veç po keni mjete buxhetore të mjaftueshme dhe kur pritet të rregullohet.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, fillimisht po më vie mirë që z.Naim Çunaku po na kthen në kohë, por interesant do të ishte të shihej edhe përpara se çka do të vie, nuk e di i zotëri Naim çka mendon ti. Çështja tjetër, për ata që e njohin ekonominë, në qoftë se e hedhim një produkt në treg varet prej kërkesës dhe ofertës, në këtë rast është oferta, do të thotë e Ekzekutivit të Komunës që thotë që ku janë mjetet buxhetore, mirëpo mungon kërkesa, e kërkesën kush e dërgon këtu, do të thotë ne jemi përfaqësues dhe delegues të qytetarëve të cilët i dërgojnë kërkesat e tyre në adresën e caktuar, e kjo fatkeqësisht po mungon.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar z.Ragip Fetahu, me qëllimin më të mirë e them se unë nuk jam ai i cili duhet mësuar dikë cili është pozicioni gjegjësisht roli i këshilltarit të Kuvendit dhe nuk pretendoj sikurse ju t'i japësh vetit të drejtë t'ju tregosh të tjerëve se të sillen ata konform mandatit që e kanë marrë, mirëpo për mua udhëzues i veprimit të një këshilltari të Kuvendit komunal është Ligji për vetëqeverisjen lokale, Statuti i Komunës së Podujevës, Rregullorja e punës së Kuvendit, këto pra përcaktojnë se kush është dhe cilat janë kompetencat e një anëtari të Kuvendit.

Kërkesat dhe shqetësimet është shumë normale që paraqiten nga votuesit përmes neve që na kanë votuar neve si përfaqësues sikurse që të kanë votuar edhe ty (i drejtohet z.Ragip Fetahut), por kur jemi te projektet, kur jemi te buxheti i Komunës nuk jemi në këtu që të hartojmë projekte, edhe njëherë e përsërita këtë, dhe nuk jemi në këtu që vrapojmë sepse fundja qysh e përcakton rregullativa ligjore ne jemi këtu madje fare për të mos e shikuar kush dhe çka ka bërë por cili projekt është i arsyeshëm dhe ai projekt i arsyeshëm ta merre votimin e Kuvendit, ngase fundja ne

me vendimet tona i japim orientim zhvillimit, mirëqenies dhe kontribuojmë se ku do të shpenzohet një buxhet komunal.

**z.Burim Hasani**, theksoi, ka replikë me parafolësin z.Naim Çunaku, lidhur me mirëmbajtjen e varrezave, sa i përket planifikimit mund të ketë ndodh që nuk kanë pas as planifikim fare në vitin e kaluar apo saktësisht ndarje buxhetore për mirëmbajtjen e varrezave, por duhet pasur parasysh se mirëmbajtja e varrezave tani e tutje bëhet nga NPL “Eko-Llapi” ku kemi filluar me mirëmbajtjen e një pjese të qytetit (tek hekurudha) dhe mirëmbajtja e varrezave gjatë planifikimit në Ndërmarrjen publike, nga Bordi i Drejtorëve dhe nga Kryeshefi është e planifikuar që së shpejti të fillohet edhe në pjesët tjera të qytetit duke pasë parasysh se një pjesë e tyre është duke u mirëmbajtur nga një Kompani private, ndërsa pjesa tjetër që nuk kanë mirëmbajtje do të mirëmbahen, pastrohen, kasiten dhe krasiten, pra kjo sa i përket pjesës së varrezave të qytetit në këtë vit dhe në vitin e ardhshëm.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar z.Burim Hasani, me mirëkuptimin më të madh po mundohem të polemizoj diçka me ju, kjo qasja juaj, kemi paraparë.., nuk fol për rolin tuaj sepse nuk je ti dhe të paktën nuk e ke mandatin diçka me Ndërmarrjen publike, e para, ndërsa çështja e dytë unë të paktën kam asi mendimi që Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Llapi” të gjithë ne këtu e kemi votuar dhe e kemi numëruar si lehtësim për punët dhe obligimet që na dalin si Komunë e Podujevës dhe më lehtësisht, më afër dhe më me përgjegjësi t’i kryejmë si dhe me kosto më të ulët, pra kur është ndërtuar kjo Ndërmarrje e cila ka marrë votë për edhe nga ne, ky ka qenë synimi, kurse tani të më tregoj këtu në foltore që NPL “Eko-Llapi” e ka këtë e ka atë, unë them se NPL e ka gjithë atë që ky Kuvend gjegjësisht ky Ekzekutiv komunal vendosin cilat punë t’ia kalojnë për t’i kryer NPL “Eko-Llapi” si dhe duhet të ketë një Memorandum ose një Kontratë apo një bashkëpunim kush di çfarë si do ta quajnë mes NPL “Eko-Llapi” dhe Komunës së Podujevës sepse mirëmbajtja e varrezave nuk është përgjegjësi e kësaj Ndërmarrje por është përgjegjësi e Komunës dhe Komuna atë përgjegjësi të vetën e kryen duke përcaktuar një Operator ekonomik i cili i’ua kryen atë, dhe në këtë rast si partner dhe si themelues e zgjedhim këtë Ndërmarrje.

Po ashtu edhe një fjali të cilën fillimisht u tërhoqa si segment që nuk kisha qëllimin, dikush përmendi shkarazi, Ndërmarrjet Publike Lokale i ka themeluar ky Kuvend, aksionarët janë nominuar nga ky Kuvend, pyeteni çdo njëri prej nesh vetën, e kanë obligim ligjor të raportojnë sepse ata në emër tonin janë shkuar atje, a ka raportuar ndonjëherë ndokush, apo kështu vetëm në formën e “fontanë dëshirash” qohet dikush duke përdoruar “akraba” atje, ose tjetra formë po du t’ia bëjë një favor atij ose këtij.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, plotësisht pajtohem me kolegun z.Naim Çunaku sa i përket pjesës së mirëmbajtjes së varrezave dhe mendoj se është një prej punëve më të mira që do të mund ta bënte Komuna e Podujevës që të merret me këtë çështje. Sigurisht se ne nuk po diskutojmë vetëm për varrezat e qytetit por edhe për varrezat nëpër fshatra, kështu që formën, mëryen qysh e gjen Komuna qoftë përmes Ndërmarrje publike që u cek dhe që e kemi themeluar këtu në këtë Kuvend, ose përmes subvencionimit të ndonjë kompanie private, mirëpo një prej punëve më të mira do të ishte sepse ne të gjithë e dim se në shumë fshatra gjendja e varreza është e tmerrshme., kështu që e përsëris se do të ishte një prej punëve të mira nëse mund ta përfshijmë në buxhet, ta kemi një kod buxhetor qoftë përmes NPL “Eko-Llapi” qoftë përmes ndonjë kodi tjetër buxhetor që mund ta ndajmë si iniciativë fillimisht vetëm për vitin e ardhshëm për një pjesë dhe pastaj të vazhdohet për çdo vit të ndahet buxhet dhe subvencionim.

**znj.Arjeta Salihu**, theksoi, edhe një pyetje e kam për drejtorin e DBF-së, në këtë projektbuxhet a është paraparë diçka për Shoqatën “Handikos”, pra a është paraparë ndonjë shumë e caktuar buxhetore për atë kategori duke ditur që është mëse e nevojshme kjo pjesë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa po vërej nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën nga anëtarët/et e Kuvendit, andaj konsideroj se debati u shterr për këtë pjesë dhe fjalën i'a jap drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave z.Fatlum Osmani.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e DPKGJ, ju falënderoj për pyetjet dhe diskutimet e bëra lidhur me projektbuxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2025, si dokument i cili pa dyshim ashtu siç u cek edhe nga ju është dokumenti ndoshta më i rëndësishmi i cili miratohet brenda vitit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe që propozohet nga ana e Ekzekutivit të Komunës.

Po bëjë përpjekje të përgjigjem në formë të përmbledhur për të gjitha ato çështje që u shtruan nga ana e asambleistëve, duke filluar nga z.Arjant Topanica i cili shtroj disa çështje lidhur me prioritetet e përfshira në këtë buxhet të vitit 2025 duke bërë një konstatim që vazhdon të jetë prioritet asfalti, siç e shihni dhe ashtu siç unë e ceka edhe në fjalën hyrëse prioritetet e këtij buxheti janë Arsimi, Ekonomia, Kultura, Bujqësia dhe këto prioritetet i përmendi sepse në rast se e krahasojmë këtë buxhet me të kaluarën dhe në rast se krahasojmë këtë buxhet me investimet në infrastrukturën rrugore, ta zëm buxheti i planifikuar në Arsim të cilin me kënaqësi e kemi prioritetizuar në buxhetin e vitit 2025 janë 1,970,000.00€, me Qarkoren Buxhetore të lëshuar nga ana e Ministrisë së Financave janë rreth 110,000.00€ ku ne si Ekzekutiv dhe ju si Kuvend i Komunës e kemi detyrim t'i miratojmë pra 110,000.00€ mirëpo nuk na ndalohet ta rrisim buxhetin në Arsim e që nga grandit i përgjithshëm kemi marrë nga kjo kategori diku më shumë 1,800,000.00€ dhe i kemi transferuar në Arsim e që tani janë afër 2 milion euro për investime në Arsim që ka projekte siç është ndërtimi i shkollës së mesme, ndërtimi i shkollave në fshatrat Bradash, Dobërdol, pastaj përmirësimi i infrastrukturës fizike shkollore që ka të bëjë me renovime në shumë shkolla aty ku shfaqet nevoja për renovime, mandej është projekti i Kuzhinës Qendrore projekt ky i cili është në kuadër të një reforme dhe hapjes së Çerdheve të reja ku kjo Kuzhinë do të luaj rol të përgatitjes së ushqimit për të gjithë fëmijët nëpër çerdhe e që brenda këtij mandati mendohet të shkohet deri në 10 Çerdhe që do të hapen në Komunën e Podujevës, pra ka qenë 1 Çerdhe dhe tani trendi ka ec dhe disa janë funksionalizuar e disa janë në proces të funksionalizimit, disa do të fillojnë të ndërtohen në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, kështu që kjo ka shfaq nevojën që edhe përgatitja e ushqimit të centralizohet për arsye se është edhe më efikase goftë në kuptimin ekonomik ashtu edhe në kuptimin organizativ dhe që ajo Kuzhinë Qendrore do t'i shërbejë edhe shkollave tjera ku mësimin tërë ditë mundëson që ta bëjmë përmes Kuzhinës Qendrore.

Për Bujqësi në të kaluarën kanë qenë 460,000.00€ - 430,000.00€ për subvencione, tani janë 750,000.00€ pra është dyfishim i buxhetit dhe njëkohësisht prioritetizim ngase nuk është dyfishuar buxheti i Komunës së Podujevës nëse e krahasojmë me buxhetin e viteve para rreth 3-4 viteve, pastaj te projektet kapitale në fushën e Bujqësisë kemi një projekt tejet të rëndësishëm të cilin po e përsëris që është për herë të parë që do të fillojë në Kosovë që është Parku Industrial Bujqësor që do të ndërtohet në fshatin Sfeçël.

Te Shëndetësia ka një rritje të madhe të buxhetit në kategorinë e mallrave, tani për investime kapitale janë rrumbullakësuar projektet me përfundimin e Urgjencës së Qytetit, QMF-të në fshatrat Lluzhan e Gllamnik, pra janë rrumbullakësuar projektet që kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve shëndetësore andaj tani nevojat kryesore janë furnizimet e që ka buxhet të mjaftueshëm edhe për pajisje mjekësore prandaj mund të themi se buxheti për Shëndetësi është i mjaftueshëm në këtë projektbuxhet dhe plotëson të gjitha nevojat e shëndetësisë duke pasë parasysh që i kemi dhënë prioritet janë të paraqitura dhe nuk ka mbete asgjë mangu nga nevojat dhe kërkesat të cilat janë të sektorit të Shëndetësisë në mënyrë që të funksionoj normalisht ky sektor.



Te Ekonomia, dihet se Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ka qenë sa për numër dhe për disa shërbime administrative të cilat kanë pasë të bëjnë kryesisht me regjistrimin e bizneseve, subvencione në të kaluarën nuk ka pasë asgjë kurse tani kemi 300,000.00€ për subvencione, kjo tregon shumë sepse matematikisht treqindmijë thye për zero është pa kufi, kështu që rritja është e pamatshme thuajse. Po ashtu ka projekte të investimeve kapitale siç ndërtimi i Zonës Industriale që është bashkëfinancim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë projekt ky i cili është i madh dhe kap shumën rreth 3.8 milion euro dhe së shpejti shpresojmë se do të fillon edhe ndërtimi, është licencuar ngase ka qenë një fazë shumë e rëndësishme sa i përket pronave, shpronësimit, themelimit të Zonës Industriale, krejt ky proces është kryer dhe tani ka mbete vetëm ndërtimi i infrastrukturës, po ashtu edhe Plani Rregullues i Hollësishëm është miratuar, andaj së shpejti do të fillojmë me përgatitjen e thirrjes publike për investitorët e interesuar që besojmë se do të ketë në Zonën Industriale.

Sa i përket buxhetit për lumenj që po ashtu i cek nga z.Arjant Topanica, besoj se do të sqaroj edhe drejtori i Drejtorisë përkatëse mirëpo janë të ndara 100,000.00€ dhe ndoshta janë pak, por ky do të jetë një projekt bashkëfinancim me Ministrinë përkatëse e cila ka ndarë 5 milion euro dhe i ka në projektionet e veta buxhetore e që tani ne duhet të jemi bashkëpjesëmarrës me një shumë të vogël buxhetore në mënyrë që të përmbillet si projekt dhe të zgjidhet problematika e lumenjve,

Po ashtu nga i përmenduri u cek edhe furnizimi me kabinete shkollore, por unë e them se përgjatë këtyre viteve edhe është shtuar buxheti në Arsim por edhe në mënyrë specifike është shtuar buxheti për kabinete, shembull te buxheti për shkencat natyrore sa jam në dijeni sot janë të furnizuara me këto kabinete, shtu kësaj edhe kabinete të informatikës ka pasë kështu që kjo është një shumë e mjaftueshme për t'i plotësuar edhe disa kabinete të tjera ngase pothuajse është një projekt i cili vazhdimisht përgjatë këtyre viteve është investuar.

Sa i përket çështjeve për Shtëpinë e Shëndetit vetë se u përgjigja, edhe tek subvencionet në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik i sqarova projektet të cilat kanë të bëjnë në investimet kapitale në fushën e zhvillimit ekonomik sikurse që e sqarova edhe çështjen e subvencioneve në këtë Drejtori.

Gjithashtu z.Bashkim Sylja i ngriti disa çështje lidhur me Shëndetësinë, unë e përsërisë i nderuar që ka buxhet të mjaftueshëm fusha e Shëndetësia, po ashtu edhe grandit specifik i jep buxhet të mjaftueshëm mirëpo edhe te grandit specifik për Shëndetësi kemi kontribuar nga grandit i përgjithshëm kështu që edhe në kategorinë e mallrave për çdo nevojë që ka Shëndetësia mirëpo edhe te investimet kapitale që tani kryesisht ka nevojat për disa pajisje ato janë të buxhetuara dhe do të prokurohen në vitin 2025 në mënyrë që të bëhen furnizimet e nevojshme duke përfshirë edhe një autoambulancë e cila është e planifikuar. Sa i përket të hyrave vetanake që i ceku zotëri Sylja, këto janë të planifikuara me Qarkore Buxhetore e që ne në planifikimet buxhetore nuk mund ta tejkalojmë mirëpo në rast që si Komunë arrijmë të mbledhim të hyra më shumë atëherë përmes Kuvendit të Komunës ato mjete alokohen në ato projekte që ne bashkërisht e vlerësojmë dhe e konsiderojmë të arsyeshme.

Sa i përket subvencioneve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit janë subvencione të cilat kanë të bëjnë sipas Marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame. Po ashtu subvencionet në Shëndetësi vlen të ceket se në të kaluarën kanë qenë 70,000.00€ kurse tani janë 300,000.00€ në këtë projektbuxhet e që edhe kjo tregon se është i mjaftueshëm ky buxhet.

Po ashtu z.Bashkim Sylja e shtroj çështjen e ndërtimit të Zonës Industriale ku e ceku shumën buxhetore 200,000.00€, është e vërtetë se 200,000.00€ janë të pa mjaftueshme por 3 milion e 500 mijë euro i investon Ministria ndërsa ne 380,000.00€, 200,000.00€ janë të planifikuara kurse

180,000.00€ do t'i marrim qoftë nga tejkalimi i të hyrave vetanake apo diku tjetër por që do të sigurohen këto fonde.

Disa çështje të cilat i shtroj z.Ekrem Rrahmani sa i përket numrit të të punësuarve, unë vetëm i përsërita propozimet e reja në raport me propozimin që e keni marrë me thirrjen e mbledhjes, pra ato që i ceka në fjalën hyrëse janë përmirësime nga propozimi fillestar duke cekur edhe arsyen sepse në të kaluarën numri i asambleistëve nuk ka qenë në kuadër të numrit total të të punësuarve të aprovuar nga ana e Ministrisë së Financave ndërsa tani është inkuadruar dhe pastaj na u imponua ky përmirësim që i ceka në fjalën hyrëse për çdo program sa i përket numrit të të punësuarve. Vlen të ceket se rritja e numrit të punësuarve ka ndodh në 2 programe, në programin e Shëndetësisë dhe në programin e Arsimit e që në qoftë se e krahasojmë me këtë vit që jemi 2024 tani numri do të rritet për 20 të punësuar në sektorin e Shëndetësisë që mendojmë se pa dyshim është lajmë shumë i mirë dhe kjo është me Ligjin e Qeverisë për buxhet dhe me Qarkoren Buxhetore, si dhe për afër 15 është numri i rritur i të punësuarve në sektorin e Arsimit e që kjo kryekëput shkon në Arsimin parafillor dhe atë për hapjen e Çerdheve, normalisht se arsimit i mesëm dhe fillor është i kompletuar mirëpo hapja e Çerdheve të reja ka nevojë për staf shtesë.

Sa i përket pyetjes për ndërtimin e aneksit të Komunës, edhe salla e asamblesë komunale që u cek, mendoj se më shumë është çështje inxhinierike por ne që jemi këtu jemi në dijeni se diçka ka nevojë për aneks shtesë të Komunës mirëpo pastaj zgjedhja teknike e ndërtimit se qysh do të bëhet normalisht se është zgjedhje inxhinierike qoftë për ndërtimin e sallës së re të asamblesë qoftë për diçka tjetër por që ky buxhet është i domosdoshëm për ndërtimin e një aneksi të Komunës i cili do të ofroj zgjidhje për problematikat e hapësirës që po përballet në kuadër të administratës komunale. Për mirëmbajtjen e trotuareve dhe mirëmbajtjes e lumenjve, do të thotë është cekur se ka një rritje të buxhetit në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit e cila ka të bëjë me mirëmbajtjen dhe normalisht ky është buxhet i planifikuar kurse pastaj çështja e kontraktimit me Operator Ekonomik është çështje e prokurimit, u cek disa herë NPL "Eko-Llapi" e cila është themeluar dhe punët të cilat arrin t'i kryej nuk prokurohen sepse angazhohet direkt kjo Ndërmarrje. U shtruan disa çështje nga z.Qëndrim Softolli, çështje të cilat kryesisht u cekën edhe nga parafolësit dhe po besoj që për pjesën dërmuese të tyre veç u përgjigja me theks ato që patën të bëjnë me prioritetet, asfaltimet dhe çështje tjera që prioritizohen dhe planifikohen me këtë buxhet. Po ashtu znj.Arnisa Sylejmani i shtroi dy çështje të cilat kanë të bëjnë me çështjen e mirëmbajtjes së ndriçimit publik, mirëpo tani kemi të bëjmë me buxhetin e vitit 2025, është problematika dhe ka nevojë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe kemi rritje të buxhetit për mirëmbajtjen e ndriçimit publik që do t'iu përgjigjet nevojave përgjatë vitit 2025, sa i përket shërbimeve kontraktuese tjera në shumë 150,000.00€ kjo ka të bëjë me disa aktivitete siç janë çështja e dezinfektimit, mirëmbajtja e kanalizimit dhe disa mirëmbajtje tjera të cilat janë në kuadër të këtij kodi ekonomik për shërbimet kontraktuese. Për aneksin e Komunës veç se u përgjigja pak më parë.

Çështja e subvencionimit të Shoqatës "Handikos" që u shtrua nga znj.Arjeta Salihu, kjo bëhet në kuadër të subvencioneve në drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ku kemi ndarë një buxhet në shumë 300,000.00€ e që është një rritje e konsiderueshme e buxhetit dhe normalisht financimi i Shoqatës "Handikos" që është bërë përgjatë këtyre viteve ligjërisht është e rregulluar në atë mënyrë që ajo si OJQ që funksionon duhet të aplikoj në kuadër të thirrjes publike të Drejtorisë së cekur dhe normalisht subvencionohet ashtu siç ka ndodh në këto vitet e fundit.

Edhe znj.Tringa Sfishta ngriti çështjen e mirëmbajtjes së ndriçimit publik për çka veç se u përgjigja pak më parë, ndërsa sa i përket çështjes së mirëmbajtjes së varrezave ka një rritje të buxhetit që kemi ndarë në kategorinë e shërbimeve publike dhe duhet të shikohet mundësia qoftë

me NPL “Eko-Llapi” qoftë ndonjë formë tjetër që të zgjidhet kjo çështje në kuadër të mundësive buxhetore që të mirëmbahen varrezat.

Sa i përket çështjes së subvencioneve dhe përfshirjes së grave në biznes që po ashtu u ngrit si pyetje nga ana e znj.Arjeta Salihu, ju them se në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik janë 300,000.00€ për subvencione dhe Rregullorja për ndarjen e subvencioneve i’u jep një përparësi sa i përket pikëve të fituara ku aplikojnë biznese që janë në pronësi të grave në mënyrë që ato të mbështeten, do të thotë në thirrjet publike kanë disa pikë shtesë e që në raport me burrat i’u jepet prioritet grave, mirëpo normalisht duhet t’iu përmbahemi Rregullores për ndarjen e subvencioneve e cila është miratuar në këtë mandat nga ana e Kuvendit të komunës së Podujevës, pra e mira është që ka buxhet për subvencionimin e bizneseve dhe të Ndërmarrjeve Publike por që kryesisht do të priorizohen dhe atë ka ndodhë përgjatë këtyre viteve bizneset prodhuese.

Pra këto ishin sqarimet dhe përgjigjet ndaj çështjeve të shtruara nga anëtarët/et e Kuvendit të komunës sa i përket projektbuxhetit të Komunës për vitin 2025, që u mundova ti përfshijë të gjitha.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, drejtori parafolës i DBF-së për 2 projekte i iku 2 pyetjeve, fjala është për projektin e shenjzimit vertikal dhe horizontal në vlerë 200,000.00€, dhe te mirëmbajtja e trotuareve. Po ashtu drejtori parafolës përmendi 150,000.00€ për shërbime kontraktuese tjera, mirëpo kjo shumë është veç në një Drejtori ndërsa ka mjete tjera të ndara nëpër të gjitha Drejtoritë tjera thuajse për vitin 2025 janë 797,000.00€ për shërbime kontraktuese tjera prandaj kjo ishte pyetja që e shtrova unë përse gjithë kjo shumë buxhetore për shërbime kontraktuese tjera.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e DPKGJ, theksoi, sqarim parafolësit, shërbimet kontraktuese tjera, varësisht nga Drejtoritë, shembull në Drejtorinë e Arsimit kontraktohet transporti i nxënësve që është një buxhet i konsiderueshëm për t’i mbuluar këto shërbimet e transportit, për shërbimet Publike veç se i’u informova më parë, pastaj për shërbimet e tilla në Administratë ka të bëjë me disa mirëmbajtje ose shërbime tjera të cilat kontraktohen siç është sistemi i ngrohjes, mirëmbajtje e elektrikes si dhe çështje tjera mirëpo ato pastaj specifikohen në plan të prokurimit dhe gjithçka shkon përmes procedurës së prokurimit.

**z.Avni Fetahu**, drejtor i DKA, theksoi, u parashtroi disa pyetje prej asambleistit që vie nga fshati Sfeçël rreth çështjes së shkollave me tri ndërrime, pra bëhet fjalë për shkollën ekonomike dhe një shkollë që ju nuk e potencuat fare që është shkolla “Naim Frashëri”, por do të ishte mirë që nganjëherë asambleistët të japin edhe alternativa e që ne alternativën veç e kemi dhënë dhe disa prej tyre vetëm i kemi përmirësuar. Shkolla “Naim Frashëri” edhe ju jeni në dijeni se subjekti jua politik dhe ish subjekti im e ka kritikuar kur është rrëzuar ajo godinë me shumë rëndësi që ka qenë shkolla “Naim Frashëri” për interesa të asaj kohe dhe është ndërtuar një shkollë ku për vite të tëra është punuar me tri ndërrime, dhe sot ajo shkollë punon me dy ndërrime falë investimit që është bërë në vitin e kaluar dhe në këtë e që jemi e që tani atë shkollë e kemi me dy ndërrime.

Në shkollën ekonomike, edhe unë kam punuar aty si mësimdhënës dhe ka punuar me tri ndërrime, pra e kemi gjetur ashtu dhe alternativa është për t’u ndërruar shkolla e re, kurse ajo shkollë për t’u shndërruar në shkollë fillore me qëllim që t’i plotësojmë nevojat e komunitet në qytet.

Sa i përket projekteve për kabinete veç se u potencua nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, pra ajo shumë që është ndarë tani i plotëson nevojat për blerjen e kabineteve që është si nevojë e disa kabineteve tjera që tani po shkojmë në atë drejtim, dhe se duke u nisë nga fshati juaj Sfeçël (i drejtohet z.Arjant Topanicës) do të ishte mirë t’i vizitoni ndonjëherë sepse keni kabinetet për biologji, kimi, fizikë, informatikë, madje edhe muzikë, e në të njëjtën kohë është mirë t’i potenconi sepse vini nga ai lokalitet që pa marrë parasysh përbërjes së votave që ka qenë në mes subjektit LDK dhe LVV, prap është ndërtuar Çerdhja në atë lokalitet e që është mirë të përmendet

dhe nuk duhet të të vie marre ta përmendësh, gjithashtu edhe palestra sportive po në atë vend e që është në këtë buxhet e nuk duhet të të vie marre prap ta pontencosh edhe atë, kështu që këto janë projekte të cilat i kemi realizuar e për të cilat ju po flisni që janë në proces.

U tha po ashtu se a ka ndonjë projekt që Komuna e Podujevës e ka financuar 100% dhe që është kryer, po mor ka, mudn të vini me mua dorëpërdorë dalim shkojmë në fshatin Obrancë e vizitojmë shkollës e atij fshati, pastaj shkollën e fshatit Dumosh, Çerdhen në qytet, Çerdhen në fshatin Lluzhan, Çerdhen në fshatin Sfeçël, pa i llogaritur edhe këto tjerat që janë duke u punuar, pra këto janë projekte me 100% të financuara nga buxheti i Komunës tonë dhe të Ekzekutuara e që shihen dhe nëse dëshironi edhe me foto, me dron por edhe live.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSh, theksoi, sa i përket Drejtorisë që unë e udhëheqë u shtruan një varg pyetjesh dhe u kërkuan një varg sqarimesh e që pati edhe pyetje të ngjashme prej disa asambleistëve mirëpo si më me rëndësi ato që unë i evidentova dhe që janë më me rëndësi unë në do t'iu përgjigjem të gjithëve. Po filloj nga mirëmbajtja e trotuareve që u diskutua shumë duke u potencuar se po i mirëmban NPL "Eko-Llapi" pastaj dikush tjetër e ceku se po mirëmbahen nga kompani private e të ngjashme, por një gjë duhet ta kemi të qartë të gjithë se mirëmbajtja e trotuareve nuk nënkupton vetëm largimin e barishteve prej trotuareve, mirëmbajtje të trotuareve nënkupton edhe ndërrimi i kabëzave në rastet kur ato janë të dëmtuara, edhe ndërrimi i skajoreve në rastet kur ato janë të ndërtuara, edhe pastrimi i bankinave të tjera rreth trotuareve prandaj është lidh kontratë me operator privat meqë NPL "Eko-Llapi" tash ka filluar punën e që ne t'ju them të drejtën jemi shumë të kënaqur me angazhimin e saj dhe e ka lehtësuar shumë punën në mirëmbajtjen e infrastrukturës publike në përgjithësi mirëpo që janë disa punë që ende kjo Ndërmarrje nuk mund t'i kryej vet siç është ajo që e ceka sa i përket mirëmbajtjes së trotuareve, ndërrimi i kabëzave, anësoreve, zhavorri e të tjera të ngjashme, prandaj kjo është arsyeja pse lidhet kontratë edhe me operator privat për mirëmbajtjen e trotuareve, kurse punët të cilat i kryen operatori privat nuk i kryen Ndërmarrja Publike, do të thotë largimin e barishteve nga trotuaret nuk e kryen Ndërmarrja Publike Komunale, por e bënë ndërmarrja private siç është ndërrimi i kabëzave dhe gjithë tjerat që i përmenda pak më parë, megjithatë në gjendjen që kanë qenë trotuaret dhe në gjendjen çfarë janë tani nuk besoj se duhet të flasim shumë sepse janë gjëra të cilat shihen, për çdo ditë ecim nëpër trotuare dhe mund të shohim qysh ka qenë gjendja më herët dhe qysh është tani e që mund të them se gjendja ka qenë aq e keqe që shpeshherë e kemi diskutuar edhe mos investimin në rregullime të reja në trotuare pikërisht për shkak të mirëmbajtjes së tyre, mirëpo tani kur kanë filluar të mirëmbahen dhe po duken aq bukur me një punë aq të madhe që po behet edhe nga Ndërmarrja Publike në fjalë besoj se do të vazhdohet edhe me rregullimin e trotuareve të reja e që këtu u lidh paksa edhe me një kërkesë që ishte individuale me sa e dëgjova e që po diskutojmë për buxhetin në përgjithësi, pra ishte çështja e mungesës së trotuarit në fshatin Sfeçël e që unë e di që në vitin e kaluar është ndërtuar një gjatësi bukur e madhe në fshatin Sfeçël, mirëpo nuk mund të fokusohemi tani vetëm në një fshat sepse ka shumë kërkesa të shumë fshatrave tjerë. Jam në dijeni se në fshatin Sfeçël është një kërkesë për ndërtimin e trotuarit në rrugën kryesore që besoj se në kontrata e radhës do ta shqyrtojmë dhe nëse del të jetë prioritare prej të gjitha kërkesave tjera sigurisht se do të investohet edhe në atë trotuar që është e vetmja kërkesë për trotuare në fshatin Sfeçël sa unë jam në dijeni se i kam në zyrën time.

Çështja tjetër që ndërlidhet shumë me një gjithëpërfshirje të pyetjeve që ishin është edhe sinjalistika, është goxha absurde të mendohet se sinjalizmi i rrugëve është vetëm në vija horizontale që i kemi bërë vija të bardha e të kuqe nëpër qytet e që janë dukur bukur dhe po vazhdojnë të duken bukur, mirëpo sinjalistika nënkupton edhe shenjzim vertikal, edhe panelet e vendosura të rregullave të komunikacionit që janë vendosur në hyrje të qytetit - tek rrethi ku është

vendosur shqiponja dhe që tjetra që ka filluar të vendoset edhe tek rruga tjetër “Skënderbeu”, pastaj sinjalistikë është edhe disa radar informues që janë planifikuar, pastaj edhe disa ndriçues në vendet e këmbësorëve që janë planifikuar për të cilat kontrata ka qenë dy vjeçare dhe shuma prej 200,000.00€ që u përmend është pjesë e këtij viti sepse kjo ka filluar në vitin e kaluar dhe përfundon në këtë vit dhe kjo është më shumë kontratë që është e lidhur dhe që në një mënyrë e kemi borxh për punët që ende nuk janë kryer, po e quaj borxh në kuptimin që ekziston një buxhet i planifikuar dhe që shpenzohet brenda këtij viti, ndërsa për pjesën tjetër të sinjalistikës duhet të lidhet kontratë e re mirëpo duhet pasur të qartë se nuk kemi të bëjmë vetëm me vijat, por ka plotë gjëra tjera e mund ti shihni brenda kontratës meqë ato janë publike dhe mund të analizoni gjithsecili se çka parashihet në atë kontratë.

Çështja tjetër që u ngrit dhe që është me rëndësi është ndriçimi publik e që është një shqetësim jo vetëm i juaji por edhe i joni, e dim që ka shumë defekte në ndriçim publik, në fakt jemi vonuar me lidhjen e kontratës por jo për fajin tonë sepse fillimisht pikërisht për shkak të këtyre problemeve të mëdha sa i përket ndriçimit publik ne në fillim të këtij viti kemi nisë procedurën e një analize të fizibilitetit për ndriçimin publik në tërë territorin e Komunës së Podujevës e që një territor shumë i madh është i mbuluar me ndriçim publik e që tani ka kaluar me mbi 300 km ndriçim publik në territorin e Komunës së Podujevës e që sigurisht se nevojiten shumë mjete buxhetore për mirëmbajtjen e tij, ndërsa këtu u tha përse janë të parapara 240,000.00€ për ndriçim publik, kurse unë ju them se edhe ajo shumë është pak, ndërsa juve ju duken shumë, sepse sigurisht po e vëreni edhe ju se ka shumë probleme. Analiza e fizibilitetit na ka vonuar në projekt sepse nuk kemi pas mundësi paralelisht me analizë të fizibilitetit të iniciojmë edhe kontrata të reja për mirëmbajtje dhe zgjerim të rrjetit, kurse pasi kemi parë analizën e fizibilitetit e kemi konstatuar që, ashtu siç kemi menduar ne ta bëjmë një ndriçim publik smart (të mençur) në Komunën tonë, ka dal se është shumë i kushtueshëm dhe tani më Komuna e Podujevës nuk i ka mundësitë buxhetore të filloj me atë projekt e që shpresojmë të filloj në të ardhmen kur të krijohen mundësitë për ndërrimin e këtij rrjeti apo instalimin e ndriçimit smart në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

Për informacionin e juaj tani jemi në fazën e vlerësimit të kontratës për mirëmbajtje dhe mund të ndodh që dje është shpallur fituesi e që me t’u lidhur kontrata të gjitha problemet që janë të shumta përfshirë rr/”Fitorja” që u përmend ka edhe shumë rrugë tjera që ne i kemi identifikuar dhe do t’i rregullojmë së shpejti. Nuk interes a i joni e as i juaji që të vendoset një trup ndriçues diku dhe ai të mos funksionoj mirëpo janë disa procedura që herë pas herë na paraqesin vonesa dhe duhet të zhvillohen si procedura.

Sa i përket lumenjve, nuk është punuar në ndërtimin e rrjetit të lumenjve por unë e dëgjova si shqetësim këtu kur u cek shuma prej 150,000.00€ për mirëmbajtjen e lumenjve, kurse për ndërtim, rregullim apo zgjerim të lumenjve vetëm 100,000.00€, çështje të cilën veç se e sqaroj drejtori i DBF-së që ato 100,000.00€ janë vetëm sa për t’i iniciuar procedurat për bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës tashmë me buxhetin e ndarë nga kjo Ministri, ndërsa te mirëmbajtja e lumenjve kjo nënkupton vetëm deblokimin e disa pjesëve të lumenjve që janë shumë problematike dhe që mund të paraqesin edhe vërshime e që tani vetëm jemi duke shkuar në fazën kur mund të ketë vërshime, pra si kontratë është e lidhur dhe e kemi ruajtur dhe vazhdojmë ta ruajmë për raste eventuale më të vështira sepse kur të fillojnë shirat sigurisht se edhe kërkesat shtohen për deblokim të pjesëve të lumenjve andaj kjo kontratë është vetëm sa për mirëmbajtje, ndërsa për rregullimin e shtretërve të lumenjve është në procedurë dhe fatkeqësisht na është vonuar shumë si procedurë një projektim i lumenjve gjë që na mundëson shumë edhe lidhjen e Memorandumit me Ministrinë përkatëse për shumën 5 milion euro që u cek, por edhe na jep një rezymë të qartë se sa do të na kushtojë rregullimi i lumenjve në territorin e Komunës së Podujevës e që sipas asaj që

gjithë ne po shohim do të del një kosto shumë e lartë. Unë ju them se në projektim janë të gjithë lumenjtë kryesor duke përfshirë lumin Llap, lumin Dumnica, lumin Batllava dhe lumin Kaçandolli, por lumit Llap i bashkëngjiten edhe disa pjesë siç është pjesa e fshatit Halabak, pastaj lumi që rrjedh nga fshati Obranqë, do të thotë të gjithë këta lumenj janë të përfshirë në projektimin e lumenjve e që me t'u kryer projektimi ne do të iniciojmë procedurat bashkërisht me Ministrinë e cekur për rregullimin dhe ndërtimin e shtretërve të lumenjve.

Ishte edhe një pyetje për rr. "Kongresi i Manastirit" e cila është në gjendje të keqe dhe e kemi të qartë këtë mirëpo jeni në dijeni se në vitin e kaluar e kemi bërë një rrjet të ri të kanalizimit dhe nga ajo ka ardh deri te dëmtimi i rrugës mirëpo në vitin e kaluar ka qenë një premtim që këtë rrugë do ta trajtojmë në tërësi por kjo rrugë meqë bëhet fjalë më shumë për asfaltimin e asaj rruge i takon edhe Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, por meqë kam qenë pjesë e këtij projekti për kanalizim dhe është punuar në projektin e Drejtorisë që unë e udhëheqë e që është dëmtuar, bashkërisht me drejtorin e Drejtorisë së cekur e kemi diskutuar disa herë dhe kjo rrugë do të trajtohet dhe do të rregullohet komplet rrugë e re.

Te çështja e trajtimit të qenve endacak, është problem të cilin e kemi diskutuar shumë herë, ne kemi lidhë kontrata dhe vazhdojmë të lidhim për çdo vit kontrata për trajtimin e qenve endacak, mirëpo sa i përket trajtimit dhe si trajtohen dhe si bëhet trajtimi në tërësi i tyre, e kemi diskutuar disa herë dhe nuk dëshiroj t'ju marrë kohë më shumë. Sigurisht jeni në dijeni me gjitha ato çka kemi të drejtë dhe çka nuk kemi të drejtë të bëjmë me trajtimin e qenve endacak, prandaj nuk dëshiroj t'ju marrë kohë më shumë.

Pra kjo ishte e tëra ajo që unë mora nga parafolësit dhe që u mundova të jap përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nga fjala e drejtorit parafolës, ndoshta jam shprehur ashtu, ndoshta jam kuptuar gabim mirëpo qëllimi im nuk ka qenë kur e kam potencuar kinse po më pengon buxheti në këtë masë i Komunës së Podujevës, absolut jo, përndryshe unë do të doja që buxheti i Komunës tonë të jetë edhe shumë fish më i madh dhe krejt kjo duke pasë në ndërdije që një buxhet më i madh nënkupton edhe projeksione dhe lehtësim të jetës së qytetarëve, këtë e them dhe bazohem në reagimin e drejtorit kur u shpreh duke më treguar përse është rritur buxheti, do të thotë nuk do të doja të keqkuptohem por unë e thash sakt edhe në foltore se e kuptoj se është rritur si shifër nominalisht por si vlerë dhe si fuqi e vlerës ose fuqi e realizimit të projekteve. E fillova me subvencionet në Drejtorinë e Bujqësisë Pyltitarisë dhe Zhvillimit Rural, nëse para 3 viteve sa ka kushtuar 1 lopë maksimum 1000 €, kurse sot kushton 3000 €, do të thotë në kuptimin e vlerës nominale, e fuqisë blerëse dhe e realizimit të projekteve, këtu e pata poentën, nuk do të thotë që kemi kushedi çfarë rritje dhe përse po e them këtë sepse fundja nuk ka ndryshuar formula për financimin e Komunave nga niveli qendror, formula është e njëjtë, madje madje në kohën e fundit në bazë të regjistrimit të popullsisë janë mundësitë potenciale të bie buxheti komunal e që fare nuk i gëzohem këtij fakti.

Prandaj deshta të sqarohem për këtë sepse në fakt unë do të doja që buxheti të jetë edhe trefish më i madh mirëpo ky që është sot i paraqitur as nuk ka ndryshuar formula e ndarjes buxhetore dhe fuqia blerëse e kësaj vlere nominale është e pakrahasueshme, si shifër është më e madhe por pakrahasueshëm është më e vogël. U përmend nga dikush prej kolegëve 1 metër asfalt sa ka kushtuar para 3 viteve, pastaj sa ka kushtuar një mekanizëm bujqësor, cili është çmimi i tij në treg. Kështu që edhe njëherë po e them vërtetë nuk më pengon buxheti i madh, përkundrazi i gëzohem një buxheti sa më të madh.

**Kryesuesi i Kuvendit**, deklaroi për disa që e kanë kryer diskutimin më herët që të mos e kërkojë më sepse kanë përfunduar diskutimet nga ana e tyre nga 2-3 herë, kështu që nuk mund ta shkelim Rregulloren e punës së Kuvendit.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendi përse po përton dhe po heziton të na japësh fjalën neve opozitës, ne këtë mundësi e kemi këtu të shprehemi. Në fakt na duhet të marrim fjalën sepse drejtori parafolës i DSHPMSH e potencoj se çka është horizontal dhe çka vertikal, kinse ne nuk e dim këtë dhe deri aty e sjelli punën, nëse dëshironi ne mund ta lëmë atë që e theksoi ai dhe po ecim krejt nga kjo mbledhje meqë është më i fortë ai.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ajo që e potencoj drejtori i DSHPMSH rreth kësaj çështje kishte të bënte me sqarim për ne të gjithë që mendojmë se sinjalizimi është vetëm ai vertikal.

**z.Ekrem Rrahmani**, vazhdoi, te kodi infrastrukturë publike-kolona e tretë, shkruan kështu i nderuar drejtor i DSHPMSH, sinjalizimet vertikale dhe horizontale nga rr.”Zahir Pajaziti” te rr.”Xhemajl Mustafa” si dhe nga rr.”Skënderbeu” te rr.”Zahir Pajaziti”, këto 3 projekte rr.”Zahir Pajaziti” apo Sheshi i qytetit ka kushtuar rreth 3 milion euro dhe këto tri rrugët tjera janë rreth 3 milion euro e që në total bëjnë 6 milion euro, të gjitha i keni në projekte të detajuara qysh do të jenë edhe këto shenjzimet horizontale dhe vertikale, pse bash aty ku janë kryer, nëse jeni në dijeni sipas Ligjit të prokurimit të paktën 2 vite pas kryerjes së një projekti nuk guxon të ndërhyhet në atë projekt, e jo sërish të behet e njëjta gjë dhe të shpenzohen para për të njëjtën gjë, ndoshta ju e keni shkruar gabim këtu në planifikime por këtu në dokument po shkruan ashtu, përndryshe nëse do ta shkruani ta zëm 200,000.00€ për shenjzimin nëpër rrugët e Komunës së Podujevës do të ishte ndryshe mirëpo këtu i ke shkruar dhe i ke caktuar edhe cilat rrugë e në ato rrugë njëra është duke u punuar tani, tjetra ende nuk ka përfunduar, dua të them se kompania e cila është duke e kryer punën në rrugë i ka për obligim edhe shenjzimet, ne këtë e potencuam.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e DSHPMSH por paraprakisht i them kolegut nga radhët e LVV-së çka është ky insistim që për 10 minuta ta kryejmë seancën, nuk është hera e parë që qohen në këmbë, shkarravitën duke kërkuar të përfundohet dhe të hedhet në votim, nuk janë të thirrur për këtë gjë, përndryshe më mirë do të ishte të paraqet ndonjë problematik apo të bëjnë ndonjë punë të hajrit se të vin në seancë për 10 minuta dhe ta marrin atë pagë.

I nderuar drejtor i DSHPMSH, gjatë gjithë verës kemi parë pamje të shëmtuar derdhjen e ujërave të zeza në lumin Llap, ka pasë edhe kundërmim ndërsa tani kur po shohim gjithë këto investime që po bëhen nga viti në vite për mirëmbajtjen e shtratit të lumit Llap pyes a e keni sanuar këtë dhe a keni plan konkretë për këtë problematikë dhe a ka kontratë për mirëmbajtjen e kanalizimeve ngase më janë adresuar shumë shqetësime nga qytetarët që kur po kanë probleme me kanalizim po i'u duhet të kontaktojnë kompani privatisht dhe pagesën po e bëjnë privatisht.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, unë vetëm njëherë kam diskutuar dhe atë në emër të grupit të LDK-së i nderuar Kryesues dhe ti e potencove në fillim duke na thënë që mos folni nga dy herë në fillim, leni të përgjigjen drejtorët e drejtorive dhe pastaj dosktoni sërish kurse tani po na thua folën drejtorët e Drejtorive e ju mos folni më, mirëpo nëse ata nuk përgjigjen ne duhet të ngrisim si shqetësime dhe t'jua rikujtojmë dhe të insistojmë të marrim përgjigje.

Po ndërlihem me drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili e potencoj se ish partia ime e ka rrënuar shkollën “Naim Frashëri” për interesa personale por po jua rikujtoj se ne që jem këtu asnjëherë nuk kemi qenë pjesë e Ekzekutivit e as në atë kohë, është vetë ai që ka qenë pjesë e Ekzekutivit në atë kohë dhe atyre interesave ndoshta mirëpo ato janë shkruar dhe tani janë disa interesa tjera dhe është pjesë e tyre e që nuk është keq kjo. Po ashtu mu drejtua mua duke më thënë që duhet t'i vizitoj kabinetet shkollore në fshatin ku jetoj por nuk e di me çfarë sigurie e thotë ai që unë nuk i kam vizituar, pra ku po e din ai që nuk i kam vizituar unë ato laboratorë që e potencoj se do të isht mirë

të vizitohen. Gjithashtu e potencos se edhe pse kemi humbur në fshatin Sfeçël (duke i'u referuar subjektit të tij) e kemi bërë Çerdhen, kjo logjikë është vërtetë për të ardhur keq sepse kjo qeverisje po tregon se i'u shërben interesave të votave e jo interesave të qytetarëve, nisur nga kjo, pra konkretisht e tha se për dallim nga rezultati që kemi marrë në fshatin Sfeçël e kemi bërë Çerdhen, nuk e kemi këqyr tha me rezultat të votave. E potencoj edhe që 3 ndërrime janë në shkollën “Isa Boletini” kurse ne jemi në dijani se ajo ka filluar në kohën e pandemisë ndërsa tani nuk është koha e pandemisë e që kjo zgjidhje është dashtë të bëhet më herët sepse në këtë vit sepse një shkollë të punoj me tri ndërrime dhe me klasë ku mësimi zhvillohet me nga 30 minuta nuk e besoj se është në interesin e askujt dhe duhet të zgjidhet sa më parë si çështje, madje është edhe në kundërshtim me Ligjin për arsim.

**znj.Arjeta Salihu**, theksoi, unë po kthehem sërish te pyetja ime e më hershme që kisha rreth subvencionimit të grave në biznes, i nderuar drejtor i DBF ju e potencuat që do të bëni thirrje publike, çka nëse ato nuk i përgjigjen thirrjes publike por që ka kërkesa të drejtpërdrejta në zyrat e juaja që kanë parashtruar për një ndarje ose për një përkrahje të atyre grave, pra a i keni paraparë ato këtu në këtë ndarje të buxhetit apo ato gra duhet të presin thirrjen publike, kurse nëse nuk i përgjigjen asaj thirrje të mbetet ju të bëni çka të doni. E ceka këtë sepse unë kam informatë se kanë kërkesa të drejtpërdrejta dhe veç se janë përcjellë nëpër zyrat e juaja, a duhet t'i keni parasysh ju ato kërkesa apo patjetër duhet me dal në dëgjim publik, konkretisht pyetja është a duhet t'i keni parasysh edhe kërkesat që i kanë bërë drejtpërdrejti në mënyrë të ligjshme dhe me nënshkrime.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, fjalën e ka kërkuar Kryetari i Komunës, urdhëro Kryetar.

**znj.Tringa Sfishta**, nga vendi ndërhyne duke theksuar, i nderuar Kryesuesi i Kuvendit ju lus të mos bëni sjellje të tilla të pahijshme sepse kolegja ende nuk e ka përfunduar fjalën andaj mos i'a ndal mikrofonin, ta kesh parasysh që nuk ke para vetës persona rrugaç. Në anën tjetër ti i lut anëtarët e LVV-së sa herë që dëshirojnë me marrë fjalën “si kasetë e prishur” dhe nuk jua ndal fjalën, ndërsa neve po.

Edhe njëherë po të them se nuk ke para vetës njerëz rrugaç por ke njerëz me shkollë, prandaj mos bë sjellje të tilla të pahijshme ose në të kundërtën nuk vijmë më në seancë fare. Ne po mundohemi vazhdimisht të sillemi mirë kurse ti jo me neve, nëse ti sillesh mirë atëherë edhe ne do të sillemi mirë, përndryshe nuk vijmë më në mbledhje nëse vazhdon të na ofendosh kështu.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nuk bëra kurrfarë shtjellje të pahijshme ndaj askujt, përndryshe herëve tjera kërkoje fjalën dhe unë ta jap e jo në këtë formë kështu, kushdo që e kërkoj fjalën unë i'a japa, edhe ty znj.Tringa Sfishta e kërkoje fjalën dhe diskutove çka dëshirove

**znj.Arjeta Salihu**, vazhdoi, unë nuk e përfundova fjalimin tim sepse kam edhe një çështje, në Planin e punës së Kuvendit është paraparë që në muajin shtator si pikë e rendit të ditës të jetë Informatë për Arsim, kurse drejtori i Drejtorisë së Arsimit dol dhe në pika të shkurtra me dy-tri fjali, por nuk na tregoj e që e ka për obligim dhe që nuk e keni futë si pikë të rendit të ditës, pra e ka për obligim të na informoj neve dhe qytetarët rreth fillim vitit të ri shkollorë, rreth punës dhe zhvillimit që është duke bërë në këtë fushë. Tash e përfundova.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, sigurisht që kjo seancë është një prej seancave më të rëndësishme vjetore të kësaj asambleje sepse para vetës keni projektbuxhetin e Komunës për të cilin u diskutua nga anëtarë të Kuvendit dhe u japën sqarime edhe nga ana e drejtorëve të Drejtorive përkatëse varësisht prej sferës së interesit. Mendoj se ky buxhet ashtu siç edhe u cek disa herë është buxheti më i madh gjë që është normale sepse nga viti në vit kemi pas rritje substanciale, një buxhet që për herë të parë kalon mbi 30 milion euro si total dhe një buxhet i cili për investime kapitale ka mbi 9 milion euro.



Pati shumë pyetje të cilat u shtruan nga ana juaj dhe unë nuk e kam në plan të kthehem mbrapa sepse drejtorët e Drejtorive i jepen sqarimet përkatëse, mirëpo ajo që mund të themi për këtë periudhë kohore është fakti që kemi një varg projektsh infrastrukturore që janë duke u ndërtuar anë e kënd Podujevës, projekte këto të cilat qytetarët tanë për çdo ditë i prekin dhe shohin, edhe pse ndokush mund të mos i shoh por nuk do të thotë që të gjithë shohim me të njëjtin sy.

Ne këtu absolutisht nuk kemi nevojë që të japim sugjerime njëri tjetrit për arsye se pas pak kohe do të dalim sërish para qytetarëve dhe besoj se qytetarët do të jenë ata të cilët do të vlerësojnë punën ose mos punën tonë.

Unë besoj shumë se këto projekte të cilat janë duke u realizuar nuk janë projekte të asfaltit por janë projekte të cilat kapin një gamë të gjerë të infrastrukturës po thuajse në të gjitha fushat.

E dim që është thënë se nuk do të bëhet kjo shkollë, nuk do të bëhet e kryhet ky e ai projekt mirëpo ju po i shihni se po kryhen të gjitha, është kryer ndërtimi i shkollës në fshatin Dumosh, është kryer po ashtu shkolla në fshatin Obrancë, vazhdojmë me ndërtimin e shkollës në fshatin Shajkoc, po ashtu po vazhdojmë me ndërtimin e shkollës së mesme ekonomike, 2.5 milion euro subvencion për ndërtimin e Shkollës / Qendrës së Kompetencës, mandej po vazhdojmë me ndërtimin e shkollave në fshatrat Dobërdol dhe Bradash, dhe nuk janë vetëm këto sepse për pak ditë presim nënshkrimin e Kontratës për Pishinën Gjysmë Olimpikë në shumë 4.3 milion euro, po ashtu tani më është përzgjedh operator i ekonomik për ndërtimin e Zonës Industriale që kap shumë rreth 4 milion euro. Nuk e di cili është interesi të thuhet çka kemi kryer ne me para tonat sepse ato para janë transparente, ky buxhet është transparent sepse dihen vijat dhe linjat buxhetore ku shkojnë.

Përse nuk po e përmend askush shembull që viti 2024 po përmbyllet ku vetëm Memorandume të Bashkëpunimit me nivelin Qeveritar i kemi 14.5 milion euro deri më sot, pra 14.5 milion euro janë Memorandume të nënshkruara me nivelin qendrorë-Qeverinë e Kosovës, po ashtu shtu këtu edhe donacionet që i kemi marrë në këtë vit, pra 14.5 milion euro janë më të mëdha se sa 9 milion euro që kemi për investime kapitale në buxhetin e Komunës, këto janë rezultatet dhe këtu shihen rezultatet dhe këto punë të mira.

Unë besoj që këtu mund të ketë ndonjë, në fakt nuk e besoj dhe nuk do të doja të besoj të paktën, ndoshta mund të ketë ndonjë që nuk i dëshiron këto punë të mira, por unë e di që qytetarët i kanë mirëprirë dhe janë duke i pritë mirë këto punë të mira. Jam shumë i kënaqur që sot patët mundësi të diskutoni çdonjëri prej juve si anëtar/e të Kuvendit të Komunës në mënyrë të hapur, por edhe të dilni dhe të lironi sallën sikurse që tani filluat të dilni një nga një dhe që ka mbete vetëm z.Naim Çunaku vetun nga opozita, por e them se kjo është demokracia dhe ky është Kuvendi ku duhet të thuhet të gjitha, të mirat dhe jo të mirat, dhe për atë jeni të thirrur si asambleistë, jo të ofendojmë njëri tjetrin por të flasim me fakte e faktografi gjë që nuk është problem.

Ne nuk jemi të pagabueshëm, tu filluar nga unë e rend tjerët kemi gabime, por se a ka Podujeva punë të mira dhe projekte të mira besoj se këtë sot çdo kush e pranon, pastaj a kemi prekur me investime në çdo cep të Llapit me punë dhe me projekte besoj se kjo punë tani më është e dukshme gjithandej, por si do qoftë ne për pak muaj shkojmë në zgjedhje lokale dhe unë besoj se ato zgjedhje do të na japin çdonjërit vendin meritator aty ku e meritojmë.

Unë ju falënderoj shumë gjithë anëtarëve të Kuvendit, pa dallim, për “kontributin e madh” që e japët sot në këtë seancë ku po diskutohet projektbuxheti i Komunës. Më vie shumë keq që ndoshta ata që duhet të thonë më shumë dhe që e kanë gojën plotë në mbrojtjen e interesit qytetarë, nuk than asgjë ngase ju e vërejtët që nuk patën asnjë të vetmin projekt konkret që ta kërkojnë për t’u përfshirë në këtë projektbuxhet e që kjo është e mjaftueshme për gjithë ata që neve na dëgjojnë çka jemi duke bërë, çka jemi duke punuar, kjo është e mjaftueshme, andaj nuk ka nevojë të diskutohet shumë kjo.

Ne bashkërisht si Ekzekutiv i Komunës kemi punuar shumë, por edhe me asambleistët e interesuar që kanë qenë, për muaj të tërë duke përfshirë edhe diskutimet publike buxhetore që janë organizuar në terren për ta nxjerrë këtë dokument final që e kemi për shqyrtim sot dhe nuk i'a kemi ndaluar kontributin askujt sikurse nuk i'a ndaluan as sot në këtë mbledhje sepse në çoftë se edhe sot ndonjë propozim i mirë ka qenë i mirëseardhur ngase fundja ky nuk është buxhet i një subjekti politikë por është buxhet i qytetarëve të Llapit dhe këtë buxhet të tyre po mundohemi ta ndajmë në mënyrën më të mirë të mundshme, prandaj ju falënderoj për kontributin dhe ju ftoj ta përkrahni dhe ta votoni, dhe besoj se bashkë do të votojmë dhe përkrahim shumë e shumë buxhete tjera sepse ne nuk lodhemi dhe nuk kemi kohë për të humbur por do të vazhdojmë me punë të mira dhe projekte të mira.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, para se ta hedhim në votim kërkoj ta konstatojmë kuorumin, meqë kuorum ekziston atëherë e hedhim në votim propozim vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026 – 2027, duke përfshirë propozimet për plotësim ndryshim që i paraqit drejtori i DBF-së dhe propozimin e anëtares së Kuvendit znj.Mrika Thaçi.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 21 vota Për, 6 vota Kundër, asnjë votë të Përmbajtur), miratohet propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe plotësim ndryshimeve të paraqitura nga drejtori i DBF në fjalën hyrëse, të cilat mbetet të përfshihen/plotësohen dhe ndryshohen nga DBF.*

*(Meqë një pjesë e anëtarëve/eve të Kuvendit lëshojnë sallën dhe dalin, nga pjesa tjetër e anëtarëve/eve të Kuvendit i kërkohet kryesuesit të Kuvendit që të bëjë thirrje të vazhdohet seanca sipas rendit të ditës).*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ju lutem të qëndroni në sallë sepse nuk ka përfunduar seanca sepse kemi edhe pikën Të ndryshme, kështu që do të ishte mirë ta përfundojmë edhe këtë.

**z.Ekrem Rrahmani**, i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit duke i kërkuar ta vazhdoj këtë seancë sepse je i obliguar për këtë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë jam i interesuar dhe po kërkoj që të vazhdohet me mbledhjen dhe të përfundohet kjo mbledhje, mirëpo të shikojmë a ka kuorum për të vazhduar dhe përmbyllur pasi të përfundojnë diskutimet.

**znj.Arnisa Sylejmani**, i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit që të bëjë zgjidhje rreth diskutimit edhe pikën Të ndryshme sepse nuk hera e parë dhe nuk bënë të vazhdohet kështu.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, asambleistët e LVV-së çdo herë te pika Të ndryshme po e lëshojnë sallën dhe po e pamundësojnë diskutimit në këtë pikë, janë bërë si makina votuese, të paktën të qëndrojnë në sallë dhe të kemi kuorum në mënyrë që të na mundësohet t'i parashtrijmë disa pyetje.

**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit kur po kemi vonesa për ta filluar mbledhjen ne po duhet t'i presim këta gjysmë ore, kurse tani në pikën Të ndryshme kur nuk po i'u konvenon po dalin nga salla, a hajgare është kjo a. Pra i nderuar Kryesues ashtu siç po i pret për të filluar mbledhjen ashtu edhe thirri të jenë prezent në sallë deri në përfundimin e mbledhjes.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë i'u bëra thirrje të qëndrojnë në sallë por edhe të kthehen në sallë, shefin e Grupit të LVV-së e kemi prezent këtu, vetëm ta konstatojmë kuorumin dhe

vazhdojmë. Pra për momentin kuorum kemi dhe kurdo që kemi kuorum mund të vazhdojmë me mbledhje.

## 2. Të Ndryshme

**z.Haki Rudari**, theksoi, të nderuar koleg e sidomos ju të LDK-së, unë prej fillimit të seancës dëgjova diskutimet e kolegëve nga radhët e LDK-së dhe natyrisht janë shuma e atyre diskutimeve që nuk më pëlqyen por nuk i ndërhyra askujt për arsye se është e drejtë e secilit të diskutoj dhe të jap qëndrimin e vet.

Çështja që dua të ngriti sot dhe që e kam ngritur vazhdimisht është se duhet dhe duhet të mësohemi njëherë e përgjithmonë, sepse edhe unë kur po foli këtu dikush na dëgjon, pra duhet të mësohemi njëherë e përgjithmonë ta respektojmë një Rregullore.

**znj.Donjetë Sheqiri**, duke ndërhyrë nga vendi, theksoi, lus kolegun që të mos del jashtë temës dhe nuk ka nevojë ky të na mbaj ligjëрата neve rreth sjelljeve e rregullave. Pra kërkoj të mos dilet jashtë temës por të diskutoj në temë.

**z.Haki Rudari**, vazhdoi, për besë parafolësja nuk e dinë çka është Rregullorja dhe unë nuk i ndërhyra askujt, prandaj më lejoni të përfundoj diskutimin.

Ajo çka po dua të them është se neni 41 pika 4 thotë, sqarimet plotësuese apo diskutimi për herë të dytë, prandaj kjo nuk është që t'i mbahet ndokujt ligjëratë por është lexim i Rregullores së punës së Kuvendit, pra thuhet, sqarimet plotësuese apo diskutimi për herë të dytë në kuadër të një pike të rendit të ditës, e që ne deri tani kemi pasë vetëm një pikë, lejohet vetëm pas përfundimit të krejt të paraqiturve për diskutim, e këtu z.Arjant Topanica pati të drejtë sepse e ka pasë vetëm një diskutim dhe atë në emër të Grupit, kurse të tjerët koleg të LDK-së patët disa diskutime në atë pikë, prandaj Rregullorja në fjalë duhet të respektohet dhe këtë e din edhe kolegu z.Naim Çunaku sepse bashkërisht për shumë kohë kemi qenë aktiv dhe jemi munduar shumë ta respektojmë çdo herë.

I nderuar Kryesues kërkoj të mos më ndalet migrofoni dhe të mos më ndërhyjë askush sikurse që po ndërhyjnë tani z.Valon Demolli ngase edhe unë mund të ndërhyjë kur diskutojnë ata por nuk e bëra një gjë të tillë, madje pikërisht tani është dashtë të flasim unë dhe kolegu që e ceka që jemi në cilësinë e shefave të Grupeve, prandaj edhe njëherë po e përsërisë që duhet të mësohemi, ngase edhe dalja nga salla e kolegëve të LVV-së natyrisht ndoshta është si pasqyrë dhe pasoj e këtyre sjelljeve jo të mira nga ana juaj.

Unë e kam thënë që të nderuar kolegë, për ndonjë rast kush di çka mund të jetë sepse jemi familjarë, e lajmërojmë shefin e Grupit i cili e njofton Kryesuesin e Kuvendit, dhe mund të shkon, madje e kam thënë që nuk duhet lejuar të shkoj seanca pa u përfunduar në tërësi, andaj edhe jam prezent dhe shpresoj se do të kemi kuorum dhe ta vazhdojmë seancën deri në përfundimin e saj.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë tju them të drejtën e kam shkel vet Rregulloren e punës së Kuvendit duke jua dhënë fjalën edhe nga 3 herë siç janë z.Ekrem Rrahmani, znj.Arnisa Sylejmani, znj.Arjeta Salihu sepse mbajt evidencë sa i përket kësaj çështje, mirëpo nuk po dëshirojmë të ndalemi në këtë çështje sepse për hir të demokracisë ju kam dhenë fjalën sa herë që keni dashur sepse nuk kam dashur të krijoj probleme eventuale, kjo është arsyeja.

Pra tani jemi në pikën Të ndryshme, drejtoritë e Drejtorive janë këtu prezent, kuorum ka, urdhëroni po vazhdojmë me mbledhjen kurse për çështje tjera nuk kemi çfarë të diskutojmë.

**z.Valon Demiulli**, thekoi, propozoj të shkojmë në pauzë deri në ora 15:00.

*Kryesuesi i Kuvendit, konstatoi se nga shumica e anëtarëve prezent në mbledhje mbështetet propozimi që të shkohet në pauzë deri në ora 15:00*

**Pas pauzës apo ndërprerjes së mbledhjes për shkak të mos arritjes së kuorumit, mbledhja vazhdon në ora 15:15.**

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, i cili fillimisht konstatoi se prezent për momentin janë 10 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit, dhe atë:

Nga LVV, Haki Rudari.

(Nga LDK Valon Demolli; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta.

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes nga Ekzekutivi i Komunës ishin drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Shuajb Blakçori-Drejtoria e Administratës DA; Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;).

Të pranishëm ishin përfaqësues të media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pra pas pauzës e vazhdojmë mbledhjen aty kemi mbete.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit e ke për obligim të mos i mbyllësh seancat pa përfunduar të gjitha pikat e rendit të ditës. Kjo situatë kështu është që ti e ke sjellë sepse nëse në seancën e radhës ti do të ndërmerrje veprime dhe në pikën e parë të rendit të ditës ta vendosje këtë pikë të rendit të ditës në mënyrë që të mos mbyllet kjo seancë e pastaj të fillohet me mbledhjen tjetër nuk do të iknin nga seanca këta po sa t'i përfundojnë interesat e tyre dhe të na lën kështu në këtë situatë, përndryshe ata (Grupi i LVV-së) kur po votojmë ne kundër po bëjnë foto e po bëjnë propaganda sa herë që votojnë pika të rendit të ditës për interes të tyre pastaj ikin kurse ne mbetemi këtu, prandaj i nderuar Kryesues ti duhet të marrësh disa masa, mos ju prano mëditjen atyre që vijnë nënshkruhen dhe ikin sepse ka disa që kurrë nuk vijnë në seancë ose vetëm vin nënshkruhen dhe ecin, përndryshe po e lëm edhe ne këtë punë krejt dhe po ecim, nuk e di përse kaq jo serioz kështu.

Unë pata 2-3 çështje dhe tani nuk e di a mund t'i them apo jo, nuk e di si qëndron puna.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, me propozimin e juaj pati një pauzë dhe mbledhje u shty për të vazhduar në ora 15:00, tani e filluam por kuorum nuk kemi për të vazhduar me mbledhjen sepse kemi vetëm 10 anëtarë të Kuvendit që janë prezent në sallë, meqë po dëshironi t'i lexoj kush mungon, po i lexoj, pra mungojnë: Florent Hasani, Fitim Muçolli, Artrit Mulliqi, Kasib Bashota, Sebastina Vokrri, Bahri Blakçori, Lirika Maliqi, Arnisa Sylejmnai, Donjetë Sheqiri, Ilir Koprani, Fahri Hasani, Bashkim Sylja, Endritë Murati, Mimoza Abdullahu, Mrika Thaçi, Burim Hasani, Arbnor Fazliu, Gazmend Islami, Demokrat Hodolli dhe Adnan Zymeri.

Kështu që për shkak të kuorumit unë kam dy propozime, a jeni që ta ndërprejmë mbledhjen dhe kjo pikë të kaloj në një mbledhje të ardhshme si pikë e rendit të ditës, apo të thërrasim një mbledhje të re me vetëm këtë pikë të rendit të ditës, kurdo që dëshironi nesër, pasnesër apo ndonjë ditë tjetër.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit nuk mund ta pyetesh Kuvendit se si të marrim vendim kur nuk ka kuorum, por deri sa e kemi këtë situatë mbetet ajo që e propozoj edhe kolegu z.Ekrem Rrahmani që kjo seancë nuk mund të konsiderohet e përfunduar.

Deri kur e sheh të arsyeshme të thërrasësh seancë të re pa u përfunduar kjo, mund të jetë seancë e re por kjo pikë është e papërfunduar andaj edhe duhet të fillohet me pikën e papërfunduar dhe pasi të përfundoj kjo pikë e papërfunduar, në atë seancë e konstatojmë që mbyllet seanca e kësaj date dhe pastaj fillojmë me seancën e datës tjetër, kështu do të ishte në përputhje me Ligjin dhe me Rregulloren e punës, kurse për çështje tjera “allpartizanqe” të shkoj siç të shkon, numrat, gishtat, inatet, teket, ta shikojmë ku p dalim.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pra mbledhja pritet të vazhdohet në mundësinë e parë që do të na jepet. Ju faleminderit dhe mirupafshim në mbledhjen e ardhshme.

*Meqë nuk pati kuorum për të vazhduar, Kryesuesi i Kuvendit e ndërpreu mbledhjen me konstatimin që e njëjta të vazhdoi në mundësin e parë që do të na jepet.*

**Mbledhja përfundoi në orën 15:20**

**Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;**

**Osman Bajrami**

**Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0065082/24**

**Podujevë,**

**26 shtator 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Hilmi Hoxha**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **Procesverbal nga mbledhja e XLV-të (dyzetepesë)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 04 nëntor 2024.**

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani, kurse munguan; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu; kurse mungoi Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Demokrat Hodolli; Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Shujb Blakçori-Drejtoria e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;).

Të pranishëm ishin edhe, Kovacs Karolly dhe Balazs Horuath përfaqësues të KFOR - LMT, media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

## Rendi i Ditës

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe duke iu dëshiruar punë të mbarë në këtë mbledhje, ndër të tjera theksoi, rendin e ditës dhe materialet e mbledhjes i keni marrë me kohë, po ashtu në mbledhjen e mbajtur të Komitetit për Politikë dhe Financa janë shqyrtuar edhe 3 pika tjera shtesë të cilat edhe janë rekomanduar për këtë mbledhje ashtu siç ju janë dërguar me konstatimet e asaj mbledhje, pra numri i pikave të rendit të ditës është rritë dhe tani kemi 7 pika, kështu që e hedh në votim rendin e ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 22 anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent për momentin, me 20 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të përmbajtur (të tjerët nuk votuan) miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe pikat shtesë të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF sipas materialit përkatës të dërguar me konstatimet e KPF-së.*

### Rendi i miratuar i ditës:

1. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar - shtator 2024
2. Propozim vendimi për vënie në konsultim publik të:  
- Draft Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2024 - 2029
3. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. në Podujevë
4. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A.
5. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS Sh.A.
6. Hartimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025 nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës përmes organizmit të një punëtorie të përbashkët dy ditore.
7. Të Ndryshme

## 1. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar - shtator 2024

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, kemi pikën e parë që është raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar-shtator 2024, do të thotë kjo mbledhje paraprakisht koha nuk na ka mbërritur sepse është dashtë të mbahet para fillimit të muajit nëntor mirëpo edhe vikendet kanë qenë kështu që Komiteti për Politikë dhe Financa është mbajtur në muajin e kaluar – tetor, kurse mbledhja e Kuvendit po mbahet sot më 04.11.2024, andaj për këtë pikë të rendit të ditës fjalën i’u kalojmë drejtorit të Drejtorisë për Buxhet Financa.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, lidhur me raportin financiar për nëntëmuajorin e vitit 2024 ne si Drejtori e kemi obligim ligjor që të raportojmë për çdo tremujor me raporte të tilla financiare lidhur me ecurinë e shpenzimeve të Komunës i cili është miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Për vitin 2024 buxheti i Komunës së Podujevës është në bazë të strukturës në vijim; -paga dhe mëditje 16,518,288.00€, -mallra dhe shërbime 3,585,500.00€, -shpenzime komunale 530,000.00€, -subvencione 1,670,000.00€, -shpenzime kapitale 8,756,231.00€.

Në bazë të planifikimit të cekur kemi një strukturë të shpenzimit për këtë periudhë si në vijim; -për paga dhe mëditje 14,114,000.00€, -për mallra dhe shërbime 2,037,000.00€, -për shpenzime komunal 359,815.00€, -për subvencione 871,000.00€, për investime kapitale 5,190,000.00€, do të thotë kjo është në terma të përgjithshëm ecuria e shpenzimeve të këtij nëntëmujori të buxhetit të Komunës së Podujevës.

Raportin financiar e keni marrë me kohë dhe nuk dua t'ju marrë kohë më shumë por për të gjitha diskutimet, pyetjet dhe sqarimet të cilat mund t'i keni, ne jemi të gatshëm t'ju japim sqarimet e nevojshme lidhur me shpenzimin e parasë publike për këtë periudhë.

**z.Haki Rudari**, theksoi, natyrisht se raportimi financiar është një ndër mekanizmat për monitorimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të Komunës ku ka për qëllim informimin objektiv lidhur me ecurinë dhe zhvillimet që janë bërë në Komunë, pastaj obligimet e planifikuara, investimet e ndryshme si dhe mjetet e shpenzuara sipas kategorive të ndryshme. Pra në këtë drejtim raportimi financiar vërtetë e ka një rëndësi të veçantë, në radhë të parë është një nga mekanizmat ku ne edhe e kemi si një lloje transparence, fundja ne jemi këshilltarë komunal dhe natyrisht se kemi edhe obligim ligjor që ta kemi raportin financiar dhe në të njëjtën kohë edhe ne jemi duke dhënë kontributin tonë në këtë drejtim.

Sa i përket shpenzimeve për nëntëmujorin janar-shtator 2024, kemi këtë gjendje; -paga dhe mëditje 14,114,736.00€, -mallra dhe shërbime 2,037,305.00€, -shpenzime komunale 359,815.00€, -subvencione dhe transfere 871,059.00€, dhe në fund që do të ndalem kemi -investime kapitale në shumë totale prej 5,190,120.00€. pra thjesht kjo është struktura apo progresi i shpenzimeve në Komunën tonë për periudhën janar-shtator 2024.

Sa i përket investimeve nëpër kode apo shpenzimeve nëpër kode të ndryshme ekonomike, natyrisht se nuk do t'ju lodhi shumë sepse besoj se kolegët e kanë të njëjtin raport. Është e vërtetë se në këtë raport financiar prap e kemi që po përsëritet një shumë e madhe e mjeteve që e merr kontrata kolektive përmes procedurave gjyqësore, çështje kjo e cila realisht po bartet në këtë kohë.

Në aspekte tjera këtu kemi shpenzime nëpër kode të ndryshme prandfaj po mendoj se këto shpenzime që kanë ardh janë në interes të qytetarëve ngase janë bërë shpenzime nëpër kategori të ndryshme e të cilat ndërlidhen edhe me interesin dhe standardin e qytetarëve.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, sot në këtë mbledhje po trajtojmë si pikë të rendit të ditës një pikë sikurse që e potencoj edhe parafolësi si një prej detyrave të Kuvendit të Komunës gjegjësisht anëtarëve të Kuvendit të Komunës të cilët sikurse që e kemi pasur në muajin shtator të vitit të kaluar miratimin e buxhetit, pastaj në bazë të Ligjit mbi financat është e obliguar që nga Kryetari i Komunës paraqitjen e raporteve periodike për ecurinë gjegjësisht për situatën ekonomike për menaxhimin e buxhet për këtë vit kalendarik. Pra ligjërisht janë të parapara tri raporte periodike tremujore dhe ne sot po trajtojmë raportin periodik të tretë gjegjësisht nëntëmujorin janar-shtator.

Kur kemi parasysh që udhërrëfyes i shpenzimit të buxhetit duhet të ishte buxheti të cilin e kemi miratuar në këtë Kuvend dhe në bazë të pasqyrave financiare që na i japin të shofim se ku jemi me dinamikën e realizmit të projekteve gjegjësisht me shpenzimin e buxhetit të Komunës sipas kategorive të përcaktuara me buxhetin që e kemi të miratuar.

Nga ajo që e potencoj edhe parafolësi, nuk po dëshiroj të përsëris, nga kategoritë e shpenzimeve të paraqitura në këtë raport, një vëmendje të veçantë duhet ta kemi te investimet kapitale duke ditur mirëfilltin që kemi pas të planifikuara 8,756,231.00€, ndërsa me këtë raporte financiar nëntëmujor deri më tani dinamika e realizmit të këtyre projekteve gjegjësisht shpenzimit të buxhetit është



5,190,120.00€ e që kemi një diferencë prej 3,566,111.00€ dhe po ta vështrosh në këndin e realizmit të projekteve kapitale është një shumë bajagi e mbetur edhe pse nuk e kemi përfunduar ende vitin fiskal të mos keq kuptohemi, por në këtë nëntëmujor kemi një mbetje prej 3,566,111.00€ e që parqet një shqetësim se a mund të realizohen ato projekte të cilat janë të miratuara në këtë fazë të mbetur kur dihet se po hyjmë në një fazë që edhe kushtet atmosferike e bëjnë të vetën e që mund të paraqesin një rrisht të rrezikut lidhur me shpenzimin e buxhetit ashtu siç paraparë.

Kur kemi parasysh raportimet financiare periodike, në veçanti e kemi potencuar edhe herëve tjera që mekanizëm për monitorimin për të mos thënë kontrollin e shpenzimit të buxhetit në kuvendarët jemi të thirrur në monitorim të shpenzimit të buxhetit dhe Ekzekutivi i Komunës, e potencova edhe në fillim, që si detyrë ligjore e ka të paraqes raportin.

Nga ky raport i cili është bërë standardë ose i përgjithësuar që neve na paraqitet, vërtetë na krijon dilema dhe shpeshherë krijohen paqartësi se a janë shkuar mjetet buxhetore në vendin apo projektin e caktuar, përse po e them këtë, shembull, këtu në raport kemi kode buxhetore të dhëna me një fjali që neve na bënë goxha të pakuptueshëm dhe nuk kemi pasur asnjëherë një raport më të detajuar, më të shkoqitur që fundja për çdo projekt që ka kaluar në fazën e realizmit do të duhej, që këtu disa kolegë shpeshherë e përdorin fjalën free-balance, kurse unë po e them që në bazë të raportit të Thesarit të Kosovës që për çdo pagesë ndoshta do të duhej që ne të paktën ta kemi vetë të qartë se ku janë shpenzuar ato mjete dhe për çdo projekt duhet ta kemi të paktën shumën e mjeteve që është lidh kontrata dhe me çfarë shume të mjeteve është përfunduar projekti, ngase shpeshherë gjatë realizmit të projekteve dalin punë shtesë gjegjësisht ashtu siç i trajton Zyra e prokurimit me aneks kontrata, prandaj ne duhet të dimë për secilin projekt sa ka kushtuar por që në bazë të këtij raporti ne nuk mund ta kuptojmë.

Po mundohem që në bazë të asaj si mjet krahasues sepse nuk kemi pas një plan-program pune, përjashtoj këtu buxhetin, që ta shohim dinamikën e realizmit gjegjësisht shpenzimit të buxhetit dhe nuk kemi me çka ta krahasojmë tjetër vetëm me buxhetin dhe eventualisht me raportin financiar të vitit paraprak, dhe nga ajo që shihet në këtë raport vërtetë ka dallime të theksuara nëse e krahasojmë me buxhetin e vitit të kaluar, po mundohem si shembull ti ceku dy-tre raste për të mos i përsëritur apo në të vërtetë t'i vë në spikam, shembull, kodi 13503, në vitin paraprak në këtë periudhë (edhe pse në këtë periudhë nuk kemi pasur fare raport financiar nëntëmujor në vitin e kaluar por që të paktën këtu është shkruar edhe pse ne nuk e kemi pasë e që nuk mund të harrohet sepse fundja për ata jemi të thirrur këtu si anëtar të Kuvendit për të mos harruar dhe për ta kryer punën tonë siç duhet), pra thuhet që për kompjuter i kemi të shpenzuara 188,333.20€, ndërsa në vitin e kaluar i kemi 3,480.00€, vërtetë një diferencë që don shpjegim se çka ka ndodh.

Kur e thash që nuk kemi një raport më të detajuar shembull kemi kodin 15509 ku thuhet pajisje tjera, dhe tani ato pajisje tjera tani është e kundërta e asaj që e potencova sepse në vitin e kaluar kemi pasë të shpenzuara shumën prej 128,425.14€ ndërsa në këtë vit kemi vetëm 40,913.17€ e që sërish një diferencë që kërkon shpjegim a kan pushuar nevojat apo çka është kjo me këtë dallim kaq të madh në mes dy viteve, si dhe për mua shumë e pakuptueshme kjo, pajisje tjera, pra kjo rubrika standarde e një raporti të përgjithësuar e kuptoj atë që e ka bërë raportin që kështu thuhet, por kurrfarë mangësie, përkundrazi ka qenë dashtë duke marrë parasysh që raporton para atyre që e kanë miratuar buxhetin, me një shtojcë të raportohet çka kuptojmë me pajisje tjera.

Shqetësim tjetër që prap është dallim shumë i madh është tek drutë dhe prodhimet e drurit, e që nuk e di sa është adekuate kjo “prodhimet e drurit” sepse nëse sipas këtij termi kuptohet shumë çka dhe është term i gjerë, por sigurisht ka qenë dashtë të jetë “dru për ngrohje” ose “produktet e drurit për ngrohje” apo të ngjashme sepse përndryshe po krijon huti termi “produktet e drurit” se çka

kuptojmë, dhe këtu në vitin paraprak kemi pasë 400,000.00€ ndërsa në këtë vit afërsisht 200,000.00€.

Po ashtu një diçka që nuk kam mund ta kuptoj dhe po besoj që nuk jam i vetmi që nuk kam mundur ta kuptoj është kodi 14050 mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve, dhe tani në këtë kod kemi të paraqitura që deri më tan në këtë periudhë nëntëmujore kemi të shpenzuara 60,728.00€, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishin vetëm 7,000.00€ prap edhe kjo fol për një diferencë të madhe. Gjithashtu për fund po e perëndi edhe një kod buxhetor sepse sigurisht edhe kolegët kanë për t'i thënë të gjaturat e tyre përdhe nuk po dua të marrë kohë shumë, fjala është për kodin 22200 pagesa për përfituesit individual, në vitin e kaluar kishim 89,600.00€ në këtë periudhë kohore, ndërsa në këtë vit kemi zero euro, a folët këtu për një mangësi të raportit apo për një mangësi të këtij aktiviteti që ka ndodh.

Një diçka që kemi rrugët lokale, në vitin e kaluar në këtë periudhë kohore, kur e ceka që te investimet kapitale nëse vonohemi mund të na paraqitet si rrezik për të na mbetur të pashpenzuara, pra në vitin e kaluar në këtë periudhë kohore kishim 787,749.00€ ndërsa tani kemi vetëm 160,000.00€ prap një dallim shumë shumë i madh.

Te të hyrat vetanke, duke pas parasysh se është raport nëntëmujor po presim që fjalën tonë ta themi kur t kemi raportin vjetor janar-dhjetor 2024, ato mund të rrjedhin varësisht rrethanave sepse parashikimet janë tonat kurse pagesat janë të dikujt tjetër dhe mund të ndryshoj gjendja.

Një diçka që edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e potencova ishte se neve në këtë raport na paraqiten shpenzime për sindikatë dhe në atë mbledhje e mora një sqarim nga drejtori i DBF-së që Komuna një lloj ndërmjetësuesi i pagesave të sindikatës, kur dihet se tani në Kosovë sindikatat janë organizata vullnetare dhe ato duhet të paguajnë vullnetarisht anëtarësinë e jo të paraqitet si shpenzim një shifër prej afër 20,000.00€, sepse me këtë logjikën që Komuna po i kryen shërbim sindikatave të pavarura në rend të parë e cenon pavarësinë e sindikatave kurse në rend të dytë me këtë logjikë ndoshta do të ishte mirë që edhe anëtarësinë e Bashkësisë Islame ose ndonjë tjetër, e që mendoj se na del goxha banale nëse ne fillojmë të mbledhim anëtarësia të OJQ-ve që janë organizata vullnetare kurse ne t'i paraqesim si shpenzime në këtë raport.

Po e përmbylli edhe me diçka, kam edhe shumë të gjetura tjera por duke pasë parasysh se nuk është raport përfundimtar po e kursej veten dhe në vitin e ardhshëm kur të paraqitet raporti përfundimtar vjetor do t'i shfaqim disa shqetësime që për mua janë shqetësime, tani për tani duke pasë parasysh që edhe ligji e parasheh raportimin periodik si obligim, por asgjë nëse nuk kalon raportimi periodik në një formë i'a ka humb fuqinë e atyre që e monitorojnë për masa nëse nuk shpenzohet buxheti ashtu siç është paraparë.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, sot po diskutojmë për raportin financiar të periudhës janar-shtator 2024.

Shuma totale e buxhetit të aprovuar për vitin 2024 ka qenë 31,043,019.00 € e që në periudhën e cekur janë shpenzuar 22,573,035.00€ ose 73% e buxhetit.

Te investimet kapitale për këtë periudhë nga 8,756,231.00 € janë shpenzuar 5,190,120.00€ ose 60% të buxhetit në këtë kategori. Te mallrat de shërbimet nga 3,585,000.00€ sa kanë qenë të planifikuara, janë shpenzuar 2,037,000.00€.

Te subvencionet nga 1,670,000.00€ janë shpenzuar 871,000.00€ ose 55%

Te të hyrat vetanake janë planifikuar 1,859,659.00€ ndërsa janë realizuar 1,356,459.00€ e që planifikimi te të hyrat vetanake shembull te licencat dhe lejet nga 130,000.00€ sa janë planifikuar janë inkasuar vetëm 6000.00€, pastaj te certifikatat dhe dokumentet zyrtare nga 100,000.00€ janë inkasuar 65,000.00€. Te tatimi në pronë nga 705,000.00€ të planifikuara janë realizuar 237,000.00€, ndërsa te bashkë pagesat për arsim janë planifikuar 75,000.00€ ndërsa janë inkasuar

120,000.00€. Te të hyrat tjera të ardhura nga taksa administrative nga 150,000.00€ të planifikuara janë inkasuar 23,464.00€.

Te kodet buxhetore, pagesa sipas vendimeve gjyqësore janë 2-3 shifra në të njëjtin kod, andaj dua ta pyes drejtorin e DBF sa është shuma totale e shpenzimeve në këtë kod për këtë periudhë kohore për vendime gjyqësore e që këtë çështje e ceku edhe parafolësi im, ngase nga ajo shumë kur t'i hiqet kategorisë së investimeve kapitale prej 5,190,120.00€ kjo i bie se përqindja e shpenzimit për investime kapitale është edhe më e ulët.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, edhe unë kam disa paqartësi dhe disa dilema edhe pse disa prej tyre veç u ngritën. Disa prej tyre dua t'i përmendi dhe atë nga raporti i free-balance sepse këtë raportin që na e dërgoni ju nuk gjenden më shumë se gjysma. Shembull, shpenzimet e telefonisë fikse 6500.00€, shpenzime këshillëdhënëse dhe intelektuale 79,084.00€, blerje e mobileve 112,939.00€, kurse shpenzime për mirëmbajtjen e mobileve 60,720.00€, do të thotë mobile janë blerë 112,939.00€ kurse për t'i mirëmbajtur mobiljet janë shpenzuar 60,720.00€ tani këtë vetëm drejtori i Drejtorisë së Administratës mund ta dijë se çka ka bërë me këto mjete.

Kemi për blerjen e kompjuterëve 188,333.00€, mandej shpenzim për dreka, darka dhe pije mbi 155,000.00€, ju mund të shënoni si të dëshironi por unë i kam të gjitha faturat dhe bëhet fjalë për dreka jo zyrtare, shembull ka kushtuar një darkë deri në 7670.00€, pastaj vetëm një kafe këtu afër në oborrin e Komunës që është janë mbi 700.00€ pije që i keni blerë, madje deri në 3 herë në ditë keni paguar dhe e dini që pa kontratë nuk mund të shkoni në këtë formë brenda vitit më shumë se 100 € sepse nuk keni të drejtë e jo shembull 3 herë në ditë nga 60 €, 70 €, të gjitha i kam të shënuara dhe me fatura.

Pastaj çka më bëri përshtypje dhe një tjetër që unë nuk e kam parë e që boll shumë qëndrojnë në Podujevë, nëse ndokush e din të tregoj, pagesë shembull me 9 korrik nënkallim në shumë 9200.00€ në qytet, a më tregoni ku gjendet ai nënkallim që ta shohim edhe ne, kush bëri pagesë për atë, kjo është katastrofë. Tani kemi pagesën tjetër, ngritja e infrastrukturës së turizmit 48,876,00€, nuk e di kush po bën turizëm këtu. Pastaj te subvencionet për OJQ-të, ne jemi në dijeni se edhe kur po ju jepet atyre të Podujevës ata po i zgjedhni e që duhet të jenë bio LVV, por këtyre tjerëve paratë e mëdha siç është shembull shoku i këtij drejtorit të urbanizmit, Arlind Sadiku me këtë organizatën përkatëse në Pejë merre 15,000.00€, a nuk bën t'i jepen ndonjë peroni të Podujevës atë shumë dhe të ndahet ajo shumë për t'ju shpërndarë organizatave apo klubeve sportive të Llapit e vetëm nga 1000 € do të përfitonin 15 klube dhe shoqata, e jo t'i jepen 15,000.00€ asaj organizate që është në Pejë, përndryshe i nderuar drejtor po të bëjë shok edhe unë e qitmi nga 15,000.00€, do të thotë ai person paratë i ka marrë dhe nuk dihet asgjë çfarë ka bërë këtu ai person që është arsimtar i Gjeografisë nga Peja.

Tani është tjetri Nuhi Bytyqi i cili merr 8000.00€ person i cili më afërmi është që e ka një banesë në Prishtinë dhe nuk ka lidhje me Podujevë fare, kurse klubeve tona të Llapit jua jep nga 500€ e disave hiq sepse i këqyrin me cilën parti politike janë, ndërsa prej pareve të tatimeve tona t'ju jepen peronave jashtë Podujevës kjo është tmerr.

**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi, sa i përket raportit financiar të Komunës së Podujevës për periudhën janar-shtator 2024 si çdo raport tjetër edhe ky raport sipas meje është shumë i pakuptueshëm, andaj nëse mund të kem disa sqarime prej drejtorit të drejtorisë përkatëse për disa kode buxhetore që janë të paraqitura në këtë raport, shembull kemi kodin buxhetor 11411 që është shtesë e veçantë për të zgjedhurit dhe shuma është rreth 30,000.00€ nëse mund ta di përse është kjo shumë dhe për çfarë përfaqëson ky kod, gjithashtu shtesat tranzitore te kodi 11611 që është shuma rreth 6000.00€, ndërsa kemi edhe një kod i cili është 13616 që është për furnizim me artikuj bujqësor e që nëse nuk gaboj shuma qenka 45 euro për çka po ashtu kërkoj të na sqaroni se çka

është furnizuar me këtë shumë buxhetore. Gjithashtu te 14060 që është mirëmbajtje rutinore, ku në vitin e 2023 shuma ka qenë 55,000.00€ ndërsa tani në vitin 2024 deri tani në këtë muaj raportues është 9000.00€ andaj a mund të di çka është ky dallim i shumës dhe çka është kjo mirëmbajtje rutinore.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, para veten kemi raportin financiar për periudhën janar-shtator të vitit 2024 dhe n qoftë se e analizojmë këtë raport mund të konstatojmë se paraja publike në Komunën tonë është duke u shfrytëzuar racionalisht dhe në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe këtë e themi duke u bazuar në rritjen e shpenzimeve në rregullimin e rrugëve lokale, pastaj në rritjen e shpenzimeve në fusha të sportit, investime në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit, dyfishim të shpenzimeve për ndriçim publik që do të thotë se kemi shtrirje të vazhdueshme të ndriçimit publik për qytetarët e Komunës së Podujevës, si dhe blerja e kompjuterëve që do të thotë se kemi modernizim dhe investim të Ekzekutivit në kabinete të shkollave.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se në bazë të këtij raporti Ekzekutivi i Komunës është duke e shfrytëzuar paratë publike në mënyrë racionale, në mënyrë të drejtë dhe të gjitha rritjet e shpenzimeve të cilat pasqyrohen në këtë raport janë si rezultat të punës efektive në terren dhe projekteve kapitale të cilat janë duke u bërë në Komunën tonë.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, falënderoj të gjithë për diskutimet dhe për çështjet e shtruara në lidhje me raportin financiar nëntëmujor janar-shtator 2024 të Komunës së Podujevës, dhe po bëjë përpjekje që në mënyrë të përmbledhur t'iu përgjigjem të gjitha çështjeve të cilat u shtruan e që normalisht disa çështje u përsëriten mirëpo si do që të jetë unë besoj që do të arrijmë t'iu përgjigjem të gjithëve.

Lidhur me diskutimin dhe çështjeve që u shtruan nga asambleisti z.Naim Çunaku, te çështjet e realizmit të investimeve kapitale dhe dinamikën e realizmit të investimeve ku për këtë nëntëmujorësh janë afërsisht edhe 3 milion euro të pashpenzuara dhe është e vërtetë ajo shumë e paraqitur në raport financiar sepse është shumë e sakt e vlerës së projekteve kapitale që janë shpenzuar në këtë nëntëmujor, mirëpo tani ne vetëm se kemi hyrë në muajin nëntor dhe i kemi të dhënat dhe shpenzimet dhe të muajit tetor, do të thotë një trend të shpenzimeve se qysh është duke shkuar për këtë periudhë dhe ka një dinamikë të kënaqshme të realizmit të investimeve kapitale ku vetëm gjatë muajit tetor thuajse janë shpenzuar edhe afër 1 milion euro për investime kapitale dhe shumë projekte janë fazën dhe në një dinamikë të mirë të realizimeve dhe në fazën e përmbjlljes ku në këtë vit besoj se nuk do ta kemi aspak problemin e suficitit të mjeteve buxhetore për vitin 2024 të investimeve kapitale e që ka qenë disa vite më shumë e disa vite më pak, por që ka qenë një lloj trendi i përvitshëm ku ka pas suficit të investimeve kapitale.

Lidhur me çështjen e kodit buxhetor të kompjuterëve që u shtrua se në këtë vit janë shpenzuar 183,000.00€, ndërsa në vitin e kaluar 3480.00€, çështja është që për këtë periudhë ka pasë një procedurë të prokurimit dhe është bërë furnizimi i shkollave me kompjuter ku ka vlera e paraqitur buxhetore, kurse në vitin e kaluar nuk janë furnizuar shkollat me kompjuter ndërsa në këtë vit dihet se numri i shkollave dhe nevojave të tyre janë goxha të mëdha andaj kjo është arsyeja e kësaj diferencës që është me vitin e kaluar. Pastaj te çështjes e pajisje tjera, ku ka diferencë me vitin e kaluar 128,000.00€ kurse në këtë vit 42,000.00€ unë edhe në raportet tjera financiare e kam sqaruar se kur bëjmë raportime financiare jemi të detyruar që t'i përmbahemi planit kontabël i cili është i miratuar nga Ministria e Financave dhe janë disa çështje të cilat e kanë kodin specifik në planin kontabël mirëpo janë disa çështje të cilat e kanë një kod ekonomik kështu më të përmbledhur dhe këtu ta zëm pajisje të tjera hyjnë kamerat për Komunë ose për shkollë, pastaj projektorët për shkollë e që faktikisht nuk e kanë kodin e kompjuterit dhe të tjera andaj për këtë arsye e kanë këtë diferencë sa i përket shumës së shpenzuar.

Sa i përket kodit për dru dhe produkte të drurit, nënkupton se viteve të fundit është bërë një ndryshim për shkak të peletit në mënyrë që është përgjithësuar si kod ky në planin kontabël e që nënkupton drutë dhe elementet tjera të drurit për ngrohje, në vitin e kaluar çmimi i druve ka qenë jashtëzakonisht më i shtrenjtë kurse në këtë vit çmimi i druve është më i lirë dhe për këtë arsye është diferenca mirëpo këto diferenca nganjëherë krijohen varësisht trendit të shpenzimit dhe prej kohës se prej kur vijnë faturat për ekzekutim në DBF, do të thotë varësisht prej periudhës së furnizimit sepse normalisht furnizimi me dru bëhet në atë përditshmëri por bëhet dy herë në vit maksimum dhe këtu mund të krijohen këto diferenca.

Pastaj tek mirëmbajtja e mobileve që ndoshta në çdo raport financiar po na bie të diskutojmë, është kod ekonomik, mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve, nuk ideja e ulëseve / karrigeve ose diçka e ngjashme por flitet për mirëmbajtjen e mobileve dhe pajisjeve e që ta zëm në këtë vit shpenzimet e mjeteve dhe zotimet kur i kemi bërë, në këtë kod është inkuadruar ta zëm edhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore që mund të jetë shembull për Komunën dhe për shkollat sepse nuk kemi ndonjë kod ekonomik më adekuat sesa ky, përndryshe nëse ka ndonjë kod të veçantë ma gjeni sepse unë nuk e di që është kurse ai që asambleisti z.Ekrem Rrahmani po e përmend nga vendi tani është përshkrim, ndërkaq si kod ekonomik është me këtë kod ekonomik që e ceka, mirëpo normalisht te përshkrimi duhet të shkruhet shpenzimi i mirëmbajtjes se a është për mirëmbajtje të ngrohjes qendrore apo mirëmbajtje e elektrikes.

Te pagesat për përfituesit individual, do të thotë te subvencionet, është çështje që si përfitues individual janë përfitues të cilët mund të jenë qoftë në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të cilët i marrin direkte apo subvencione në fushën e kulturës që mund të jenë klube sportive apo individ të cilët subvencionohen dhe normalisht që procedura e subvencioneve shkon në bazë të qoftë Rregullores së Qeverisë për financimin e OJQ-ve apo në bazë të Rregullores së subvencioneve e cila është miratuar në këtë Kuvend dhe në bazë të thirrjeve publike dhe vendimeve për subvencione, janë të realizuara edhe shpenzimet për subvencione.

**z.Naim Çunaku**, kërkon nga drejtori i DBF-së të sqaroj pse është zero tek kjo kategori sepse kështu ishte pyetja, jo kush janë përfituesit.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF-së, vazhdoi duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, këtu mund të jetë zero sepse varësisht nëse shikohet sepse te përfituesit individual në vitin e kaluar nëse kanë mund të shpenzohen nga grandit i përgjithshëm, në këtë vit mund të shpenzohen nga të hyrat vetanake mirëpo shpenzimet për subvencione nuk janë zero, për të mos e shpalosur raportin me shifra të sakta por që nuk, janë zero.

Sa i përket të hyrave vetanake, trendi i të hyrave vetanake mund të them se nuk është trendi më i mirë i mundshëm posaçërisht fjala është tek të hyrat e tatimit në pronë, kurse te kategorit tjera të të hyrave vetanake qëndrojmë mirë, çështje kjo e cila u shtrua edhe nga asambleisti z.Bashkim Sylja, arsyeja e kësaj tani më veç e kemi sqaruar edhe te raportet tjera financiare me theks atë të gjashtëmujorit, është se me propozim vendim dhe në bazë të Ligjit që është miratuar nga ana e Qeverisë do të thotë janë falë 100 € për detyruesit e tatimit në pronë dhe normalisht kjo ka ndikuar që në këtë vit të kemi një trend më të ulët të realizimit të të hyrave nga tatimi në pronë.

Sa i përket shpenzimeve për sindikata që u shtrua nga z.Naim Çunaku, këtë çështje e kemi sqaruar edhe në mbledhjen e KPF-së, pra kjo çështje rregullohet ligjërisht dhe pagesa bëhet në bazë të listave të pagave e cila ekzekutohet nga ana e Thesarit të Kosovës në bazë të të dhënave të cilat i marrin nga Organizatat buxhetore dhe në ato të dhëna është numri i të punësuarve pagat e të cilëve inkuadrohen në listë të pagave në bazë të procedurës ashtu siç është e rregulluar për inkuadrimin e një punonjësi në listë dhe ligjërisht jo vetëm ne si institucion publik mirëpo edhe kompanitë private po që se janë është detyrim që trusti pensional dhe tatimin e ndalë dhe e paguan biznesi dhe

në këtë rast edhe ne si Komunë e Podujevës jemi të obliguar që këto të ndalen dhe të paguhen në llogari të punonjësve mirëpo kur është fjala te tatimi ose kontributet pensionale paguhen në llogaritë përkatëse, ndërsa pagesa e sindikatës i'u merret punonjësve nga paga, pra për të gjithë ata punonjës të cilët janë vullnetarisht të deklaruar si anëtarë të sindikatave që deklarohen përmes e-kosova dhe rrjedhimisht te rubrika në listën e pagave atyre i'u ndalet shuma e anëtarësisë që e kanë në sindikatë. Pra të gjithë ata punonjës të cilët janë të punësuar në sektorin publik të arsimit ose shëndetësisë dhe që marrin paga këtë çështje e kanë të njohur se qysh figuron në listë të pagave.

Çështjet të cilat i shtroj asambleisti z.Bashkim Sylja që ishin lidhur me trendët e investimeve kapitale si dhe çështjen e të hyrave vetanake do të thotë veç se u përgjigjëm, po ashtu edhe për vendimet gjyqësore figurojnë në këtë raport financiar, mjetet financiare të cilat janë marrë qoftë nga kategoria e pagave, qoftë nga kategoria e investimeve kapitale qoftë edhe nga kategoria e mallrave që janë marrë nga vendimet gjyqësore.

Gjithashtu asambleisti z.Ekrem Rrahmani i shtroj disa çështje, shpenzimet e telefonisë fikse janë për të gjitha institucionet qoftë administrata, arsimit si dhe shëndetësia dhe normalisht se këto tarifata që i paguhen kompanisë publike (Postës dhe Valës) është i përfshirë edhe rrjeti i internetit i cili është për Komunën por edhe për institucionet arsimore dhe ato shëndetësore, pastaj çështje e shërbimeve këshillëdhënëse dhe intelektuale në shumë 76,000.00€ këtu bëhet fjalë për kontratën që është për hartimin e projekteve të Komunës së Podujevës e që pothuajse në mënyrë të vazhdueshme Komuna ka një kontratë me një operator privat për hartimin e projekteve dhe kodi ekonomik për shpenzimin e mjeteve të cilat kanë të bëjnë me hartimin e projekteve është kodi për shërbime këshillëdhënëse intelektuale, pra hartimi i projekteve është një lloj shërbimi intelektual të cilin na e jep një kompani për Komunën e Podujevës.

Po ashtu i cek edhe blerja e mobileve duke u cekur edhe shuma e mjeteve financiare e që sërish e përsërisë se bëhet fjalë për mobile ku nënkupton edhe inventari i shkollave apo institucioneve shëndetësore por edhe për institucionet komunale mirëpo këtu është më pak për arsye se dihet që nevojat janë më të vogla por po bëhet fjalë edhe për institucione arsimore, gjithashtu edhe te kodi për mirëmbajtjen e mobileve dhe pajisjeve këtu nënkupton mirëmbajtjen e rrjetit të kamerave në qytet, mirëmbajtjen e pajisjeve që janë këtu në Komunë, mirëmbajtjen e pajisjeve shëndetësore që nënkupton se janë pajisje dhe që në mënyrë të vazhdueshmë duhet të mirëmbahen sepse kanë probleme të vazhdueshme pa dyshim, andaj kodi ekonomik është mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve.

U cek edhe shpenzimi për ushqim dhe pije për të cilën u tha se janë 155,000.00€ por bëhet fjalë për dreka jo-zyrtare, pra ushqim dhe pije për furnizim të shkollave për ushqim dhe pije, pra shujtat të cilat i marrin nxënësit nga klasa e I-rë deri në të V-të.

Sa i përket pyetjes për nënkalimin në qytet që u cek, bëhet fjalë për një pagesë të taksës për të marrë një pëlqim prej Infrakosit te Stacioni i Autobusëve në mënyrë që me hartuar projektin për ndërtimin e një nënkalimi, pra për filluar me hartimin e projektit ne është dashtë marrim një leje / pëlqim nga Infrakos sepse aty është pronë e Infrakosit prandaj edhe është paguar ajo taks në shumë rreth 1300.00€.

Sa i përket çështjes së infrastrukturës së turizmit, Komuna e Podujevës ka investuar te parku në fshatin Shakovicë dhe në fshatin Kërpimëh, dhe kjo vlera në shumë 44,000.00€ ka qenë një mbetje e projektit nga viti 2023 e cila është paguar në vitin 2024 për atë projekt.

Edhe për çështjen e subvencioneve e ceka që do të thotë se për çdo pagesë e subvencionit bëhet në bazë të thirrjeve publike apo në bazë të vendimeve të veçanta që janë të rregulluara qoftë me Rregulloren për subvencionimin e OJQ-ve qoftë me Rregulloren komunale për subvencione.

Po ashtu asambleistja znj. Arnisa Sylejmani i shtroj disa çështje siç ishte ajo për shtesat tranzitore, bëhet fjalë që Ligji i ri për paga disa zyrtarëve që kanë pagë më të ulët se që kanë pasë paraprakisht dhe Ligji i pagave e ka një çështje që për tri vite nuk mund t'ia ulësh pagën që e ka pasë asnjë zyrtari pa marrë parasysh të cilën ligji e thotë dhe brenda kësaj periudhe paguhet një shtesë tranzitore për këtë diferencën midis pagës që e ka pasë para miratimit të Ligjit për paga dhe pagës të cilën i'a definon ky ligj, pra kjo është shtesa tranzitore, ndërsa çështja e furnizimit me artikuj bujqësorë bëhet fjalë për një faturë 45 euro për disa artikuj siç janë pleh artificial dhe të ngjashme që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e oborreve dhe normalisht që kodi ekonomik i tyre ashtu ka qenë artikuj bujqësor dhe ashtu është dashtë të klasifikohet kjo çështje.

Sa i përket mirëmbajtjes rutinore, ka shumë investime që janë të natyrës së mirëmbajtjes, fjala është tek disa diferenca të cilat mund të merren të çështja e mirëmbajtjes midis vitit të kaluar dhe këtij viti si dhe në disa raste është tek çështja e ndryshimit të planit kontabël, ta zëm në vitin e kaluar e kemi klasifikuar dhe kemi bërë pagesa në bazë të një kodi ekonomik, në këtë vit bëhet fjalë për të njëjtën por ka ndryshuar vetëm kodi ekonomik por që dihet se ato të gjitha janë të klasifikuara.

Besoj se arrita të përgjigjem në çështjet e shtruara, po ashtu nga asambleja është kërkuar edhe raporti i free-balance e që aty është i paraqitur çdo shpenzim i Komunës, z. Ekrem Rrahmani është i rregullt në kërkesën e këtij raporti dhe jemi shumë transparent në shpenzimet publike, madje unë ju kam thënë edhe më parë që neve çdo lëndë e cila paguhet, skanohet mund ta kërkonit dhe jua japim të gjitha. Të premtën e kaluar a shkua Auditori i cili ka audituar Komunën e Podujevës dhe ne jemi të hapur dhe transparent në të gjitha pagesat të cilat kryhen nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

**znj. Tringa Sfishta**, theksoi, ekzistojnë disa kode buxhetore rreth të cilave do të doja më shumë informacione sepse drejtori i DBF-së as që nuk i ceku në raportimin e tij apo ndoshta nuk i ka parë. Tek raporti financiar për periudhën janar-shtator 2024, shembull për shërbimet e varrezave në këtë kod nuk është paraqitur asnjë shumë andaj a mund të na sqaroni përse. Gjithashtu tek furnizimet mjekësore në krahasim me vitin e kaluar janë rreth 28,000.00€ më pak, andaj pyes fillimisht çfarë keni furnizuar me këtë kod dhe meqë shuma është më e vogël a është ulë kërkesa apo çfarë.

**znj. Arjeta Salihu**, theksoi, një pyetje na u adresua tani për tani i nderuar drejtor i DBF-së, përse që 3 muaj Zjarrfikësve nuk ju janë paguar orët shtesë.

**z. Ekrem Rrahmani**, theksoi, pa qare më duhet t'i replikoj paksa drejtorit parafolës sepse si në mënyrë të zbutur foli deri tani. I nderuar drejtor i DBF-së ti e din se unë i kam raportet e free-balance dhe nuk deshta t'i përmend emrat e kafeve dhe i di faturat që janë për furnizim me ushqim dhe pije për Çerdhe e shkolla dhe ato nuk i kam përmendur asnjëherë nëpër seanca por unë i kam përmendur drekat dhe darkat e qejfit zyrtarët që shkojnë, shembull sërish nuk dua të përmend emrin e kafes por më 03.09.2024 në një kafe në sheshin e qytetit vetëm pije 723 € do të thotë se aty duhet të jenë kallaballëk sepse aty nuk i zë, pra 723 euro e ke faturën, pastaj ke atë që e përmenda edhe më parë që është shuma 7600 € vetëm për një darkë nëpër restorante, mandej ka shembull pagesë në një kafe këtu afër brenda oborrit të Komunës ku thuhet në shumicën e faturave të saj janë pije, kafe e që një faturë e datës 04.09.2024 është 589.60 € dhe thuhet akomodim brenda vendit, kurse në atë kafe nuk ka akomodim sepse nuk e zë askënd të bëj gjumë aty, prandaj nuk deshta të hyjë me emra dhe këto gjëra mirëpo unë deshta të përmend drekat dhe darkat e qejfit që shkojnë me verëra, mish, peshk etj.

po ashtu edhe tek çështja e shërbimeve këshillëdhënëse dhe profesionale, këto janë më shumë pagesa që keni paguar auditorë, e që unë nuk po e di përse sepse është auditori brenda Komunës, pra edhe auditor edhe shërbime këshillëdhënëse sepse shërbime kontraktuese tjera ishte shuma

239,820.63 €, do të thotë këtu ka pagesa tjera dhe nuk është vetëm pagesa e vetëm projekteve ashtu siç e potencove i nderuar drejtor i DBF-së por ti deshtë ta zbutësh paksa, mirëpo kjo çështje është te puna e shërbimeve këshillëdhënëse dhe intelektuale, do të thotë njëres që nuk janë brenda këtu por janë dosta të dikujt e më shumë të Kryetarit të Komunës dhe të drejtorit z.Leutrim Krasniqit që fitojnë në tjera mënyra, mua më vije keq shembull edhe prej kolegëve asambleistëve të LVV-së dhe do të kisha qejf nga njëherë t'ju jap këto raporte që t'i shohin edhe ata që këta ngajn shumë kurse dikush tjetër i merr parat për së uluri.

Sa i përket edhe punës së subvencionimit e përmenda dhe po e përmendi edhe njëherë, përse të mos i merr ndokush nga Podujeva, nuk ka lidhje në cilën parti politike është, por t'i merr Arlind Sadiku që ka qenë në një klasë me drejtorin z.Leutrim Krasniqi, do të thotë ky person është arsimtar i gjeografisë në fshatin Leshan të Pejës, nuk jam unë kushedi çfarë nacionalisti ose lokalisti mirëpo përse paratë nga taksat tona të shkojnë në Pejë, të ndalen këndeje sepse pothuajse të gjitha Komunitat janë më të zhvilluara se ne, madje mendoj se kushdo nga Podujeva të aplikoj në Pejë, Kryetari i Komunës nga LDK është atje, nuk do t'ju jap asnjë cent, përse ne t'ju japim personave jashtë Podujevës, këtu ishte esenca.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, asambleistja znj.Tringa Sfishta pati çështjen e furnizimeve mjekësore të cilën e shtroj, po në këtë periudhë nëntëmujore janë më pak për rreth 20,000.00€ se shpenzimet e periudhës së kaluar, mirëpo me furnizime mjekësore fatmirësisht kemi buxhet të mjaftueshëm dhe furnizimi bëhet në bazë të kontratës dhe kërkesave që janë, dhe kjo diferencë mund të krijohet edhe varësisht menaxhimit të stokut që është në barnatoren e QKMF-së, përndryshe institucionet shëndetësore në bazë të kontratës e cila është aktive furnizohen me të gjitha sipas kërkesave të tyre sepse e nuk ka ndonjë problem të shfaqur me situatën financiare apo mundësit buxhetore ose diçka të ngjashme sa i përket furnizimeve mjekësore.

Shpenzimet tek shërbimet e varrimit që cekën po ashtu, pagesat që i kemi bërë përmes kodit të subvencioneve dhe është kategori e subvencioneve kjo pagesë që i bëhet Bashkësisë Islame dhe janë subvencione për entitete jo publike.

Gjithashtu asambleistja znj.Arjeta Salihu shtroj çështjen e pagesës së Zjarrfikësve, tani kemi të bëjmë edhe me një problematikë e cila po ashtu u diskutua pak më parë e që ka të bëjë me vendimet nga vendimet gjyqësore, edhe ne Komuna e Podujevës sikurse shumica e komunave tjera që ka derivuar një problem si shkak i Kontratës kolektive ku ka mbi 4 milion euro të cilat janë marrë në këtë vit në bazë të vendimeve gjyqësore për çështjen e Kontratës kolektive, si rezultat i kësaj edhe ne si Komunë sikurse shumica e Komunave kemi mungesë të mjeteve në kategorinë e pagave e që pagesa e pagave por edhe ekzekutimi i mjeteve shkon nëpërmes Ministrisë së Financave e që kjo Ministri / Thesari i Kosovës jo vetëm për Zjarrfikësit por asnjë Komunë nuk është duke i'a ekzekutuar shtesat të cilat janë si rezultat i punës shtesë të cilët e bëjnë punonjësit nëpër sektor të ndryshëm duke përfshirë këtu edhe Zjarrfikësit, pra po e them se pa marrë parasysh ne si Komunë që e kemi dërguar dokumentacionet e nevojshme që t'ju ekzekutohen shtesat nuk janë ekzekutuar për arsye se mungojnë mjetet në kategorinë e pagave, madje shumica e Komunave në këta dy muajt e fundit, mjetet për paga që do të paguhen do të jenë si shtesa me vendime të Qeverisë duke i'u shtuar mjete buxhetore në kategorinë e pagave për arsye se në qoftë se e marrim në bazë të planifikimeve dhe në bazë të trendit të shpenzimeve nuk kemi mjete të mjaftueshme Komunitat për pagesën e pagave as të rregullta është fjala, andaj për këtë arsye Ministria e Financave e ka ndal ekzekutimin e shtesave.



**znj.Arjeta Salihu**, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së, unë po e shoh një postim të Ministrit të Ministrisë së Financave z.Hekuran Murati i cili ka dal me këtë postim duke thënë se Qeveria jua paguan orët shtesë Zjarrfikësve të Kosovës.

Pra këtë e kemi si dëshmi dhe duke u bazuar në këtë postim, e parashtruam edhe si pyetje.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, vazhdoi, mund të jetë postim i mëhershëm, por janë ndal shtesat edhe pse janë obligim ligjor për tu paguar për një punonjës i cili punon jashtë orarit të rregullt të punës për arsyet të cilat i ceka, duke përfshirë edhe shtesat e Zjarrfikësve.

Çështjet të cilat i ceku asambleisti z.Ekrem Rrahmani po përgjigjem tani, sa i përket drekave dhe darkave shuma e cekur 7600.00€ është darka e fundvitit që është paguar, pastaj ka disa dreka dhe darka për disa aktivitete në fushën e kulturës që bëhen, por nuk janë dreka që shkojnë shembull zyrtarët publik, drejtorët apo dikush tjetër, mirëpo shuma 723 euro ka pas aktivitet në fushën e kulturës e që si aktivitet e ka paraparë që të shtrohet edhe një drekë për pjesëmarrësit e atij aktiviteti në atë kafe ose restorant në qendër të qytetit që u cek.

Sa i përket çështjes akomodim i brendshëm, ky është kodi ekonomik i drekave zyrtare, pra ka ndryshuar përshkrimi, planin kontabël nuk e miraton Komuna dhe ne jemi të detyruar t'i përmbahemi planit kontabël i cili miratohet nga ana e Ministrisë së Financave si dhe në free-balancë nuk ka mundësi të zotohet dhe ekzekutohet si pagesë pa i'u përmbajtur atij plani kontabël.

Gjithashtu i cek edhe pagesa e auditorëve, ne e kemi zyrën e auditimit të brendshëm mirëpo me ligj parashihet të angazhohet edhe Komiteti i Auditimit ku 2 prej tyre janë auditorë të jashtëm dhe ata auditor të jashtëm paguhen në bazë të Rregullores përkatëse për kompensim të cilën ata e kanë dhe ku thuhet se për çdo mbledhje që e mbajnë Komiteti i Auditimit paguhen 50 euro, andaj ekzekutimi bëhet në bazë të asaj, ndërsa kjo çështja e shërbimeve këshillëdhënëse dhe intelektuale e ceka edhe më parë se bëhet fjalë për hartim të projekteve dhe janë 2 konsulentë të cilët paguhen sipas kontratës së rregullt mujore e që një zyrtar punon në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si konsulent dhe një zyrtar në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe këto mjete klasifikohen në kuadër të kësaj shume të përgjithshme buxhetore mirëpo normalisht që pjesën dërmuese janë kontrata për hartimin e projekteve e cila është një kontratë e nënshkruar përmes procedurave të prokurimit.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, dëshiroj të jap një sqarim lidhur me atë që u përmend edhe emri im ndoshta me një qëllim jo të mirë, personin në fjalë i cili ka përfituar subvencion unë nuk e njoh përveç që e kemi profesionin e njëjtë, kështu që peroni në fjalë as që e kam ditur që ka një organizatë të tillë por atë e kam kuptuar këtu nga ju dhe po sugjeroj që kjo nuk është formë e mirë. Madje pas kësaj unë jam interesuar edhe për projektin e tij që ka aplikuar, por ajo çfarë është e rëndësishme si pjesë përfundimtare, pra personin në fjalë unë nuk e njoh.

Po ashtu çka është e rëndësishme prej kësaj do të thotë unë nuk kam qenë i përfshirë në asnjë vendim ose as që kam biseduar me komisionin, nëse ju mendoni ndryshe urdhëroni gjejeni vetëm një person i cili e thotë se unë kam biseduar për këtë organizatë ose për ndonjë formë tjetër atëherë jemi në rregull. Pra as edhe njëherë të vetme, përveç që ju e keni përmendur këtu.

**z.Valon Demolli**, theksoi, deshta të ndërlihem tek kjo çështja e shumës 15,000.00€ që i janë dhënë këtij profesorit nga Peja, drejtori parafolës i DPUMM po thotë që as nuk e njoh mirëpo sipas disa hulumtimeve që i kemi bërë ne aty del që qe 10 vite është shok vetëm në Facebook, andaj nuk mund të jetë krejt e rastësishme kjo. Pastaj përveç që e njeh drejtori i DPUMM atë peron e njeh edhe profa Kryetari i Komunës.

Sa i përket çështjes së furnizimit me dru nëpër shkolla që e përmendi drejtori parafolës i DBF, unë e di se asnjë shkollë ende nuk është furnizuar me dru për ngrohje, si duket diçka Kryetarit të

Komunës baxhanaku i ka dal prej dore, nuk dihet as a e ka nënshkruar kontratën apo jo, dhe për këtë e pyes drejtorin e Drejtorisë së Arsimit a është nënshkruar kontrata apo jo ngase asnjë shkollë në Komunën e Podujevës ende nuk është furnizuar me dru për ngrohje ende e që nxënësit e sidomos këta që janë në orar të hershëm të paradites po kanë probleme me ngrohjen.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, vetëm një sqarim të shkurtër lidhur me pagesën e druve që është rreth 200,000.00€, bëhet fjalë për kontratën që ka qenë në vitin e kaluar për furnizimet të cilat janë kryer për sezonin e ngrohjes nga muaji janar deri në muajin prill, ndërsa kontratë e re nuk është nënshkruar ende

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi,

**z.Avni Fetahu**, drejtor i DKA, theksoi, është interesantë që ju dikë që nuk e kam shok në formë të detyruar po ma bëni shok, e çuditshme, asgjë tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk mendoj se ka lidhje në këtë çështje se a e ka apo jo shok, problemi është tek subvencionin, andaj të mos zgjatet më shumë kjo çështje.

**z.Avni Fetahu**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, sa i përket çështjes së furnizimit me dru për ngrohje, nga një kontratë e mëhershme janë furnizuar shkollat me dru, ndërsa ne kemi nisë procedurat e prokurimit dhe është përzgjedhur një operator ekonomik për të cilën është për çudi që e vërteta është që ju si opozitë herë i bëni shok, herë i bëni baxhanaka e herë në forma të ndryshme i gjeni, por sa për njoftimin e juaj ai baxhanaku që ju e quani ashtu sepse ne nuk e dim që e ka baxhanak, i është shkëputur kontrata dhe i është marrë masa e sigurimit në vlerë 12,000.00€, kurse me pas baxhanak dhe t'ia merr 12,000.00€ goxha punë del pastaj.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, deshta krejt diçka tjetër të them dhe çka nuk pajtohem me 2 drejtorët parafolës në këtë raste me z.Leutrim Krasniqi dhe z.Avni Fetahu, kur dikush diskuton diçka me emër dhe mbiemër nuk është mirë të përgjithësohet me termin ju, ngase unë po ju drejtohem me emër z.Avni Fetahu ose z.Leutrim Krasniqi, në këtë rast kur Naimit i adresohet diçka thuaj Niaimi, mirëpo ky termi ju, është jo i këndshëm nganjëherë sepse ne nuk mendojmë njësoj të gjithë edhe pse jemi në një subjekt sepse nuk e kemi as Mao Ce-tung në krye e as kënd dhe mendojmë secili me trurin tonë, andaj kjo po më pengon dhe njëkohësisht ju lus që tjetrën herë t'i adresoheni atij që ju bënë pyetjen dhe atij thuaj ti ose filanit, e jo të gjithë ju, ose thuaj ju shefi i Grupit dhe jemi në rregull.

Tani po filloj me temën dhe i nderuar z.Avni Fetahu mos më keqkupto sepse nuk kam diçka as personale e as të atakoj asgjë, por kur u referuat në foltore dhe i shpjegove të arriturat gjegjësisht se ku janë shpenzuar mjetet buxhetore për këtë vit kalendarik, kur kemi të bëjmë me raportet mos tento që t'ia veshësh dikujt diçka çka nuk e thotë, veç se nëse je ndonjë lexues i mendjes sepse nuk ka dikush që si gëzohet të arriturave qoftë në arsim, qoftë në shëndetësi, qoftë në infrastrukturë, kurrë dhe asnjëherë pavarësisht kush e bënë unë të arriturave i gëzohem dhe ajo që nuk e kemi bërë këtë nuk kisha dashur me qenë temë e këtij Kuvendi sepse edhe njëherë edhe po e përmbylli, çdo e arritur e Kosovës në këtë rast edhe më gjerë sigurisht që më bënë të ndihem mirë.

Këtu kemi raportin periodik financiar për nëntëmujorin dhe duhet ta artikulojmë, gjegjësisht ta kanalizojmë bisedën për atë që jemi duke biseduar dhe udhërrëfyes për t'u shpenzuar paratë është projektbuxheti që e kemi miratuar për vitin 2024, janë planifikimet se ku duhet të shkojnë ato para dhe ku do të realizohen ato projekte. Nëse e kemi aprovuar këtë dhe kësaj duhet t'i përmbahet Ekzekutivi i Komunës që t'i ekzekutoj ato projekte, këtu është tema a ju ka përmbajtë ose jo Ekzekutivi këtij buxheti dhe çka ka mund të bëhet më mirë e çka më keq.

E hapët fjalimin me investimet në ujësjellës, kë e pengon ky projekt në Podujevë që është një problem i kah mortshëm që lëngon me furnizimi me ujë të pijes, askënd, unë isha ndje shumë mirë nëse qytetari që jeton në Komunën e Podujevës ose e frekuenton Komunën e Podujevës ta ketë

furnizimin me ujë për nevojat e tij, por kur bisedohet këtu, sepse ne në ligj e kemi parë dhe si temë të veçantë sa më kujtohet para rreth një viti znj.Mrika Thaçi e ka shfaq si problem furnizimin me ujë dhe i dini investimet që bëhen vazhdimisht në atë sektor, cila është gjendja e furnizimit me ujë dhe kemi një anomali këtu që është dashur të merret dikush me këtë e që në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Komuna është kompetente për furnizim me ujë për qytetarët, ndërsa po e them kushtimisht se ne që jemi këtu e kemi deleguar këtë kompetencë dikujt tjetër, një Ndërmarrje Publike dhe tani buxheti i Komunës harxhon mjete të tij në Ndërmarrjen Publike, ndërsa a jemi të kënaqur me furnizimin me ujë, jo, dikush normalisht nuk mund të thotë e kemi gjendjen e kënaqshme me ujë.

Krejt në fund, është goxha e dhimbshme kjo që ti të paguash nga buxheti yt dhe të njëjtën kohë nuk e merr shërbimin cilësor karshi pagesës që bënë, madje e kam thënë edhe njëherë po e them edhe tani është për kokë dhimbje kur sheh atje shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimeve, të më tregon dikush çfarë shërbimi i kanalizimit bëhet nga Kompania e Ujësjellësit në Komunën e Podujevës, ai i ka ndodh ndokujt të ketë ndonjë defekt në kanalizim dhe ku derdhen ato ujëra, kush i trajton, çfarë mjetesh buxhetore harxhon ajo Kompani për trajtimin e ujërave të zeza, çfarë përkujdesje ka për kanalizim, ky është shqetësim.

Tani i drejtohem drejtorit të DBF-së, kur unë e shfaq si shqetësim frikën apo rrishtun e mbetjeve buxhetore te investimet kapitale nuk thash që do mbesin po thash e kemi një risk se janë 1/3 e buxhetit të pa shpenzuara dhe e thashë atë që duke pas parasysh që nuk ka përfunduar viti buxhetor vetëm të shtohet dinamika dhe të shpenzohen këto mjete, kaq ishte, nuk ishte në formë të vërejtjes.

Te kodi i përfituesve individual drejtori i DBF i shpjegoi kategoritë e subvencioneve se nga kalojnë dhe qysh kalojnë, i dimë ato por deri sa është kod të paraqitet në buxhet, në raport buxhetor e që në vitin paraprak është një shifër goxha e madhe kurse në këtë raport e kemi zero, pra këtu ishte qëllimi, a është lëshim ky apo është ndonjë defekt sepse unë e di që ka përfitues individual sepse është e pa mundur në një fazë nëntëmujore të mos ketë asnjë përfitues, në fakt mund të cilësohet sepse e di që shkojnë prej kategorisë së subvencioneve por është parap kod i veçantë që është përfituesit individual, ju e keni shkruar jo unë, dhe është me zero euro dhe përse paraqitet kjo sepse në një formë na del raport jo i drejtë, del raportim jo i drejtë dhe jo i kuptueshëm siç edhe e përmendi znj.Arnisa Sylejmani që ky kod nuk është shumë i kuptueshëm.

Për fund, te sindikatat i nderuar drejtor i DBF-së, hiç nuk po hyj n atë qysh është e rregulluar kjo me ndonjë Memorandum Mirëkuptimi të Qeverisë apo Ministrisë dhe mund të jetë ashtu siç po thua ti, të gjithë që jemi këtu e dimë çka është taksa komunale dhe për çdo shërbim që Komuna bënë karshi shpenzimeve ose kapaciteteve që i vë në funksion në shërbim të atij shërbimi e vë një taksë dhe e kemi taksën komunale, tani këto shërbime që Komuna jonë në këtë rast sipas paraqitjes së Drejtorit po ia kryen sindikatës, a mund ta quash diçka tjetër përveç se shërbim, pra Kuvendit të Komunës së Podujevës në këtë rast i paraqitet si shpenzim, andaj nga ajo që del këtu që e sheh dhe e lexon del si shpenzim nga buxheti i Komunës, ndërsa atë që drejtori i DBF-së e lidhe me trustin pensional, trusti është diçka tjetër.

Edhe njëherë po e them, qëllimi i krejt kësaj është që të kemi një buxhet të miratuar me projeksione dhe vizion për lehtësimin e jetës së qytetarëve si në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi. Ky buxhet është miratuar në këtë Kuvend dhe raportet financiare duhet t'i kuptojmë sepse ashtu janë për të parë se sa është realizuar buxheti me planifikim dhe trashëgimet buxhetore që i kemi pas, hiç nuk më vjen mërzi gëzohem për suksesin në Komunën time.

## **2. Propozim vendimi për vënie në konsultim publik të: - Draft Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2024 - 2029**

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, Plani Lokal i Veprimit në Mjedis përmban përshkrimin dhe analizën e gjendjes ekzistuese në mjedis, identifikimin e problemeve kryesore në mjedis në Komunën e Podujevës, pra është dokument bazë i informatave, rregullave dhe kushteve për përmirësimin e gjendjes në mjedis. Qëllimi i hartimit të Planit Lokal për Veprim në Mjedis është të bëjë vlerësimin dhe analizën e gjendjes ekzistuese, identifikimin e problemeve dhe prioritetëve kryesore për periudhën e caktuar të planifikohen dhe përcaktohen afatet për këto prioritete.

Problemet kryesore mjedisore të cilat janë evidentuar aktualisht në këtë draft Plan janë, ndotja e ujërave që përfshihet nga deponimi ilegal i mbeturinave, ndotja e ajrit nga numri i madh i automjeteve, humbja e tokës nga përdorimi jo racional i tokës ndërtimore si dhe zvogëlimi i diversitetit nga dëmtimi, fragmentimi dhe humbja e habitateve. Në kuadër të këtij Plani do të përgatitet edhe harta online që të gjithë qytetarët do të kenë mundësinë e qasjes për t'i parë objektet natyrore të cilat janë të mbrojtura, debati për Planin në fjalë do të mbahet nga data 20.09.2024 deri më datë 19.12.2024, kurse debati i përgjithshëm me qytetarë mbahet më datë 03.12.2024, andaj ju ftoj të jeni pjesëmarrës me mendimet e juaja, këshillat, kritikrat dhe sugjerimet që në fund të jetë një plan sa më i përdorshëm.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, meqenëse ky draft Planit lokal për veprim në mjedis 2024-2029, del edhe në diskutim publik ne Grupi i LVV-së e përkrahim dhe të gjitha vërejtjet, sugjerimet të cilat i kemi do t'i japim gjatë diskutimit publik.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, edhe ne Grupi LDK-së në parim e mbështesim megjithëse ka shumë mangësi duke filluar nga titulli, së pari Ligji për planin lokal dhe veprim në mjedis thotë që Plani bëhet për 5 vite e jo për 6 vite dhe kështu viti 2024 thuhet se shkoj, këtë duhet ndërruar dhe të bëhet 2025-2029 sepse pastaj kthehet nga Ministria.

Ajo që mu duk shumë interesant ishte se të dhënat këtu ishin shumë të vjetra, shumë gjëra në këtë raport janë huçë, shkollën e fshatit Zhiti e ka paraqitur që është e hapur dhe ka nxënëse kurse ajo shkollë realisht nuk funksionon, kjo ishte njëra prej pikave që më ra në sy. Te skema sociale kur kam hyrë në Agjencinë e Statistikave ato çka janë në skemë sociale janë 2610 persona në Komunën e Podujevës kurse këtu të paraqitur kemi 4500 persona. Pati edhe shumë gjëra tjera të cilat gjatë dëgjimeve publike duhet të ndryshojnë, por së pari titulli duhet ndërruar si dhe te shumë projekte që i kanë bërë nuk i kanë caktuar shumat e parave për cilin projekt shkojnë e që këto janë obligative që të caktohen, besoj se e përmirësojnë këtë në mënyrë që të mos na kthehet vendimi pastaj sepse jemi bërë bozë duke na u kthyer vendimet nga Ministria, duke pas parasysh ligjin që e cekta shumë mirë që ky dokument duhet të jetë për 5 vite, e këto të dyja nuk janë.

**znj.Mimoza Abdullahu**, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së e mbështesim këtë vendim për vënie në konsultim publik.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, draft Plani Lokal për Veprim në Mjedis 2024-2029, vërtetë këto që i shfaqti kolegu z.Ekrem Rrahmani i cili e potencoi që Plani bëhet për një afat 5 vjeçar, mirëpo unë po shtoj diçka që viti 2024 është paksa i vonuar por derisa sipas kalendarit të vitit 2024 nuk mund të punojmë në vitin 2025 sepse është viti 2024 dhe 5 vjetarin po e mbërrin, a është i vonuar, po është i vonuar dhe atë me të drejtë se nuk ka projekt, nuk ka plan pa kosto financiare.

Poenta kryesore që duhet të vëhet në spikamë është kosto financiare, mirëpo duke pas parasysh që ky dokument do të vëhet në dëgjim publik dhe me të gjitha vërejtjet dhe mangësitë e këtij

dokument kështu siç është dhe si i tillë i plotëson kushtet për diskutim publik dhe e ka votën e këshilltarëve të LDK-së, për t'i dhënë dritën e gjelbër për të kaluar në diskutim publik.

**z.Haki Rudari**, theksoi, vetëm dua ta sqaroj se draft Planit lokal për veprim në mjedis 2024-2029, realisht është një dokument i një rëndësie të veçantë dhe në këtë dokument sigurisht që duhet të inkorporohen edhe Ekzekutivi. Është e vërtetë që drejtori e tha që Komuna jonë ka disa faktor që në aspektin gjeografik ka faktor që ndotin lumenjtë por edhe gurthyesit e ndryshëm andaj në një mënyrë në këtë drejtim mendoj se kjo iniciativë për mbrojtjen e mjedisit është e një rëndësie të veçantë e aq më parë kur dihet se mjedisit në të gjitha vendet e botes i kushtohet një rëndësi e madhe ngase lidhet edhe me shëndetin qoftë personal të qytetarëve, nxënësve etj.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, çështja e titullit është çështje e thjeshtë teknike sepse ne nuk kemi pas mundësi tashmë të paraqesim Planin lokal 2025-2029 përderisa ende nuk kemi hyrë në vitin 2025 sepse ka mundësi që Plani të miratohet në vitin 2024, pas përfundimit të debatit publik, kështu që ajo çka është e rëndësishme brenda kësaj është se më vie mirë që është shfletuar materiali dhe dëshira ime është që ky material të jetë në formën edhe përmbajtjen sa më të mirë. Të gjitha vërejtjet që i keni mund t'i shkruani ose t'i dërgoni përmes zyrës pritëse, unë nuk jam aspak kundër për çdo ndryshim eventual i cili është i nevojshëm që në fund të kemi një Plan lokal për një mjedis sa më të qëndrueshëm në të ardhmen.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, rreth titullit të planit e bëri sqarimin drejtori parafolës, por për financa që i ceku kolegu z.Naim Çunaku dhe unë nuk morëm përgjigje. Ligji thotë por këtu te kapitulli 7 prej faqes 83-92 thotë Plani i aktiviteteve dhe Plani i veprimit e që në asnjërin prej projekteve që janë hartuar nuk e kanë cekur asnjë vlerë të tyre dhe çfarë kosto ka, unë për këtë e ksha fjalën dhe shtrova pyetje.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, saktësisht mund të gaboje por se afërsisht vlera e këtij projekti për të cilin është lidhur kontrata është afër 5000€, që do të thotë kaq i kushton Komunës së Podujevës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor i DPUMM nuk e ke kuptuar esencën e problemit, shembull, kur unë e thash që nuk ka plan, nuk ka veprim, nuk ka kosto financiare, t'i drejtor na tregove koston e këtij Plani. Ne nuk themi sa ka kushtuar ajo zyra konsulente që e keni paguar për ta hartuar këtë Plan, nuk ishte pyetja aty, pyetja ishte për realizmin e këtij projekti a ke paraparë qoftë në Kornizën Afatmesme Buxhetore, qoftë në projekt buxhet, a ke paraparë kosto për realizmin e këtyre aktiviteteve që i ke të përmbledhura si strategji vepruese për këto 5 vite, kjo ishte pyetja.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 31.10.2024.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 28 vota Për nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për vënie në konsultim publik të Draft Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2024-2029 sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.*

*Pas kërkesave nga për një pauzë, Kryesuesi i Kuvendit e hedh në votim dhe konstaton se shumica e anëtarëve prezent e mbështetën që të shkohet në pauzë, dhe atë deri në ora 13:00, dhe njëkohësisht i ftoj që të kthehen në sallë në ora 13:00 për të vazhduar me mbledhjen.*

*Pra Kuvendi shkon në pauzë në ora 11:45 deri në ora 13:00*

**Pas pauzës mbledhja vazhdon duke filluar në ora 13:15.**

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit, dhe atë:

Nga LVV, Florent Hasani; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani,

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Të pavarur, Demokrat Hodolli; Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes nga Ekzekutivi i Komunës ishin drejtorët e Drejtorive të Komunës;

*(Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR)*

Të pranishëm ishin përfaqësuesit e lartcekur të KFOR – LMT , media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

**3. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. në Podujevë**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, më lejoni që para juve të prezantoj Propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. në Podujevë, siç jeni të informuar të gjithë bëhet fjalë për lokacionin ku është ndërtuar Stacioni i ri Autobusëve ku është një parcelë që është e cek në propozim vendim që është në sipërfaqe më të madhe, mirëpo sipërfaqja e cila i jepet në shfrytëzim NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A në Podujevë është 912399 m<sup>2</sup>, bëhet fjalë për sipërfaqen strikt, hapësirën ku është ndërtuar Stacioni i Autobusëve, andaj ju ftoj për mbështetje të këtij vendimi.

**z.Haki Rudari**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe konsiderojmë se parcela me sipërfaqe prej 912399 m<sup>2</sup>, është një parcelë e cila realisht e bën një Stacion më funksional dhe normalisht në emër të Grupit ne e përkrahim këtë propozim vendim.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, edhe ne në emër të Grupit të PDK-së e përkrahim propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A në Podujevë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, me vetë faktin që tani aty është një ndërtesë e destinuar për Stacion të Autobusëve nuk ka si të merret vendim tjetër sepse ajo është ndërtuar në atë parcelë dhe për atë parcelë sigurisht ne sot formalisht votojmë që ajo t’i kaloj Stacionit të Autobusëve.

**z.Adnan Zymeri**, theksoi, sa i përket propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Stacionit të Autobusëve në Podujevë, parimisht e përkrahi këtë propozim mirëpo konsideroj që është e rëndësishme që ky vendim dhe vendimi tjetër që vjen për dhënie në

shfrytëzim të pronës për kompaninë private KEDS të jenë vendime të cilat përcaktojnë saktë kohëzgjatjen e tyre, po them se vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Stacionit të Autobusëve është për periudhë 30 vjeçare, ndërsa vendimi tjetër i KEDS-it është për periudhën 50 vjeçare. Ne si Kuvend e marrim vendimin dhe është mirë që vendimet të jenë të unifikuara nëse vendosim për dhënien e pronave në shfrytëzim, pra t'i japim ato për një afat të caktuar për këdo që kërkon prona për interes publik në këtë rast siç është Stacioni i Autobusëve dhe Kompania për Distribuim të Energjisë Elektrike.

Krahas kësaj pike, këto pika i kanë kërkesat e paraqitura ndërsa kjo pjesa tjetër që është në rend të ditës ku kërkojnë 30,000.00€ të mbështetet me mjete financiare e njëjta Ndërmarrje Publike dhe besoj se është shumë e rëndësishme të paraqitet një kërkesë për formën dhe mënyrën qysh do të shpërndahen ato mjete.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, me vet faktin që në këtë Kuvend është votuar dhe është ndarë ajo parcelë si destinim për Stacion të Autobusëve, nuk e di më çka ka aty, do të thotë paraprakisht është vendosur që ajo parcelë të destinohet për Stacion të Autobusëve dhe kjo nënkupton se këtë parcelë duhet ta menaxhoj Ndërmarrja Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A në Podujevë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës si dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 31.10.2024.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 27 vota Për nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. në Podujevë, sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e datës 31.10.2024.*

#### **4. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A.**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, me qëllim të funksionalizimit të kësaj Ndërmarrje tani në objektin e ri dhe me arsye të rimëkëmbjes së Ndërmarrjes për funksionim më normal kemi propozuar që të ndahet një shumë 30,000.00€ subvencionim për këtë Ndërmarrje me shpresë që kjo ndërmarrje në të ardhmen do të funksionoj nga të hyrat prej shërbimeve të saj, mirëpo kjo t'i shërbej si një infuzion fillestar për funksionimin e Ndërmarrjes.

**z.Haki Rudari**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së ne e përkrahim ndarjen e shumës prej 30,000.00€ për ndihmë Ndërmarrjes së Stacionit të Autobusëve, në të njëjtën kohë mendojmë që kjo shumë pak a shumë i ndihmon kësaj Ndërmarrje për funksionalizimin dhe kryerjen e shërbimeve sa më të mira.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, kjo kërkesë u debatua edhe në mbledhjen e KPF-së që kjo Ndërmarrje të mbështetet me një vlerë 30,000.00€ ashtu siç është paraparë në propozim vendim, mirëpo diçka që duhet ta ndërtojmë dhe duhet ta kemi parasysh kur Ndërmarrjet Publike ndërtohen në rend të parë duhet ditur se ato vet menaxhohen dhe vetë financohen. Si fillim mund të jetë në rregull kjo ndarje e kësaj shume prej 30,000.00€ por nuk kemi sqarim.

Kemi aksionar që i ka propozuar ky Kuvend dhe e kam thënë edhe më parë, e them edhe tani asnjëherë nuk kemi një raport për gjendjen ekonomike dhe financiare.

Sa unë kam informacione deri vonë ajo Ndërmarrje as xhirollogari nuk ka pas dhe nuk e di qysh do t'i barten këto mjete sepse ne nuk kemi informacion a ka apo jo xhirollogari me vetë faktin që i jepen ato 30,000.00€. Tani që po njoftohem se e ka hap xhirollogarinë, sigurisht që po më gëzon fakti nëse veç është bërë sepse të gjithë jemi dëshmitarë se ata kanë pas në shfrytëzim një parking ku në emër të menaxhimit të tyre janë mbledh të hyra dhe sot e kësaj dite nuk e dimë ku kanë përfunduar ato të hyra, nuk po lëshohem në detaje por po e përmbyll këtë temë.

Si fillim Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrah ndarjen e 30,000.00€ për NPL“Stacioni i Autobusëve” në Podujevë dhe urojmë që të jetë hera e fundit që ata të kenë nevojë për mbështetje financiare nga buxheti i Komunës mirëpo si Ndërmarrje duhet që vet të bëjnë financimin e Ndërmarrjes dhe krejt çka kisha dashtë për fund rreth funksionalizimit sepse kjo në një formë po nënkupton që së shpejti ai Stacion do të funksionalizohet, a është menduar të bëhet ndryshimi i vijës së qarkullimit të autobusëve sepse për një pjesë të madhe të qytetarëve që bëjnë lëvizje me autobusë do të jetë një distancë e gjatë prej qytetit dhe a keni menduar të njëjtën kohë të bëni ndonjë zgjidhje alternative qoftë si për fillim që ata autobusë ta kenë marshutën më afër qytetit e pastaj të stacionohen atje, qoftë me ndërtimin e një vije urbane. Si do që të jetë edhe ne e mbështesim këtë cikël me këtë ndihmë fillestare për Stacionin e Autobusëve.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, ne edhe në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar këtë çështje rreth ndarjes së një shume për Stacionin e Autobusëve. Sa i përket pyetjes së z.Naim Çunaku, për shkak se jam anëtar i aksionarëve të kësaj Ndërmarrje po i jap disa informata, si fillim kemi pas problem rreth Bordit të aksionarëve për shkak të mos përmbushjes së kuotës gjinore, më vonë është plotësuar ajo, pastaj Stacioni i autobusëve xhirollogari ka. Në fillim të gjithë punëtorët janë paguar me para në dorë kurse tani të gjitha bëhen përmes llogarisë bankare kështu që ne e përkrahim këtë propozim vendim, mirëpo kjo shumë sa i plotëson këto kushte mbetet të shihet në të ardhmen.

**z.Kasib Bashota**, theksoi, veç se e sqaroi edhe kolegu por edhe unë si pjesë e aksionarëve ju njoftoj se Stacionin e Autobusëve e kemi gjet në një gjendje shumë të rëndë ekonomike ku punëtorët janë paguar veç me fatura normale dhe nuk kanë marrë pagën kurrë ashtu siç duhet, ndërsa tani nga ky muaj i marrin pagat përmes llogarisë së tyre, ju paguhet trusti dhe gjitha kontributet tjera. Gjendja ka qenë vërtetë shumë e vështirë, ka pas shumë borxhe dhe detyrime si ndaj ujësjellësit, KEDS-it dhe institucioneve tjera.

Kjo shumë financiare është shumë e vogël për rimëkëmbje plotësisht të Ndërmarrjes por besoj se me funksionimin e Stacionit të ri do të kyçen edhe vijat ndërkombëtare dhe Stacioni do të bëhet një kompani shumë më e fuqishme dhe do të menaxhohet e financohet nga vetë vetja.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i falënderoj për informatat e dhëna dy aksionarët paraprak, mirëpo vërejtja ime konsiston në këtë se kolegu e ceku që ata kanë qenë në gjendje të vështirë dhe me vetë faktin se ky Kuvend voton aksionar dhe ata aksionar do t'i kthejnë Kuvendit një informatë zyrtare, kurse tani thuhet se ka qenë gjendja e vështirë ekonomike, ka borxhe në KEDS, ujësjellës, furnizime me naftë e ku ta di unë çka tjetër, dhe krejt në fund ka qenë mirë të na njoftojnë se kur është hapë xhirollogaria dhe në një formë të japin një elaborat ekonomik se sa është e qëndrueshme gjendja financiare, por të mos harrojmë se kjo nuk është një ndërmarrje publike e cila duhet të mbjellë grurë në vjeshtë për ta korrur në korrik, por të hyrat i ka të natyrshme aty për aty dhe unë besoj se me një punë çfarë bëjnë ata së shpejti do e marrin veten sepse fundja i kanë të hyrat që brenda ditës i kanë në llogaritë e tyre dhe nuk kanë nevojë të presin ndonjë periudhë kohore deri sa t'i inkasojnë ato të hyra. Inkasimin e këto punët tjera mund ta bëjnë fshirjen e borxheve të cilat ne nuk e dimë sa janë, gjendje e vështirë po, por ajo gjendje duhet të jetë e përcaktuar me një raport ku, tek, si, dhe në fund çdo trup që ka ndërtuar ky Kuvend e ka obligim ligjor t'i raportoj këtij Kuvendi aty ku është deleguar, për gjendjen se si është.



**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, është mirë që anëtarët e Kuvendit që janë pjesë e Ndërmarrjes të na e paraqesin një raport të detajuar si ka qenë gjendja kur e kanë marrë detyrën dhe si është gjendja sot në atë Ndërmarrje, këtë informatë të përgatisin për seancën e radhës. Meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën rreth kësaj pike, e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 31.10.2024.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 26 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A, sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e datës 31.10.2024.*

## **5. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS Sh.A.**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS Sh.A, ka bërë kërkesë në DPKGJ me qëllim të dhënies në shfrytëzim të dy parcelave me sipërfaqe nga 9m<sup>2</sup>, njëra parcelë është në fshatin Shakovicë kurse parcela tjetër është në fshatin Llapashticë e Epërme, me qëllim të vendosjes së trafave për përmirësimin e furnizimit dhe stabilizimit të energjisë elektrike në ato pjesë, kështu që ne propozojmë që këto dy prona të jepen në shfrytëzim për ndërtimin e dy trafave, mirëpo në kuadër të këtij propozimi e kemi parapa që KEDS për marrjen në shfrytëzim të këtyre dy pronave të paguaj nga 1 euro për metër katror në muaj dhe pagesa do të bëhet në vit për këto prona të cilat i shfrytëzon për vendosjen e trafave.

Sa unë jam i informuar, për herë të parë është që merret një propozim vendim që jepen me pagesë këto prona në shfrytëzim, normalisht se duhet caktohet një çmim, ne jemi konsultuar me Ministrinë, edhe komunat tjera kanë filluar të aplikojnë një tarifë minimale për këto prona të cilat jepen në shfrytëzim për KEDS-in, kështu që ju ftoj ta mbështetni këtë propozim vendim.

**z.Florent Hasani**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim dhënien e pronave në shfrytëzim KEDS-it në fshatrat Shakovicë dhe Llapashticë e Epërme për ndërtimin e trafave pasi që është në dobi të atyre banorëve.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, po filloj nga një fjali e drejtorit parafolës që e potencoj, për herë të parë po japim prona në shfrytëzim me pagesë, i nderuar drejtor më duhet të demantoj sepse nuk është hera e parë, është përpjekje më shumë se disa herë kur KEDS ka kërkuar që të merr prona komunale në shfrytëzim për instalimin e pajisjeve për furnizim sa më të rregullt me energji elektrike për qytetarët tanë. Si Kuvend i Komunës kemi marrë pjesë disa herë në vendimmarrje që i kemi dhënë prona në shfrytëzim KEDS-it duke caktuar edhe tarifë, por duke pas parasysh që KEDS ka sot një monopol në tregun e Kosovës, në një formë është kundërpërgjigjur që nëse dëshironi me pas furnizimin është në rregull. Mua krejt kjo po më vie mirë, ndoshta edhe mund të qëndroj tani kjo fjalia, për herë të parë, por për herë të parë që ka pranuar KEDS të bëjë pagesë, sepse tjera herë nuk ka pranuar të bëjë pagesë për kundër vlerë të asaj parcele komunale që e ka marrë në shfrytëzim sepse fundja shumë stabilimente gjegjësisht mjete operative të KEDS janë sot edhe në prona private dhe shoqërore që nuk paguajnë asgjë dëmshpërblim, andaj po më vie mirë që ne për herë të parë po e detyrojmë KEDS-in të bëjë këtë pagesë 1 euro për metër katror dhe s'ka si

të mos jepen këto prona në shfrytëzim sepse fundja e kemi obligim të kemi furnizim sa më të mirë me energji elektrike për qytetarët tanë.

Të përgëzoj drejtor sepse kjo gjë është shumë e mirë sepse po e detyrojmë dikë nëse tenton shfrytëzoj një aset komunal, e që do të doja që kjo të jetë praktika e parë e jo e fundit që çdo kush që shfrytëzon aset komunal për ekonominë e tij të paguaj taksën komunale konform asaj pasurie të cilën e merr në menaxhim në mënyrë që Komuna të rritë të hyrat vetanake dhe në një formë ta vë në përgjegjësi atë zotërinë dhe shumë zotërinj tjerë që i shfrytëzojnë pronat komunale dhe mendojnë se janë të tyre.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, në emër të Grupit të PDK-së e përkrahim dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS Sh.A.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, një pikë e pata të paqartë, kush është në dijeni KEDS kur e ka marrë këtë distribuimin e ka marrë për 25 vite, pra në vitin 2015 është privatizuar e që i bie deri në vitin 2035, andaj kohëzgjatja e dhënies së pronës mu duk shumë e keqe, çka nëse pas këtyre viteve e merr dikush tjetër kompaninë dhe i mbetet ajo pronë atij “turkut dhe ai vjen aty e çel ndonjë dyner aty”. Pra është dashtë që në bazë të kontratës përkatëse për ato vite sa është valide edhe prona t’i jepet në shfrytëzim për ato vite. Ne e dimë se kompania nuk ka pranuar të paguaj më shumë se 1€ dhe ne duhet t’ia japim pronat në shfrytëzim dhe këtë propozim kolegët nga LVV e përkrahen, mirëpo tani unë kam qejf të diskutoj procesverbalet e mëhershme, ka anëtar të Kuvendit që ndoshta nuk janë këtu sot por fjalimet e tyre kur i kanë dhënë më herët para 4-5 vitesh për këto prona, po të shihen atëherë dhe tani është goxha ndryshim i madh, duke thënë po jep për interesa personale e të ngjashme. Ne e dimë që në 9m<sup>2</sup> ai një trafo e vendos nuk mund të vendos diçka më shumë, por kohëzgjatja në këtë pikë 30 vjet e në tjetrën 50 vjet për mendimin tim është shumë e madhe. Kohëzgjatjen e dhënies në shfrytëzim do ta leja ashtu siç e ka në kontratë KEDS, ndoshta ai e vazhdon kontratën por mund të jetë edhe tjetër kompani.

**z.Haki Rudari**, theksoi, prej vitit 2013 deri në vitin 2024 i kam procesverbalet në kopje fizike në shtëpi z.Ekrem Rrahmani dhe kurrfarë problemi nuk ka dhe çdo diskutim që kam bërë unë mbaj përgjegjësi dhe krejt ju kuptoj, por dua t’ju them diçka, është fakt ajo që u tha se është hera e parë që jepen në shfrytëzim me pagesë prona për KEDS-in, këtë desha ta them.

Shumë mirë është kjo, edhe kolegu z.Naim Çunaku e ceku që në vitet 2013-2014 ne kemi bërë propozime por arsytimi ka qenë që KEDS në një mënyre ka deklaruar që nuk merr prona në shfrytëzim me pagesë, prandaj them që më në fund është një e mirë që ka filluar dhënia në shfrytëzim e pronës për KEDS-in me pagesë dhe mendoj se ky çmim është i lirë sepse kemi një numër të madh të trafave dhe çdo inkasim natyrisht shkon në interes të qytetarëve.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, në parim edhe unë e përkrahi këtë dhënie të pronave komunale në shfrytëzim për KEDS-in, mirëpo gjithashtu e përhëndes edhe pagesën që bëhet për herë të parë për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Ne po shohim që shpeshherë projektet infrastrukturore që për shkak të pengesave të KEDS-it, po shkaktojnë kohëzgjatje deri në realizimin e tyre, andaj pyes a ka ndonjë zotim të paktën nga kjo kompani që po i shfrytëzon asetet tona të mos vë pengesa në projektet infrastrukturore.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, mendoj se është dashur që të gjitha pronat në shfrytëzim të bëhen me pagesë, edhe ato prona që i janë dhënë në shfrytëzim më herët KEDS-it.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, u diskutua lidhur me të drejtën e dhënies me qira me pagesë për Kompaninë Publike KEDS, të qenit monopol KEDS nuk ia jep asaj të drejtën që t’i shfrytëzoj asetet publike pa pagesë.

Trafot të cilat duhet të ndërtohen është e vërtetë që janë në interes publik, mirëpo KEDS e ka për detyrim publik të bëjë furnizimin me energji elektrike në kohë të rregullt dhe cilësore për komunitetin, ne kemi vendosur duke u bazuar në Ligjin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për arsye se për çështje të caktuara ti mundesh me dhënë një pronë në shfrytëzim pa thirrje publike dhe pa zhvillim të procedurave dhe kjo dhënia në shfrytëzim për infrastrukturë energjetike e plotëson kriterin që ne mund ta japim një pronë në shfrytëzim pa procedurë vetëm me vendim të asamblesë komunale, kjo është një praktikë që kanë filluar të ndjeket edhe nga disa komuna tjera që me një çmim simbolik KEDS të paguaj për asetet të cilat i shfrytëzon.

Lidhur me atë që u tha për kohëzgjatjen e shfrytëzimit, ajo është infrastrukturë që i takon interesit publik për furnizim me energji elektrike, kushdo në të ardhmen që e merr distribuimin e energjisë elektrike normalisht e merr me gjitha asete dhe për ato asete që i përdor duhet të vazhdoj pagesën e tarifave ajo kompani që vie, apo mund të ndodh që do të jetë kompani publike, në qoftë se do jetë kompani publike revidohet ky vendim dhe pastaj e merr atë pronë në shfrytëzim pa pagesë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor, pa dashje por e cekët që kompanitë që kanë monopol, në këtë rast në rregull jemi edhe pse ka monopol nuk i jep të drejtën të luaj me qytetarët, këtë askush nuk e tha që ia jep të drejtën, por kur dikush ka monopol edhe unë e thash se jemi dëshmitar këtu disa nga përvoja e kaluar që kur ne i kemi thënë nuk mund të marrësh pronë komunale pa pagesë sepse ti po përfiton gjegjësisht po ngritë interes nga shfrytëzimi i pronës komunale, ajo kompani ka thënë nëse ju nuk jeni të interesuar as ne nuk jemi të interesuar për investime, andaj në një formë na ka detyruar të tërhiqemi nga pjesa e pagesës dhe kanë marrë prona në shfrytëzim, fare ligjërisht, fare ndershëm por kur është monopoli e ka atë mundësi të diktoj kushte, pra kjo është ajo fuqia e monopolit.

Të mos dalim tani jashtë temës sepse vetëm tek ne ndodh kjo që në prona private kemi shtylla të KEDS, a i paguan dikush dikujt diçka, jo, a është pengesë për ata zotërinj që është në pronë private, po. Kur e ka monopolin dhe e ka bërë kështu qysh e ka bërë, unë thash uroj që për herë të parë KEDS ka pranuar të bëjë pagesë dhe duhet ta dimë se në ekonominë e tregut, qoftë me monopol ose jo, nuk mund të shfrytëzosh send të huaj pa pagesë, pa çmimin e kundërvlerës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka ta lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 31.10.2024.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 25 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS Sh.A, sipas materialit përkatës të dërguar me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 31.10.2024.*

## **6. Hartimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitit 2025 nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës përmes organizmit të një punëtorie të përbashkët dy ditore.**

**znj. Sebastina Vokrri**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim organizimin e një punëtorie të përbashkët dy ditore për hartimi e Planit të Punës së Kuvendit për vitit 2025.

**z. Valon Demolli**, theksoi, do ishte mirë ta dimë ditën dhe vendin e organizmit të punëtorisë, pra në cilin vend dhe cilën datë.

**z. Bashkim Sylja**, theksoi, propozimi i një punëtorie të përbashkët dy ditore për hartimi e Planit të Punës së Kuvendit për vitit 2025 ka qenë me qëllim që të bëhet dakordimi i gjithë këshilltarëve të Kuvendit të Komunës për realizimin e kësaj punëtorie.

Propozimi është bërë në konsultim edhe me përfaqësuesin e LVV-së dhe të LDK-së, ndërsa data dhe vendi i organizmit ka mbete të caktohet në konsultim mes shefave të Grupeve përfshirë edhe Kryesuesin e Kuvendit për çka do të njoftoheni me kohë të gjithë.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, nisur nga fakti që e kemi obligim ligjor si Kuvend të ketë Plan pune, e që në vërtetë nuk i përmbahemi kurrë, por të paktën ligji e përcakton që të kemi Plan të punës, praktika që kemi ndjekur deri më tani me komisione nuk ka dal shumë frytdhënëse në kuptimin e hartimit të një Plani të punës të Kuvendit ashtu siç do të duhej të jetë, dhe në këtë vazhdë duke menduar meqë e kemi obligim ligjor si dhe t'i jepet mundësia çdo njërit se qysh e sheh Kuvendin dhe punën e Kuvendit për vitin 2025.

Duke pas parasysh që në kodin buxhetor përkatës ka kategori për organizimin e një punëtorie edhe ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës, ndërsa për detajet tjera në harmonizim me gjithë pjesëmarrjen e Grupeve politike në një kohë sa më të shkurtër ngase në dhjetor ne duhet ta kemi Planin përkatës për miratim dhe në dhjetor është mirë të miratohet Plan i punës së Kuvendit për vitin e ardhshëm.

**z. Ragip Fetahu**, theksoi, është shumë pozitive kjo ide që Plani i punës të bëhet nga gjithë ne pa dallim nga subjektet politike për faktin se jemi dëshmitar që në të kaluarën në vazhdimësi është kritikuar Plani i punës së Kuvendit dhe sidomos komisioni që e ka hartuar atë Plan edhe pse ai komision ka qenë i përberë nga të gjitha subjektet politike, andaj tani e kemi mundësinë që të gjithë ne të jemi pjesë e hartimit të Plani dhe ta zbatojmë deri në fund.

**znj. Edona Shabani**, theksoi, po i nderuari koleg z. Ragip Fetahu jemi dëshmitar të gjithë dhe kjo është e vërtetë, por kemi qenë dëshmitarë kur e kemi pas një Plan të punës që fondet janë marrë tjetër kund, andaj tani dua të di që fondet për këtë punëtori a janë nga kodi i Kuvendit apo do i merrni nga një tjetër kategori ashtu siç na ka ndodh më parë.

**z. Haki Rudari**, theksoi, është e vërtetë që para mbledhjes së KPF-së shefi i Grupit të këshilltarëve të PDK-së është konsultuar me ne dhe ne në parim e kemi përkrahur iniciativën e tij dhe në të njëjtën kohë këtë e pohoi edhe kolegja në emër të Grupit të LVV-së, mirëpo dua të them që respektimi i Planit të punës megjithatë duhet të bëhet nga të gjithë, këtë po e ri-përsërisë për arsye se është një dokument zyrtar që votohet në Kuvend por në të njëjtën kohë në hartimin e Planit të punës përveç këshilltarëve të Kuvendit, me rregullore parashihet që pjesëmarrës të jetë edhe Ekzekutivi, prandaj nuk mund të themi që nuk mund të vije edhe ndokush nga Ekzekutivi i Komunës për hartimin e Planit të punës, asgjë të keqe nuk ka këtu, vetëm mund të marrim propozime për hartimin e Planit të punës, këtë e thash edhe më herët se rregullorja e mundëson që të jenë pjesë e vizitës disa anëtarë nga radhët e Ekzekutivit.

**z. Bashkim Sylja**, theksoi, si praktikë e së kaluarës zakonisht ka marrë pjesë vetëm Kuvendi, kështu që drejtorët e Drejtorive mund të paraqesin vetëm ndonjë kërkesë, përndryshe Planin e punës së Kuvendit e bëjnë vetëm anëtarët e Kuvendit ashtu siç ka qenë praktikë edhe në të kaluarën.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, sa i përket rregullativës se kush e bënë Planin e punës së Kuvendit, është e vërtetë e madhe që në tri Planet e kaluara kështu është thënë nga Ekzekutivi i Komunës, por Planet e punës së Kuvendit janë të Kuvendit e jo të Ekzekutivit, dhe nëse dikush është lidhë me ato afatet ligjore ku, qysh dhe cila pikë të jetë në Plan të punës.

Nuk jemi në vitin e parë të ushtrimit të mandatit të këshilltarit dhe tani sigurisht secili prej nesh e din kur është KAB, Raporti financiar dhe kur duhet harmonizuar në kuptimin ligjor, e që nuk kanë marrë mundin për t'i shfletuar vetë obligimet e veta por i kanë marrë të gatshme prej Ekzekutivit.

Asgjë nuk kam kundër nëse ka gatishmëri ose ka mundësi edhe pjesa e Ekzekutivit të jenë me ne, s'kam asgjë kundër, por Planin e punës së Kuvendit e harton Kuvendi.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se për këtë pikë nuk kemi çfarë e zgjasim më shumë, pra sipas iniciativës që është marrë në mbledhjen e KPF-së, është një rekomandim që i është bërë Kuvendit dhe këtu vendoset a do ta organizojmë këtë punëtori në kohëzgjatje dy ditë gjatë muajit nëntor për hartimin e Planit të punës së Kuvendit, prandaj e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas rekomandimit nga KPF dhe diskutimeve në këtë mbledhje.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 24 vota Për, nga anëtarët/et që ishin prezent në sallë, si përfundim vendoset për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025 nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës përmes organizmit të një punëtorie të përbashkët dy ditore në muajin nëntor, ndërsa sa i përket vendit, datës dhe çështjeve tjera organizative dhe procedurale mbetet të vendoset pas konsultimeve të Kryesuesit të Kuvendit me shefat / përfaqësuesit e Grupeve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe sipas nevojës edhe ndonjë prej anëtarëve të Ekzekutivit, për çka do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit.*

## 7. Të Ndryshme

**z.Florent Hasani**, theksoi, kam një pyetje prej fshatit Gërdofc për rr."Hysni Gërdofci" në gjatësi 1150 metra e cila ka hyrë në projekt këtë vit për tu asfaltuar në gjatësi 430 metra kurse janë duke u asfaltuar vetëm 233 metra, andaj banorët kërkojnë arsyen pse është shkëputur një pjesë prej projekti. Po ashtu nga i njëjti fshat kemi pyetje edhe për DKRS-në, përse nuk është duke u vazhduar përfundimi i plotë i projektit të fushës sportive në oborrin e shkollës.

Po ashtu në fshatin Llaushë, te varrezat e lagjes "Visoka" është projektuar shtruarja e rrugës me zhavorr që tri vite dhe ende nuk ka përfunduar, gjatësia e kësaj rruge është rreth 260 metra andaj banorët kanë pyetje përse nuk po vazhdojnë punimet për përfundimin e këtij projekti.

**znj.Arnisa Sylejmnai**, theksoi, duke pas parasysh se disa seanca pika Të Ndryshme nuk është mbajtur dhe na janë bërë shumë pyetje pa u adresuar, por po e shohim interesimin e Ekzekutivit që prej 11 drejtorëve të Drejtorive vetëm 2 prej tyre janë prezent, si dhe nga fakti që ne përgjigjet nuk i marrim as përmes e-mailit e as në mënyra tjera zyrtare, nuk e di se çfarë efekti ka që ne vetëm t'i adresojmë këto pyetje.

Është hera e dhjetë që ne e adresojmë problemin e ndriçimit publik, është nevojë urgjente me u marrë me këtë çështje, a marrim përgjigje prej Ekzekutivit, jo nuk marrim, pastaj a ka ndonjë përmirësim, jo nuk ka përmirësim, kështu që nuk ka efekt kjo punë. Është pika më e rëndësishme që ne duhet ta diskutojmë dhe që Ekzekutivi duhet të jap përgjigje për ne dhe qytetarët, por që këtu nuk është prezent.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, besoj se Ekzekutivi do t'ju përgjigjet edhe përmes e-mailit.

**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, të pranishëm qenkan vetëm 2 drejtor të drejtorive por fatkeqësisht apo fatmirësisht unë nuk e kam për asnjërin që janë të pranishëm tani. Pyetjen e zakonshme dhe të përmuajshme e kam për drejtorin z.Bahri Selimi edhe pse nuk është këtu besoj se do të na shikon apo do të përgjigjet disi, pra gjendje alarmante është ndriçimi publik në rr."Fitorja" e cila është më shumë se dy muaj pa ndriçim publik dhe asnjë dritë e vetme nuk është funksionale.

Para një ose dy muajve kam bërë pyetje të vazhdueshme ku së bashku me kolegen znj.Arnisa Sylejmani kemi bërë pyetje për problemin e njëjtë dhe drejtori i cekur na ka thënë që ky është problem teknik i cili do të sanohet dhe rregullohet brenda ditës ose brenda javës, gjë që ka mbet vetëm fjalë sepse nuk është marr asnjë hap për rregullimin e këtij problemi.

Pyetje që e kam pas prej fillimit të seancës dhe që në seancat e ardhme do të jetë kjo për drejtorin e cekur të Drejtorisë përkatëse se kur do të sanohet problemi apo kur do të merret parasysh kërkesa dhe pyetja jonë, apo do të vazhdohet të hasë në vesh të shurdhër sikurse tash e sa kohë.

**znj.Arjeta Salihu**, theksoi, nisur nga nevojat dhe kërkesat e OJQ-së Handikos në Podujevë, kërkoj ndarjen e mjeteve shtesë buxhetore për këtë organizatë si fazë emergjente për të mundësuar ofrimin e shërbimeve për trajtim nga logopedi dhe psikologu e që përmes këtyre ofrimeve ose këtyre shërbimeve Handikos do të ndihmonte anëtarët e saj, familjarët e tjerë, andaj edhe është shumë e nevojshme kjo mbështetje nga ana e DSHMS-së, sepse është një çështje që na preokupon të gjithëve dhe na duhet një bashkëpunim.

Po ashtu dua të potencoj edhe një shqetësim tjetër që vie nga banorët e objekteve banesore kolektive në lidhje me higjienën në pjesën e korridoreve dhe shkallëve të cilat ata prej vitesh i mirëmbajnë vetëm me vullnetin e tyre, andaj kërkoj nga Komuna - Drejtoria përkatëse që të marrin masa për funksionalizimin e Ndërmarrjes Banesore si hap i parë i cili do ta mundësonte ofrimin e shërbimeve në këto objekte kolektive të banimit.

Gjithashtu kam edhe një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Asimit, përse janë ndaluar punimet e Çerdhes tek pishat.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, jemi dëshmitarë të disa fenomeneve negative që janë duke ndodh në Komunën tonë tek të rinjtë dhe adoleshentët dhe ne si institucion jemi të obliguar që të ndërmarrim hapa apo ndonjë iniciativë për parandalimin e tyre. Dhuna në shkolla, bullizmi, droga, alkooli dhe prostitucioni janë disa fenomene ku të rinjtë bien shumë lehtë pre e tyre dhe nuk kanë informacionin e duhur për këto çështje, prandaj mendoj që në seancën e ardhshme si rend të ditës të kemi pikën për parandalimin e efekteve negative tek të rinjtë Llapjan dhe ne si institucion në bashkëpunim me DKA-në, akterët tjerë dhe organizatat tjera të hartojmë së bashku një plan dhe të ndërmarrim një fushatë vetëdijesuese në të gjitha shkollat e Komunës tonë për parandalimin e këtyre fenomeneve.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, edhe unë kam disa pyetje por drejtoresha e DKRS-së nuk është duke ardh në mbledhje, disa fusha sportive kanë mbet të pa përfunduara kurse pagesat po bëhen.

Në fushën e sportit në fshatin Siboc njëherë është shtruar bari, pastaj e ka vërshuar uji e mandej e kanë bërë një themel përreth dhe ende nuk është ndërmarr asnjë veprim tjetër as për ta pastruar atë fushë e cila ka mbetur në atë gjendje.

Një problem tjetër e kemi me bartjen e nxënësve sepse më parë ka qenë një linjë për bartjen e tyre për në shkollë dhe e dimë që ata vetë e kanë bërë pagesën sepse gjatësia deri te shkolla është më shumë se 2 km dhe ai transportues e ka ndalë atë vijë të transportit e që nxënësit tani po shkojnë këmbë në shkollë dhe tani koha sa vie bëhet më ftohët e më ftohët dhe do të doja ta dijë a ka mundësi të ndërrohet ajo vijë e transportit ose t'i jepet ndokujt tjetër në mënyrë që të mundësohet bartja e atyre nxënësve të paktën tri herë në ditë.

**z.Burim Hasani**, theksoi, e kam një pyetje për drejtoreshën e DBPZHR-së të cilën edhe më parë e kam parashtruar por përgjigja mund ndodh që është vonuar nga Ministria e Bujqësisë, fjala është për disa kërkesa në lidhje me kompensimin e dëmeve në bujqësi të cilat janë shkaktuar gjatë vitit 2023, shumica e fermerëve kanë bërë kërkesa në lidhje me kompensim të pagesave sepse një pjesë e rasteve janë kryer kurse shumica ose 80% e listës nuk janë kompensuar ende edhe pse Ministria e Bujqësisë ka bërë kërkesë në Komunë që ta formoj një komision për vlerësimin e dëmeve.

Vlerësimi i dëmeve është bërë, lista e dëmtimeve ka shkuar në Ministrinë e Bujqësisë kurse sa i përket kompensimit të dëmeve ende nuk është bërë kompensimi i tyre, jemi thuajse në pjesën e fundit të qeverisjes dhe është mirë që kjo kërkesë për herë të fundit t'i adresohet Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe përgjigja mundësisht të kthehet në mënyrë zyrtare me e-mail, në mënyrë që ta dinë bujqit a do të kompensohen apo jo.

**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, kam pyetje për drejtoreshën e DSHMS-së e cila nuk është e pranishme këtu por të mbetet si pyetje, siç e dimë muajin e kaluar kemi qenë në muajin që e quajmë “tetori rozë” që njihet si muaji për ndërgjegjësimin kundër kancerit të gjirit, pyetja është për drejtoreshën e DSHMS-së a është mbajtur ndonjë takim sensibilizues në fshatra për gratë që dëshirojnë të dinë më shumë për kancerin e gjirit dhe mamografinë, si dhe a është mbajtur ndonjë takim në shkollë.

**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi, nuk besoj se do të kem përgjigje prej drejtorëve të pranishëm, mirëpo shpresoj se do të marrin përgjigje nga ne dhe qytetarët e Podujevës sepse kjo çështje që po e ngris është preokupim për të gjithë që është gjendja e qytetit prej qeneve endacak dhe vet faktin që jemi afër sezonit dimëror dhe tani po errësohet më herët dhe nxënësit tani po lëshohen nga mësimi më herët thuajse në terr, gjendja ka dalë paksa jashtë kontrollit.

Gjithashtu një pyetje kam për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit-DKA, pasi që deklaruar se gjitha shkollat janë të pajisura me kabinete, i nderuar drejtor a ke informacione se sa po shfrytëzohen këto kabinete prej mësimdhënësve.

**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, i nderuar Kryesues, në seancat e ardhshme vazhdoje këtë ritëm sepse sot ke qenë fantastik.

**znj.Edona Shabani**, theksoi, një pyetje kam për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit-DKA, a jeni duke bashkëpunuar me drejtoreshën e DSHMS-së për të mirën e fëmijëve me nevoja të veçanta sepse ata fëmijë kanë nevojë shumë për përkujdesje shëndetësor, çështje këtë të cilën e kam thënë edhe më parë se ata kanë nevojë për ndihmë nga ana e dy drejtorëve që i ceka.

**z.Valon Demolli**, theksoi, unë pata një pyetje për drejtorin e inspeksionit por si duket nuk qenka këtu, andaj meqë nuk është prezent nuk po e parashtroi fare.

**znj.Lirie Hoti**, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, e falënderoj kolegun z.Burim Hasani për pyetjen që e ngriti, çështje kjo për të cilën veç e kemi diskutuar edhe në seancat e kaluara, mirëpo lidhur me çështjen e ngritur në kuadër të Komunës së Podujevës siç e dimë të gjithë është ngritur një komision nga ana e Kryetarit të Komunës i cili bënë vlerësim e dëmeve të cilat shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore ku pjesë e tyre janë edhe dëmet e shkaktuara në sektorin e bujqësisë.

Lidhur me dëmet e shkaktuara në vitin 2023, siç jemi të informuar ende nuk është bërë kompensimi mirëpo të gjitha lëndët të kompletuara janë dërguar në Ministrinë përkatëse dhe asnjë lëndë për fat të mirë nuk është kthyer mbrapsht në Komunën e Podujevës, ndërsa se ku ka ngecur pastaj procesi do t'ju informoj përmes e-mailit komisioni adekuat lidhur me vlerësimin e çështjeve të tilla dhe atë konsideroj brenda javës.

Lidhur me pyetjen e cila u parashtrua për drejtoreshën e DSHMS-së, në emër të saj po ju njoftoj se është në takim me organizatën Chatar Charity, kurse pyetjen do ia përcjell dhe sigurisht do ju përgjigjet përmes e-mailit.

**z.Avni Fetahu**, drejtor i DKA, theksoi, pati një pyetje nga asamblistja znj.Arjeta Salihu e cila e potencoj pse janë ndalur punimet në Çerdhen tek pishat, jeni në dijeni se ky është projekt i Ministrisë së Arsimit dhe është 100% i financuar nga Ministria ndërsa punimet nuk janë ndalur por ka përfunduar faza e dytë, Ministria e ka kriter që projektet kapitale i ndajnë në tri faza andaj jam njoftuar se janë në fazë të prokurimit për fazën e tretë. Pastaj i njëjti operator ekonomik është edhe për sallën e sporteve që është duke u punuar në shkollën “Naim Frashëri” i cili po ashtu e ka edhe objektin e Çerdhes te pishat. Afati i fundit për tu realizuar sipas Planit të Prokurimit është shtyrë deri në muajin mars dhe këtë e ka bërë Ministria e Arsimit.

Ishte një pyetje shumë me vend nga asamblisti z.Ragip Fetahu lidhur me dukuritë negative për të cilat me plotë përgjegjësi po ju them që me intensitet shumë të lartë janë duke u mbajt trajnime nëpër shkolla përmes institucioneve, policisë dhe kështu me radhë. Jeni në dijeni se për çdo muaj e mbajmë Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe përvoja juaj do ishte e mirëseardhur në atë takim, por ato të dhëna ne mund t’ju sjellim edhe këtu në Kuvend, andaj mund t’ju them se jemi duke u marrë me këtë çështje në vazhdimësi.

Te çështja e mungesës së transportit ashtu siç e ceku edhe asamblisti z.Ekrem Rrahmani që është çështje e cila nuk i përket DKA-së ngase se nuk i ka 4 km largësi, por unë kam biseduar me drejtorin z.Bahri Selimi dhe i kam sugjeruar që ata operator ekonomik që i kanë edhe linjat tjera do duhej të sanksionohen ngase jo t’ju jepen linjat ku ata kanë dëshirë t’i marrin dhe aty ku ka fitim, mirëpo nëse e ka pas atë linjë vitin e kaluar duhet ta merr sërish nëse jo atëherë të dalë në ri tenderim ose të mos i jepet leja fare, e jo t’ju jepet leja vetëm ku ata kanë leverdi.

Sa i përket kabineteve, e nderuara asambleiste znj.Arnisa Sylejmani, sa jam i njoftuar kabinetet pas një kohe shumë të gjatë që janë pajisur shkollat, janë duke u shfrytëzuar më mirë, por keni parasysh faktin që kemi disa mësimdhënës që kanë qenë me profilin e lëndës së batit më parë dhe nuk e kanë kualifikimin ndoshta aq të duhur, por janë të punësuar me kontrata me afat të pa caktuar, ka raste ku nuk mund të shfrytëzohen, mirëpo jemi duke bërë përpjekje që edhe ata ta kenë një shfrytëzim sa më të mirë.

Sa i përket fëmijëve me nevoja të veçanta e respektuara asambleiste jemi e vetmja Komunë që sot mora një raport që 17 asistent për fëmijë me nevoja të veçanta i kemi të punësuar, do të thotë aq sa i ka lejuar Ministria aq i kemi punësuar, pra i kemi 9 psikolog, 4 pedagog dhe për fat të mirë si Komunë jemi të mbuluar në këtë fushë. E vërteta është që do ishte mirë që çdo shkollë të ketë mirëpo ato shkojnë me numër të nxënësve dhe sa për njoftimin e juaj do të thotë prej një periudhe kohore sa i patëm 17000 nxënës aktualisht jemi me 13900 nxënës, do të thotë kemi rënie të numrit të nxënësve dhe ato shkojnë në përputhje me numrin e nxënësve që janë dhe ne i kemi këta që janë që po mundohemi t’i shfrytëzojmë për nevojat ku janë.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, i nderuar drejtor i DKA, vetëm një plotësim, unë nuk e pata pyetje por ishte një iniciativë që në seancën e ardhshme të diskutojmë se si të gjejmë alternativa më të mira të mundshme si Kuvend dhe si Ekzekutiv duke përfshi këtu edhe organizata tjera që së bashku ta hartojmë një plan dhe të bëjmë një fushatë informuese tek të rinjtë tanë.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, unë nuk e dija dhe tani po e di kur e pash incizimin se përse nuk kanë ardh drejtorët në seancë, përndryshe ata na paskan injoruar neve si Kuvend sepse paskan shkuar për të luajtur pingpong, mirëpo është dashur të jenë këtu prezent dhe të raportojnë ashtu siç e sheh rregullorja të raportojnë dy herë në vit, kurse ata jo që nuk raportojnë po nuk po vijnë fare as në seancë. Është dashur të tregojnë më herët në mënyrë që ta shtynim seancën për një ditë tjetër e të shkojnë ata të luajnë pingpong edhe pse e kanë pas mundësinë pas orës 16:00 të luajnë pingpong e jo të na injorojnë neve kështu në këtë mënyrë sepse pastaj po thonë, jeni duke bërë zhurmë, në fakt ne nuk jemi duke ju bërë asgjë sepse përndryshe kishin ardhë ata këtu e ishin



renditë dhe do kishin qëndruar deri në fund të seancës, ngase ne të vijmë këtu e të kërkojmë përgjegjësi nga karriget kurse drejtorët të luajnë pingpong atje në sallë.

Këta 2 drejtor këtu që janë prezent “do thotë qenkan më budallenjtë ose më të mençurit” ose nuk i kanë thirr fare për të luajtur pingpong “ai tipi”.

**znj.Arjeta Salihu**, theksoi, i nderuar Kryesues, edhe unë si shqetësim e pata se këto kërkesat tona që po i adresojmë te Drejtoritë, në mungesë të tyre çfarë përgjigje do marrim. Do të thotë ishte një pikë shumë e ndjeshme për një ndarje buxhetore për OJQ-në “Handikos”, pastaj ishte edhe shqetësimi për objektet banesore kolektive, prandaj këto janë dy kërkesa të adresuara prej qytetarëve dhe unë faktikisht ju drejtova ulëseve të zbrazëta në këtë rast, ndërsa përmes e-mailit asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje prej tyre.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë besoj që drejtorët e Drejtorive do e shohin incizimin e kësaj mbledhje dhe do i marrim pyetjet që u parashtruan nga ana juaj.

**znj.Arjeta Salihu**, ndërhyrë duke i reaguuar Kryesuesit se a po i bie kjo “shkel e shko”.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, unë mendoj që drejtorët e Drejtorive duhet gjithqysh të përgjigjen në pyetjet e shtruara, do ishte mirë të ishin prezent këtu por unë nuk jam kompetent që të përgjigjem sepse nuk jam njohës i atyre fushave, kështu që mbetet në ndërgjegjen e atyre drejtorëve që t’ju përgjigjen këtyre pyetjeve.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, në një formë i nderuar Kryesues atë që pata ndërmend ta them e thatë ju vetë lidhur me raportin e drejtorëve të Drejtorive, duhet me Kryetarin e Komunës të sqarohemi sepse është e kotë të sqarohemi me ty ngase ti nuk je autoritet mbi drejtorët e Drejtorive, fundja ata dikush i ka zgjedh dhe dikush i ka emëruar me të vërtetë dhe ata duhet t’i japin dikujt llogari për këtë situatë që ka ndodh.

**znj.Arjeta Salihu**, theksoi, pika Të Ndryshme është dashtë të jetë pika e parë e rendit të ditës në mënyrë që drejtorët t’iu përgjigjen pyetjeve.

**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi, shumë pyetje ne kemi bërë por asnjëherë nuk kemi marrë asnjë përgjigje prej drejtorëve as përmes e-mailit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë sot i falënderoj këshilltarët që 90% kanë qëndruar në sallë, të gjitha Grupet kanë qenë aktiv kështu që kjo mbetet përgjegjësi dhe në ndërgjegjen e drejtorëve për t’i dhënë përgjigjet në pyetjet e juaja.

**znj.Arjeta Salihu**, theksoi, i nderuar Kryesues, mos na falëndero sepse të gjithë ne e kemi obligim të jemi prezent gjatë mbledhjes së Kuvendit të Komunës, përfshirë gjithë neve, juve dhe drejtorët e Ekzekutivit, pra nuk ka vend për falënderim këtu.


*Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 14:20**

**Procesverbalin e mbajti dhe hartoi;  
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0072295/24  
Podujevë,  
04 nëntor 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 58 shkronja h) ndërlidhur me nenet 11 dhe 17 shkronja k) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 14 dhe 19 paragrafi 1.11 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Rregullores Komonale për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas kërkesës nr.208/24 të datës 22.11.2024 të Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, të proceduar në Komunën e Podujevës përmes Kërkesës nr.prot.02-120/010-0075543/24 datë 22.11.2024, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

*Propozohet*

### **V E N D I M**

#### **PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT TË QYTETARËVE ME VENDBANIM TË PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

##### **Neni 1**

Me këtë Vendim miratohet kërkesa e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevës sipas të cilës Komuna e Podujevës, për qytetarët me vendbanim të përhershëm përkatësisht personat që vdesin dhe varrosen në territorin e saj, bënë subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit për periudhën deri më 31 dhjetor 2026.

##### **Neni 2**

1. Për çdo të vdekur për të cilin në bazë të ekzaminimeve mjekësore në pajtim me dispozitat ligjore është konstatuar vdekja, bëhet subvencionimi i shpenzimeve për shërbimet e varrimit nga Bashkësia Islame përkatësisht Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë, që përfshijnë: transportin e kufomës, fletëljajmrimet (afishet), dërrasat, piramidën, pastrimin e kufomës, mbulesën e kufomës dhe qefinin.

2. Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë kërkesës për kompensim të shërbimeve përkatëse sipas çmimore, i bashkëngjit edhe konstatimin e vdekjes nga mjeku, dhe raportin e kryerjes së shërbimeve të vërtetuar-nënshkruar edhe nga ndonjëri prej familjarëve të ngushtë të të vdekurit (kopja ose numri i letërnjoftimi ).

### **Neni 3**

Autorizohet Kryetari i Komunës, të lidhë Marrëveshje Mirëkuptimi me Këshillin e Bashkësisë Islame në Podujevë, në cilësinë e subjektit të vetëm për ofrimin e shërbimeve sipas këtij vendimi, përmes së cilës definohen më në detaje obligimet dhe përgjegjësitë.

### **Neni 4**

Subvencionimi bëhet nga mjetet buxhetore përkatësisht të hyrat vetanake-kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

### **Neni 5**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është çmimorja e shërbimeve.

### **Neni 6**

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorinë e Administratës si dhe Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave.

### **Neni 7**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit, Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren 06/2021.

**Nr.Prot.** 01-016/01-0075873/24  
**Podujevë, datë;** 25.11.2024

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



## **Çmimorja**

### **e ofrimit të shërbimeve të varrimit nga Këshilli i Bashkësisë Islame - KBI, Podujevë**

- 1. Transporti i kufomave** (bartja e kufomës nga shtëpia deri në Xhami dhe përcjellja deri në varreza; bartja nga Aeroporti në familje në rastet kur kufomat sjellën nga jashtë vendit; bartja e kufomës nga QKUK deri te familja në rastet kur ndërrojnë jetë në QKUK si dhe transport shtesë varësisht kërkesës së qytetarit/familjarit; transporti i nëpunësve të KBI dhe mjeteve të punës si dhe dezinfektimin i veturës/automjetit).....**50 €**
- 2. Fletë lajmërimi** (afishe).....**20 €**
- 3. Dërrasat** (dërrasat me të cilat mbulohet kufoma pas lëshimit në varr, me dimensione; gjerësia 200 cm, gjatësia 115 cm dhe trashësia 05 cm).....**40 €**
- 4. Piramida** (Dërrasa me mbishkrimin e të dhënave të të vdekurit).....**20 €**
- 5. Vend pastrimi i kufomave** (banjë moderne për pastrimin e kufomave, mirëmbajtja e vend pastrimit dhe objektit përcjellës – rrymë, ujë detergjente e të tjera).....**20 €**
- 6. Pastrimi i kufomave** (pastrimi, mbështjellja dhe përgatitja e kufomës sipas rregullave Islame nga personi përgjegjës).....**55 €**
- 7. Mbulesa për mbështjelljen e kufomës**.....**10 €**
- 8. Qefini** (Pëlhura për mbështjelljen e kufomës ku përfshihen dorezat higjienike, pambuku dhe sapuni).....**25 €**

**Totali i shpenzimeve.....250 €**





Nr. 208/24 Data: 22.11.2024

Për: **KUVENDIT KOMUNAL – PODUJEVË, kryetarit z. Shpejtim Bulliqi**

Lënda: **Kërkesë për vazhdimin e marrëveshjes për kompensimin e shpenzimeve të shërbimeve të varrimit**

I nderuari kryetar, z. Shpejtim Bulliqi!

Duke ju falënderuar për kontributin dhe mbështetjen tuaj ndaj institucionit të Bashkësisë Islame të Podujevës dhe duke vlerësuar lartë mbështetjen dhe përkrahjen tuaj ndaj qytetarëve llapjanë, në emër të KBI-së Podujevë kërkojmë që:


Marrëveshja e mirëkuptimit për kompensimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit nr: 02/109-400 datë: 25.05.2013 e arritur në mes të Komunës së Podujevës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë të vazhdohet edhe më tutje, me po ato shërbime, por duke avansuar dhe shtuar edhe më, në mënyrë që të jemi në shërbim dhe sa më afër qytetarëve, veçanërisht në raste të tilla nevojë. Për shkak të inflacionit dhe ngritjes enorme në të gjitha çmimet e furnizimit në treg krahasuar me vitet e kaluara, që të vazhdojmë me shërbime cilësore, është jetike për ne ngritja e koston mbështetëse për shërbimet e varrimit.

- P.S. Bashkëngjitur gjeni edhe çmimoren e shërbimeve.

Parapakisht ju përshëndesim dhe falënderojmë për bashkëpunim!



Kryetari i KBI-së, Podujevë

  
Mr. Mensur ef. Hoti



## **Çmimorja e ofrimit të shërbimeve të varrimit nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë**

1. **Transporti i kufomave** – Bartja e kufomës nga shtëpia deri te xhamia dhe përcjellja deri në varreza. Në rast se vijnë nga jashtë vendi, sjellja e kufomës nga Airoporti në familje. Në rast se ndërron jetë në QKUK, sjellja e kufomës në familje. Dhe varësisht kërkesës së qytetarëve, bëjmë transport shtesë. Transporti i nëpunësve të KBI, mjeteve të punës dhe dezinfektimi i veturës ..... **60 €**
  
2. **Fletë lajmërimet** – Afishet ..... **25 €**
  
3. **Dërrasat** – Dërrasat me të cilat mbulohet kufoma, pas lëshimit në varr, me dimensione; gjerësia 200 cm, gjatësia 115 cm dhe trashësia 0.5 cm .....**55 €**
  
4. **Piramida** – Dërrasa me mbishkrimin e të dhënave për të vdekurin ..... **30 €**
  
5. **Vend pastrimi i kufomave** – Banjo moderne për pastrimin e kufomave. Mirëmbajtja e vend pastrimit dhe objektit përcjellës (rrymë, ujë, detergjene etj) ..... **25 €**
  
6. **Pastrimi i kufomave** – Pastrimi, mbështjellja dhe përgaditja e kufomës sipas rregullave islame nga personi përgjegjës..... **65 €**
  
7. **Mbulesa** – Mbulesa për mbështjelljen e kufomës ..... **25 €**
  
8. **Qefini** – Pëlhura për mbështjelljen e kufomës, ku përfshihen edhe dorëzat higjienike, sapun, pambuku ..... **40 €**
  
- TOTALI I SHPENZIMEVE** ..... **325 €**



## **Sqarim i detajshëm për shërbimet:**

1. **Transporti.** Prej Spitali në shtëpi, prej shtëpie në vend pastrim, prej vendpastrimi në shtëpi, prej shtëpie tek varrezat. Pos kësaj, kemi raste dhe kërkesa që të bëjmë transportin edhe në morg (Bradash) dhe anasjelltas.
2. **Transporti 24/7.** Kemi raste jo të rralla, në orët e vona të natës kryejmë transport, si prej; QKUK, AEROPORT e KUFIJ deri në familje.
3. **Punëtorët.** Katër punëtor i kemi që punojnë për shërbimet mortore, pagat mujore të tyre, trusti dhe tatimet.
4. **Automjetet.** Për shërbimet mortore posedojmë 4 automjete, të cilat kanë një kosto të lartë për mirëmbajtje. Sigurimi i tyre, mirëmbajta (servisimi, rexhistrimi, gomat verore-dimërore etj).
5. **Dërrasa shtesë.** Rastet kur varrosen ma arkivol, duhen dërrasa shtesë.
6. **Piramidat.** Ato duhet punuar, të dhënat e të ndjerit; shkronjat e emrit, mbiemrit, viti etj.
7. **Qefini.** Duhet përdoruar, ndarë, prerje të veçantë.
8. **Flet afishet.** Shtypi, letra, ngjyra.
9. **Raste për foshnje.** Kemi raste jo të rralla kur japim shërbime për të vdekur të posalindur, nuk i shtijmë në procedurë për kryerje të shërbimeve. Ju japim shërbimet, qefin, drrasa etj.
10. **Çregjistrimi.** Rastet mortore me automatizëm i çregjistrojmë, në programin e ministrisë përkatëse, në mënyrë që mos të përfitojnë nga pensionet.



Formulari per kerkese apo ankesa

Drejtorati/Njesia  
Zyra e Kryetarit

Data 22/11/2024

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri  
Keshilli i Bashkesise Islame -Podujeve  
Adresa e vendbanimit  
Podujeve

Numri personal  
601690945  
E-mail Adresa

Numri i tel. fiks Numri i tel. mobil

00000000

2. Mënyra e pranimit  
Kërkesa

Statusi i lëndës  
Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

02-120/10-0075543/24

Afati i zgjedhjes

22/12/2024

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kerkese per vazhdimin e marreveshjes per kompensimin e shpenzimeve te sherbimeve te varrimit.

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Keshilli i Bashkesise Islame - vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.  
Podujeve

  
(Nënshkrimi)

\*Ju lutemi të kërkonti nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: Fatime.Hoxha







**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

*Draft*

### **PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2025**

**Nëntor 2024**

### **Parathënie:**

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

Kuvendi i Komunës, sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për.

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

-Si dhe akte tjera që parashihen dhe rregullohen me legjislacion tjetër, varësisht fushave dhe kompetencave përkatëse.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Komuna siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre, Kuvendi i Komunës, kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësi të saj, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të pa deleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;
- Miratimin e akteve /dokumenteve të planifikimit hapësinorë, Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), Hartës Zonale (HZK), dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme (PRRH), plotësim ndryshimin/revidimin e tyre, si dokumenteve tjera nga fusha e planifikimit hapësinor; dhe
- Iniciativat për themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Për marrjen e vendimeve Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të caktuar të Kuvendit apo Kryetarit të Komunës dhe këtë delegim mund ta tërheqë në çdo kohë.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike dhe planifikohen etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera ligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2025, ku Kuvendi i Komunës së Podujevës planifikon t'i mbaj të paktën njëmbëdhjetë (11) seanca të rregullta, gjashtë (6) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Podujevës, e të cilat janë të rregulluara me proceduara sipas legjislacionit në fuqi, ndër të tjera:

- Planifikon kohën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit dhe akteve tjera në fuqi;
- Funkcionalizimin e plotë të Komiteteve, komisioneve dhe trupave tjerë të Kuvendit, sipas ligjit, dhe planifikon raportimin e tyre para Kuvendit së paku një herë në vit.
- Planifikon shqyrtimin e raporteve e rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Planifikon miratimin e buxhetit, planeve investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm, planet rregullative etj.
- Planifikon miratimin e çështjeve tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës dhe akteve tjera ligjore;
- Planifikon shqyrtimin dhe miratimin e rregulloreve të reja dhe harmonizimin e rregulloreve ekzistuese konform ligjeve në fuqi;
- Mbikëqyrë, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e Ekzekutivit të Komunës;



## **Përfundim:**

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2024 që kanë të bëjnë me interesat e Komunës dhe qytetarëve në përgjithësi.

Me planin e punës janë paraparë njëmbëdhjetë (11) seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe eventualisht seanca të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne, siç parashihet me Ligj, Statutin e Komunës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore varësisht fushave dhe kompetencave përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit varësisht nevojave mban takime mujore me përfaqësuesit / shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit nga subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend, për të bashkërenditur punën e komiteteve obligative dhe funksionale dhe punën e Kuvendit të Komunës.

Për përmbushjen e planit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit aktiviteteve, sipas dinamikës të përcaktuar me këtë plan, do të përkujdesen Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Realizimi i Planit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës i cili duhet që sa më shumë të jetë e mundur t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2025.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshinë: emërtimin e aktit / dokumentit - objektivin e tij, propozuesin e aktit si organ përgjegjës për përgatitjen të draftit të aktit, afatin e përafërt të procedimit nga propozuesi, shqyrtimet nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2025 sipas nevojave mund të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje dhe çështje të ngritura nga anëtarët e Kuvendit,
- Çështje tjera me rëndësi publike dhe në interes të qytetarëve dhe Komunës.

**Shtojcë:** *Plani i punës sipas muajve*

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2025**

**JANAR 2025**

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Plani i punës së KKSBS-së për vitin 2025				
2.	Plani i prokurimit për vitin 2025 ( Raporton Drejtori i Drejtorisë së Administratës.				
3.	Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024				
4.	Raportet e komisioneve të ndërmarrjeve publike				
	Të ndryshme				

**SHKURT 2025**

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Plani për vlerësimin e rreziqeve në Komunën e Podujevës				
2.	Informatë nga Drejtoria e Arsimit				
3.	Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit				
4.	Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural				
5.	Të ndryshme				

**MARS 2025**

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Raporti financiar për vitin 2024				
2.	Informatë nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit				
3.	Informatë nga Drejtoria e Kulturës Rinis dhe Sportit				
4.	Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025				
5.	Informatë nga Drejtoria e Inspeksionit				
6.	Shqyrtimi i raportit/informatës së KKSBS-së				
7.	Të ndryshme				

**PRILL 2025**

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Raporti financiar janar-mars 2025				
2.	Informatë për gjendjen e Ambientit në Komunën e Podujevës				
3.	Informatë e punës nga zyra e auditorit të brendshëm				
4.	Informatë nga Drejtoria e Administratës				
5.	Të ndryshme				

**MAJ 2025**

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale				
2.	Informatë nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë				
3.	Raporti i performancës së Komunës për vitin 2024				
4.	Raporti i punës së komiteteve të themeluara nga kuvendi i Komunës për vitin 2024				
5.	Të ndryshme				

**QERSHOR 2025**

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Korniza afatmesme buxhetore (KAB) 2026-2028				
2.	Raporti i auditorit të përgjithshëm				
3.	Rishikimi i buxhetit për vitin 2025				
4.	Plani Komunal për barazi gjinore				
5.	Të ndryshme				



**KORRIK 2025**

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Raporti gjashtë mujor nga Kryetari i Komunës				
2.	Raporti financiar janar-qershor 2025				
3.	Caktimi i normave të tatimit në pronë për vitin 2026				
4.	Të ndryshme				

**GUSHT 2025**

Nr.	
1.	Pushim / përveç ndonjë mbledhje për ndonjë çështje apo rrethanë urgjente

**SHTATOR 2025**

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Miratimi i projekt buxhetit për vitin 2025 dhe projektimet e vitit 2027-2029				
2.	Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përgatitjen e vitit shkollor për vitin 2025-2026				
3.	Të ndryshme				

**TETOR 2025**

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Raporti financiar janar-shtator 2025				
2.	Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale				
3.	Të ndryshme				

### NËNTOR 2025

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Informatë nga Drejtoria e Kulturës Rinis dhe Sportit				
2.	Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural				
3.	Informatë nga Drejtoria e Inspeksionit				
4.	Informatë mbi sigurinë në Komunën e Podujevës ( nga Policia-Podujevë)				
5.	Të ndryshme				

### DHJETOR 2025

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2026				
2.	Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit				
3.	Aprovimi i listave të pronave publike për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026				
4.	Informatë nga Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik				
5.	Informatë nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit				
6.	Informatë nga Drejtoria e Administratës				
7.	Të ndryshme				

Podujevë  
29.11.2024

Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha







**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Podujevës**  
**Opština Podujeva / Municipality of Podujeva**



**KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 58 shkronja h), 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 13 dhe 8 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenin 61 paragrafi 1.8, nenin 17 dhe 19 paragrafi 1.3 Statutit të Komunës së Podujevës Nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

**Propozon**  
**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2025**

**Neni 1**

Kuvendit të Komunës i propozohet për miratim Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2025.

**Neni 2**

Lista sipas nenit 1 të këtij vendimi, për secilën pronë, përmban, arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimit ekonomik të Komunës, të dhënat kadastrale, qëllimin e dhënies në shfrytëzim, destinimin e pronës, parashikimin e kohës së publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës përkatëse të paluajtshme të Komunës.

**Neni 3**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Lista e veçantë e pronave të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2025, përfshirë edhe Certifikatën pronësore, kopjen e planit dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për secilën pronë.

**Neni 4**

Pas shqyrtimit dhe miratimit nga Kuvendit i Komunës, për zbatimin e këtij vendimi si dhe procedurave tjera të parapara me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë në bashkëpunim dhe koordinim edhe me Drejtoritë tjera të Komunës varësisht fushveprimtarisë përkatëse.

**Neni 5**

Pas miratimit, Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

**Nr.Pro: 02-463/06-0077036/24**

**Datë: 02.12.2024**

**Podujevë**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës  
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezi

LISTA E VEÇANTË E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË  
PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2025

Nr.r	Të dhënat kadastrale të pronës	Arsyetimi i interesit publik dhe zhvillimit ekonomik	Data e publikimit të njoftimit	Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës	Destinimi sipas Hartës Zonale Kadastrale
1	Paluajtshmëria e evidentuar në çertifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-0076135/24 të datës: 26.11.2024 Njësia kadastrale P-00196-0 me sipërfaqe 10441 m <sup>2</sup> , kullosë me klasë 3 në vendin e quajtur "Fshati-Rrugica e Epërme" në Zonën Kadastrale Siboc i Epërm	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Janar-Mars 2025	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Pyjore

2	<p>Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-0076135/24 të datës: 26.11.2024</p> <p>Njësia kadastrale <b>P-00860-2</b> me sipërfaqe <b>29447 m<sup>2</sup></b>, Kullosë me klasës 3 në vendin e quajtur “Bellasicë” <b>Zona Kadastrale Revuq</b></p>	<p>Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik</p>	<p>Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënie në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Janar-Mars 2025</p>	<p>Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër</p>	<p>Zonë Bujqësore</p>
3	<p>Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-0076135/24 të datës: 26.11.2024</p> <p>Njësia kadastrale <b>P-00860-3</b> me sipërfaqe <b>26998 m<sup>2</sup></b>, Arë e klasës 7 në vendin e quajtur “Bellasicë” <b>Zona Kadastrale Revuq</b></p>	<p>Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik</p>	<p>Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënie në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Janar-Mars 2025</p>	<p>Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër</p>	<p>Zonë Bujqësore</p>

4	<p>Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-0076135/24 të datës: 26.11.2024 Njësia kadastrale <b>P-01798-0</b> me sipërfaqe <b>48439 m<sup>2</sup></b>, Kullosë e klasës 3 në vendin e quajtur “Ledina të shtëpia” <b>Zona Kadastrale Podujevë</b></p>	<p>Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik</p>	<p>Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënie në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Janar-Mars 2025</p>	<p>Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër</p>	<p>Zonë e shërbimeve Merge</p>
5	<p>Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-0076135/24 të datës: 26.11.2024 Lokalet afariste të cilat janë të ndërtuara në njësien kadastrale <b>P-00459-0</b> në <b>Zonën Kadastrale Podujevë</b> me sipërfaqe prej 2237 m<sup>2</sup> në “ Qytet, Rruga Skenderbeu” Lokalet të cilat janë të planifikuara të japen në shfrytëzim janë: - Lokali afarist me sipërfaqe <b>50,00 m<sup>2</sup></b> - Lokali afarist me sipërfaqe <b>55,00 m<sup>2</sup></b></p>	<p>Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik</p>	<p>Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënie në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Janar – Mars 2025</p>	<p>Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër</p>	<p>Zonë Ndërtimore</p>

6	<p>Paluajtshmëria e evidentuar në çertifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-0076135/24 të datës: 26.11.2024 Njësia kadastrale <b>P-00437-1</b> e cila gjendet në <b>Zonën Kadastrale Podujevë</b> me sipërfaqe prej <b>231 m<sup>2</sup></b> në vendin e quajtur "Qytet" Rruga Skenderbeu"</p>	<p>Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik</p>	<p>Periudha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Janar – Mars 2025</p>	<p>Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër</p>	<p>Q2P – B1 Zonë Ndërtimore</p>
